

KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI

PER

Hartim Projekt-zbatimi, për objektin: “Rikonstruksioni i Shkollës ‘Gjergj Fishta’, Rikonstruksioni i Shkollës ‘Marash Gjoni’, Rikonstruksioni i Shkollës ‘Dodë Gegë Jaku’ dhe Rikonstruksioni i Shkollës ‘Shtjefën Gjeçovi’“

Financuar në kuadër të Projektit "Për Barazi dhe Transparencë në Ndërhyrjet e Infraskstrukturës Shkollore" mbështetur nga USAID dhe implementuar nga UNICEF në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit

Kontrata Nr. 43403559 mes EPD dhe UNICEF

Tiranë, më 12.08.2024

Seksioni 1.

FTESË
Për Shprehje Interesi

1. Europartners Development, në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë, në kuadër të projektit “Për Barazi dhe Transparencë në Ndërhyrjet e Infrastrukturës Shkollore”, financuar nga USAID dhe zbatuar nga UNICEF, kërkon të kontraktojë shoqëri të licencuara në fushën e studim-projektim të objekteve social -kulturore, publike.
2. Objekti për të cilin do të hartohet projekti është:
 - Lot 1: Shkolla Gjergj Fishta
 - Lot 2: Shkolla Marash Gjoni
 - Lot 3: Shkolla Dodë Gegë Jaku
 - Lot 4: Shkolla Shtjefen Gjeçovime vendodhje në Bashkinë Lezhë.
3. Europartners Development, në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë, fton të gjitha shoqëritë e interesuara që disponojnë licensat përkatëse në këtë fushë, për të shprehur interesin e tyre duke marrë pjesë në këtë garë. Më shumë detaje mbi shërbimet e kërkuara janë dhënë në Termat e Referencës.
4. Kërkesa për Shprehje Interesi përfshin dokumentat e mëposhtme:
 - Seksioni 1 – Ftesë (për shprehje Interesi)
 - Seksioni 2 – Udhëzimet për Shoqëritë pjesëmarrëse
 - Seksioni 3 – Propozimi Teknik - Formulari Standard
 - Seksioni 4 – Propozimi Financiar - Formulari Standard
 - Seksioni 5 – Termat e Referencës
 - Seksioni 6 – Kriteret e Pjesëmarrjes
 - Seksioni 7 – Kriteret e Vlerësimit
5. Ju lutemi na informoni me shkrim në adresën e mëposhtme :
europartners@europartners.al

Ku të konfirmoni :

- (a) që keni marrë letrën e ftesës; dhe
- (b) nëse jeni të interesuar për të paraqitur një ofertë ekonomike.

Seksioni 2**Udhëzime për shoqëritë pjesëmarrëse**

Ref.		
1.1	Autoriteti Kontraktor	Europartners Development
1.2	Institucioni Përfitues	Bashkia Lezhë
1.3	Përshkrim i Shkurtër i Shërbimeve të Kërkuara	<p>Shërbimi i Kërkuar: Hartim i Projektit të zbatimit për objektin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lot 1: “Rikonstruksioni i Shkollës Gjergj Fishta” - Lot 2: “Rikonstruksioni i Shkollës Marash Gjoni”; - Lot 3: “Rikonstruksioni i Shkollës Dedë Gegë Jaku”; - Lot 4: “Rikonstruksioni i Shkollës Shtjefën Gjeçovi”. <p>Projekti, për secilin Lot, që do të dorëzohet pranë Autoritetit Kontraktor, duhet të përfshijë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Projekti Arkitektonik, ku të paraqitet: <ul style="list-style-type: none"> i) Plan-vendosja e objektit me planin e sistemit pas rikonstruksionit. ii) Gjendja Ekzistuese iii) Ndërhyrjet iv) Gjendja pas rikonstruksionit - Plani i rilevimit ku të paraqitet gjendja aktuale e ndërtimit dhe teritorit të tij - Projekti Konstruktiv, ku është e nevojshme; - Projekti Elektrik; - Projekti i rrymave të ulta - Projekti sistemit të ngrohjes (me panele diellore) - Projekt i ujsjellës- kanalizimeve, ku të paraqitet: <ul style="list-style-type: none"> i) Ekzistuesi, dhe ii) i rikonstruktuar . - Projekti MNZ; - Projekti Paraprak i Eficiencës së Energjisë; - Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM).etj <p>Mënyra e dorëzimit është më e detajuar në detyrën e projektimit</p>

1.4	Pika e kontaktit për kërkesa për sqarime	Të gjitha kërkesat për sqarime duhet të dërgohen në mënyrë elektronike në email e mëposhtëm: europartners@europartners.al
1.5	Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës	30 ditë pas datës së dorëzimit të Ofertës, deri në datën 25/09/2024.
1.6	Afati i Kërkesave për Sqarim	<p>Sqarime, apo propozime në lidhje me dokumentat e ftesës, mund të kërkoen jo më vonë se 5 ditë përpara datës së dorëzimit të propozimeve, pra, deri në datën 21/08/2024.</p> <p><i>Kërkesat për Sqarime e propozime, duhet t'i drejtohen përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor, përcaktuar në Pikën 1.4.</i></p>
1.7	Afati për Dorëzimin e Ofertave	26/08/2024
1.8	Adresa për Dorëzimin e Ofertave	<p>Ofertat do të dorëzohen në mënyrë elektronike në adresën e email: europartners@europartners.al</p> <p>Ofertuesi i shpallur fitues do të dorëzojë dokumentacionin origjinal ose fotokopje të noterizuara të dokumentacionit origjinal, në adresën e mëposhtme: Europartners Development, Rr.Ismail Qemali, Pall 18, Ap 25, Tiranë Tel: +355686904087</p> <p>Mos dorëzimi i dokumentacionit origjinal brenda afateve të përcaktuara në Shpalljen e Fituesit sjell skualifikimin e ofertës.</p>
1.9	Përmbajtja e Ofertës	<ul style="list-style-type: none"> i) Dokumentacioni që vërteton përmbushjen e Kritereve Minimale të Pjesëmarrjes. ii) Propozimi Teknik; iii) Propozimi Financiar.
1.10	Gjuha e dorëzimit	Shqip
1.11	Monedha	Lekë
1.12	Kohëzgjatja e Kontratës	45 ditë, nga data e nënshkrimit të Kontratës

1.13	Vlera limit e Kontratës pa tvsh	1,000,000 (një milion) Lekë për Lot 1 1,000,000 (një milion) Lekë për Lot 2 1,000,000 (një milion) Lekë për Lot 3 1,000,000 (një milion) Lekë për Lot 4
1.14	Sqarim mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar	Oferta duhet të shprehet pa TVSH.
2.1	Kriteret Minimale të Pjesëmarrjes	Më shumë informacion në Seksionin 6.
2.2	Kriteret e Vlerësimit	Oferta më e mirë teknike. Më shumë informacion në Seksionin 7.
2.3	Pjesëmarrja në më shumë se një Lot	Ofertuesi mund të marrë pjesë në më shumë se një Lot të kësaj thirrjeje duke provuar se i zotëron kapacitetet teknike dhe financiare për përmbushjen e kontratës brenda afatit të përcaktuar. <i>Ne rast të pjesëmarrjes në më shumë se një Lot, Ofertuesi duhet të dorëzojë Propozim Teknik dhe Financiar të veçantë për secilin Lot.</i>
2.4	Emri dhe CV e Ekspertëve Propozuar	1 (një) Arkitekt Projektues me të paktën 10 vjet përvojë; 1 (një) Inxhinier Konstruktore me të paktën 10 vjet përvojë; 1 (një) Inxhinier Mekanik me të paktën 7 vjet përvojë; 1 (një) Inxhinier Elektrik me të paktën 7 vjet përvojë.
3.1	Forma e Paraqitjes së Propozimit Teknik	Sipas Seksionit 3.
3.2	Forma e Paraqitjes së Propozimit Financiar	Sipas Seksionit 4.
3.3	Kushtet e Pagesave	Sipas specifikimeve në Kontratë
4.1	Data e pritshme për Zhvillimin e Negociatave	09/09/2024
4.2	Data e Pritshme për Fillimin e Kontratës	16/09/2024

Seksioni 3

Propozimi Teknik - Formulari Standard

Propozimi Teknik duhet të përmbajë:

- F-1 : Formulari i paraqitjes së propozimit teknik
- F-2 : Organizimi dhe përvoja e projektuesit
- F-2A : Shoqëria e projektuesit -Ofertues
- F-2B : Përvoja ne detyra të ngjashme e projektuesit -Ofertues

F-3 : Pritshmëritë nga Autoriteti Kontraktor.

- F-4 : Metodologjia
- F-4 A: Përbërja e ekipit dhe detyrat
- F-4 B : Curriculum Vitae (CV) dhe Licencat për Stafin e Propozuar
- F-4 C : Plani i Punës

Shënim Për pjesëmarrje në më shumë se një projekt përbërja e ekipit duhet të jetë i ndryshëm për çdo projekt

FORMULARI F-1 FORMULARI I PARAQITJES SË PROPOZIMIT TEKNIK

[Vendndodhja, data]

Për: [*Europartners Development, Rr. Ismail Qemali, Pall 18, Ap 25, Tiranë*]

Te nderuar zoterinj:

Ne, të nënshkruarit, _____ ofrojmë shërbimin për hartimin e projektit të zbatimit të objektit: „Rikonstruksioni i Shkollës _____“, me adresë në _____, Bashkia _____, kjo në përputhje me Kërkesën tuaj për Propozim të datës [Shkruaj Datën].

Propozimi ynë përfshin Propozimin Teknik, dhe Propozimin Financiar, të vulosur në një zarf të veçantë.

Deklarojmë se të gjitha informacionet dhe deklaratat e bëra në këtë Propozim janë të vërteta dhe pranojmë se çdo keqinterpretim i përfshirë në të mund të çojë në skualifikimin tonë.

Ne marrim përsipër, nëse Propozimi ynë pranohet, të fillojmë shërbimet e konsulencës në lidhje me detyrën jo më vonë se data e treguar në Paragrafin Referenca 7.1 të Fletës së të Dhënave.

Me respekt,

Ofertues:

Nënshkrimi i autorizuar [Të plotë dhe inicialet]: _____

Emri dhe titulli i Nënshkruesit: _____

Emri i firmës: _____

Adresë: _____

FORMULARI F-2 ORGANIZIMI DHE PËRVOJA E PROJEKTUESIT

A – Ofertuesi

[Jepni këtu një përshkrim të shkurtër (dy faqe maksimumi) të historikut dhe organizimit të firmës/entitetit tuaj, shërbimet e ngjashme të kryera me sukses dhe kualifikimet e stafit kryesor.]

B - Përvoja e ofertuesit

[Kjo Formë duhet të plotësohet vetëm në zbatim të Pikës 4 të Kriterëve Minimale të Pjesëmarrjes “Shërbimet e Ngjashme”, sipas të cilit Ofertuesi duhet të ketë përmbushur gjatë 5 (pesë) viteve të fundit të paktën 2 (dy) kontrata për Studim-Projektim të ndërtesave shkollore, ndërtesave komunitare apo ndërtesave civile të së njëjtës sipërfaqe dhe kompleksitet. Pra kjo formë duhet të plotësohet vetëm për 2 (dy) apo më shumë, sipas vendimit të Ofertuesit, shërbime të ngjashme të kryera në të shkuarën.]

Tabela me të dhënat e projektit

Emri i projektit të realizuar	
Vlera me TVSH	
Shteti:	
Vendndodhja brenda vendit:	
Emri i porositesit	
Adresë:	
Vlera e shërbimeve të ofruara nga firma juaj sipas kontratës	
Data e fillimit (muaj/vit):	
Data e përfundimit (muaj/vit):	
Emri i projektuesve të shoqërisë apo të kontraktuar që kanë marrë pjesë në realizmin e projektit	
Përshkrimi i shkurtër i projektit të realizuar:	
Përshkrimi i shërbimeve që ju keni ofruar në bazë të stafit të vënë në dispozicion për këtë projekt	

Emri i Ofertuesit: _____

F-3 – Pritshmëritë nga Autoriteti Kontraktor

[Identifikoni, në jo më shumë se 2 (dy) faqe, dokumentacionin që prisni t'ju vendoset në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor, si psh. Planimetritë e objektit, informacione të tjera, apo lehtësitë nga Autoriteti Kontrakti si vizitat në objekt, etj.]

FORMULARI F-4**PËRSHKRIMI I QASJES, METODOLOGJISË DHE PLANIT TË PUNËS PËR KRYERJEN E DETYRËS**

- a) *Përberja e Ekipit dhe Detyrat,*
- b) *CV dhe Licencat e Stafit*
- c) *Plani i punës,*

a) *Përberja e Ekipit dhe Detyrat. Në këtë seksion ju duhet të propozoni strukturën dhe përbërjen e ekipit tuaj. Ju duhet të listoni disiplinat kryesore të detyrës, ekspertin kryesor përgjegjës dhe stafin teknik dhe mbështetës të propozuar.*

b) *Listoni sipas formatit të ofruar, apo një formati të ngjashëm që përmban informacionin e kërkuar, CV-të për secilin anëtar të stafit të propozuar. Ofertuesit mund të propozojnë më shumë ekspertë nga sa listohen në Kriteret Minimale të Pjesëmarrjes.*

c) *Plani i Punës. Në këtë seksion ju duhet të propozoni aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e tyre, fazat dhe ndërlydhjet, pikat kryesore (përfshirë miratimet e përkohshme nga Ofertuesi) dhe datat e dorëzimit të raporteve. Plani i propozuar i punës duhet të jetë në përputhje me qasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar mirëkuptimin e TOR-ve dhe aftësinë për t'i përkthyer ato në një plan pune të realizueshëm. Këtu duhet të përfshihet një listë e dokumenteve përfundimtare, duke përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat që do të dorëzohen si rezultati përfundimtar.*

FORMULARI F-4B CURRICULUM VITAE (CV) PËR STAFIN PROFESIONAL TË PROPOZUAR

1.Pozicioni i propozuar [për çdo pozicion do të nominohet vetëm një kandidat]:

2. Emri i shoqërisë [Vendosni emrin e firmës që propozon stafin]:

3. Emri i Stafit [Fut emrin e plotë]:

4.Data e lindjes:_____

Kombësia:_____

5.Edukimi [Tregoni kolegji/universitet dhe arsim tjetër të specializuar të anëtarit të stafit, duke dhënë emrat e institucioneve, diplomat e marra dhe datat e marrjes]:_____

6.Anëtarësimi në Shoqatat Profesional

7.Trajnime të tjera[Tregoni trajnim të rëndësishëm pasi janë marrë diploma - Arsimi]:_____

8.Vendet e përvojës së punës:[Rendisni vendet ku stafi ka punuar në pesë vitet e fundit]:

9.Gjuhët [Për secilën gjuhë tregoni aftësitë: e mirë, e drejtë ose e dobët në të folur, lexim dhe shkrim]:

10.Historiku i Punësimit [Duke filluar me pozicionin aktual, renditni në rend të kundërt çdo punësim të mbajtur nga punonjësi që nga diplomimi, duke dhënë për çdo punësim (shih formatin këtu më poshtë): datat e punësimit, emri i organizatës punëdhënëse, pozicionet e mbajtura.]:

Nga [viti]: _____ Për [vit]: _____

Punëdhënësi: _____

Pozicionet e mbajtura: _____

<p>11. Detyrat e detajuara të caktuara</p> <p>[Rendisni të gjitha detyrat që do të kryhen sipas kësaj detyre]</p>	<p>12. Puna e ndërmarrë që ilustron më së miri aftësinë për të trajtuar detyrat e caktuara</p> <p>[Ndër detyrat në të cilat stafi është përfshirë, tregoni informacionin e mëposhtëm për ato detyra që ilustrojnë më së miri aftësinë e personelit për të trajtuar detyrat e renditura në pikën 11.]</p> <p>Emri i detyrës ose projektit: _____</p> <p>Viti: _____</p> <p>Vendndodhja: _____</p> <p>Klienti: _____</p> <p>Karakteristikat kryesore të projektit: _____</p> <p>Pozicionet e mbajtura: _____</p> <p>Aktivitetet e kryera: _____</p>
--	--

13. Certifikimi:

Unë, i nënshkruari, vërtetoj se për aq sa kam njohuri dhe besim, kjo CV përshkruan saktë veten, kualifikimet e mia dhe përvojën time. Unë e kuptoj se çdo gabim i qëllimshëm i përshkruar këtu mund të çojë në skualifikimin ose shkarkimin tim, nëse përfshihet.

_____ Data: _____
 [Nënshkrimi i anëtarit të stafit ose përfaqësuesit të autorizuar të personelit] Dita/Muaji/Viti

Emri i plotë i përfaqësuesit të autorizuar: _____

FORULARI F-4C GRAFIKU I REALIZIMIT TE SHERBIMIT

N°	Aktiviteti	Javë								
		1	2	3	4	5	6	7	8	9
1										
2										
3										
4										
5										
6										
7										
n										

Afati maksimal i hartimit të projektit 45 ditë

1 Tregoni të gjitha aktivitetet kryesore të detyrës, duke përfshirë dorëzimin e raporteve (p.sh.: raportet fillestare, të përkohshme dhe përfundimtare) dhe standarte të tjera të tilla si miratimet e përfituesit. Për detyrat me faza, tregoni aktivitetet, shpërndarjen e raporteve dhe standardet veç e veç për secilën fazë.

2 Kohëzgjatja e aktiviteteve duhet të tregohet në formën e një grafiku me shtylla.

Seksioni 4

Propozimi Financiar

Format standarde të propozimit financiar do të përdoren për përgatitjen e propozimit financiar sipas udhëzimeve të parashikuara në paragrafin. 3.6 i Seksionit 2. Formularë të tillë duhet të përdoren cilado qoftë metoda e përzgjedhjes e treguar në paragrafin. 4 të letrës së ftesës.

FIN-1 Formulari i dorëzimit të propozimit financiar

FORMULARI FIN-1

FORMULARI I DORËZIMIT TË PROPOZIMIT FINANCIAR

[Vendndodhja, data]

Për:[*Emri dhe adresa e klientit*]

Te nderuar zoterinj:

Ne, të nënshkruarit, ofrojmë Shërbimin për përgatitjen e Projektit të zbatimit për objektin: Rikonstruksioni i Shkollës _____“ me vendodhje në _____, Bashkia _____, në përputhje me „Kërkesë per Propozim“ të datës __/__/2024 dhe Propozimin tonë Teknik.

Propozimi ynë financiar , për kryerjen e këtij shërbimi, është në shumën prej [Fut shumën(at) _____ me fjalë dhe shifra1].

Kjo shumë është pa përfshirë TVSH.

Propozimi ynë financiar do të jetë i detyrueshëm për Ne, në varësi të modifikimeve që rezultojnë nga negociatat e kontratës, deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së Propozimit, dmth përpara datës së treguar në Referenca 1.5 të Fletës së të Dhënave.

Me respekt,

Ofertues

Nënshkrimi i autorizuar [Të plotë dhe inicialet]: _____

Emri dhe titulli i Nënshkruesit: _____

Emri i firmës: _____

Adresë: _____

1 Shumat duhet të përkojnë me ato të treguara nën Kostoja totale e propozimit financiar në Formularin FIN-2.

FORMULARI FIN-2 NDARJA E KOSTOVE SIPAS AKTIVITETIT

Komponenti i kostos	Kostot			
	Sasi	Cmim	Vlere ne ALL	Shenime
Tarifat e ekspertëve				
Shpenzime të rimbursueshme –si transporti, printime me koston e tyre				
Total pa TVSH				

Ofertues

Nënshkrimi i autorizuar [Të plotë dhe inicialet]: _____

Emri dhe titulli i Nënshkruesit: _____

Emri i firmës: _____

Adresë: _

Seksioni 5. Termat e Referencës

A. OBJEKTIVAT E DETYRËS SË PROJEKTIMIT

1. Objektivi kryesor i kësaj detyre konsultimi është si më poshtë:
2. Objekti ekzistues i shkollës që do të rehabilitohet është:
 - **Lot 1: "Shkolla Gjergj Fishta"**
 - Lloji i shkollës: 9 vjeçare
 - Adresë: Rr. Kosova, Lezhë.
 - Sipërfaqja e truallit: ___ m²
 - Sipërfaqja e katit: ___ m²
 - Sipërfaqja ndërtimore: ___ m²
 - Të dhënat më të detajuara janë sipas «Detyrës së projektimit» bashkëlidhur si Aneks 1.
 - **Lot 2: "Shkolla Marash Gjoni"**
 - Lloji i shkollës: 9 vjeçare
 - Adresë: Rrilë, Lezhë.
 - Sipërfaqja e truallit:
 - Sipërfaqja e katit: ___ m²
 - Sipërfaqja ndërtimore: ___ m²
 - Të dhënat më të detajuara janë sipas «Detyrës së projektimit» bashkëlidhur si Aneks 2.
 - **Lot 3: "Shkolla Dodë Gegë Jaku"**
 - Lloji i shkollës: 9 vjeçare
 - Adresë: Rr. Manati, Lezhë.
 - Sipërfaqja e truallit: 3,000 m²
 - Sipërfaqja e katit: 400 m²
 - Sipërfaqja ndërtimore: 400 m²
 - Të dhënat më të detajuara janë sipas «Detyrës së projektimit» bashkëlidhur si Aneks 3.
 - **Lot 4: "Shkolla Shtjefën Gjeçovi"**
 - Lloji i shkollës: 9 vjeçare
 - Adresë: Troshan, Lezhë.
 - Sipërfaqja e truallit: 2,370 m²
 - Sipërfaqja e katit: 670 m²
 - Sipërfaqja ndërtimore: 670 m²
 - Të dhënat më të detajuara janë sipas «Detyrës së projektimit» bashkëlidhur si Aneks 4.

B. FUSHA E VEPRIMTARISË

Europartners Development, në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë që është në pozicionin e institucionit përfutës kërkon të paraqesin propozime teknike dhe financiare nga ofertuesi në përgatitjen e Projektit të Detajuar dhe dokumenteve të tjera plotësuese të mbështetura në

Detyrën e projektimit dhe termat e referencës për objektet: “Lot 1: Rikonstruksioni i Shkollës Gjergj Fishta”, me adresë në Rr. Kosova; “Lot 2: Rikonstruksioni i Shkollës Marash Gjoni”, me adresë Rrilë; “Lot 3: Rikonstruksioni i Shkollës Dodë Gegë Jaku”, me adresë Manati dhe “Lot 4: Rikonstruksioni i Shkollës Shtjefën Gjeçovi” me adresë Troshan, Bashkia Lezhë.

1. Shoqëria Projektuese, e perzgjedhur, do të hartojë një projekt të plotë zbatimi, të detajuar sipas Propozimit Teknik për të siguruar menaxhimin e përgjithshëm dhe gjithashtu Dokumentacionin teknik dhe Projektet e Detajuara për kontratat e punimeve. Detajet e ftesës/vlerësimit të propozimeve jepen në Kërkesën për Propozim.
2. Këto shërbime përfshijnë në përgjithësi përgatitjen e projektimit të detajuar dhe dokumentacionit tjetër teknik për realizimin e kontratave të punimeve për rehabilitimin e shkollave. Përgatitja dhe prezantimi i projektit paraprak për miratim nga përfituesi.
3. Krijimi i kontakteve dhe marrëdhënieve të nevojshme me autoritetet e shkollës për miratimin paraprak të projekteve dhe zgjidhjeve bazë arkitekturore.
4. Konsulenti, nëpërmjet ekipit dhe burimeve të tij të projektimit, do të ndihmojë Autoritetin Kontraktues në të gjitha hapat e kërkuara për miratimin e dizajneve dhe dokumenteve përkatëse nga autoritetet përkatëse dhe marrjen e lejeve të nevojshme.
5. Në procesin e përgatitjes së dizajnit të detajuar dhe dokumenteve të tjera të kërkuara, konsulenti në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë duhet të kontaktojë me autoritetet e shkollave për të diskutuar dhe marrë komentet e tyre për aspektet e projektimit. Proces verbalit e këtyre takimeve dhe fotot duhet të regjistrohen dhe të paraqiten në Raportin Teknik.
6. Është parashikuar që shërbimi për hartimin e projektit, do të kryhet në **45 ditë**.
7. Ofertuesi duhet të paraqesin në propozim përbërjen e ekipit të projektuesve dhe stafit propozohen, në bazë të përvojës së mëparshme dhe disponueshmërisë së stafit, sipas kërkesave të pikes 5 të Kriterëve Minimale të Pjesëmarrjes (Seksioni 6).

Shënim: E RËNDËSISHME

- Në qoftë se ofertuesi konkuron për më shumë se një Lot, duhet të provojë se zotëron kapacitetet e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale brenda afatit të kërkuar, duke propozuar një ekip të ndryshëm të projektuesve për secilin projekt.
- Të gjitha dokumentet/korrespondenca e përgatitur nga ofertuesi, sipas kësaj kontrate (duke përfshirë edhe dorëzimin e propozimit) duhet të jetë në Gjuhën Shqipe.
- Projekti do dorëzohet në tre kopje të printuara dhe firmosura rregullisht nga ekipi projektues dhe dy kopje dixhitale firmosur elektronikisht.

E.DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E OFERTUESIT-PROJEKTUES .

Ofertuesi do të administrojë procesin e përgatitjes së projektit ekzekutiv dhe dokumenteve të tjera të kërkuara; do të bëjë rilevimet e nevojshme si topografike në objektin ekzistues të shkollave; do të krijojë marrëdhënie me autoritetet e shkollës gjatë procesit të përgatitjes së planeve arkitekturore dhe diskutimit të këtyre planeve në takime të hapura me bordet e shkollave.

Projektuesi do të paraqesi për miratim në Bashki:

- (a) Drafti përfundimtar i planit arkitektonik të rikonstruktuar
- (b) Paraqitja e ndryshimeve në objektin ekzistues
- (c) Përgatitja e Librezës paraprake të punimeve preventivit, duke përcaktuar vlerën paraprake të punimeve;
- (d) Zgjidhje arkitektonike e zonave të jashtme të territorit të shkollës

F.LISTA E RAPORTEVE DHE AFATET E DORËZIMEVE

1. Më poshtë janë dokumentat që duhet të përgatitur dhe koha e dorëzimit dhe një përmbledhje e përmbajtjes së tyre, të cilat duhet ti dorëzohen Autoritetit Kontraktues:
 - (a) **Raporti Teknik (specifikimet teknike, relacion arkitektonik, përshkrim punimesh)** me detaje të zgjidhjeve arkitektonike dhe inxhinierike të zgjedhura, detaje të zgjidhjes dhe funksionalitetit të sistemit të ngrohjes dhe rrjeteve të instaluara të furnizimit me ujë, elektrike dhe të tjera.
 - (b) Një pjesë e dokumentave duhet te tregojë gjendjen topografikë ekzistuese të terrenit ku është ndërtimi. Në raport duhet të përfshihen diskutimet dhe konsultimet që Konsulenti do të bëjë me Autoritetin Kontraktues dhe me drejtorinë e shkollës dhe grupet e tjera të interesit.
(Nr. i kopjeve - 3 kopje)
 - (c) **Projektimi i detajuar i vizatimeve arkitektonike dhe inxhinierike**(për çdo ndërtesë shkolle) në të cilën duhet të përfshihen por jo të kufizuara;
 - Plani i përgjithshëm i objektit dhe territorit të tij në shkallën 1:500
 - Plani arkitektonik i çdo kati të objektit ekzistues në shkallën 1:100.
 - Plani arkitektonik i rehabilitimit të propozuar të ndërtesave duke përfshirë zonat shtesë. Shkalla 1:100.
 - Prerjet e ndërtesës në dy drejtime. Shkalla 1:100
 - Pamje e përgjithshme e secilës anë të ndërtesës së rehabilituar në shkallë 1:100.
 - Të paktën 5 flete pamje 3D të ndërtesës së përfunduar.
 - Vizatimet e strukturave inxhinierike për hapësira ekzistuese dhe shtesë në shkallën 1:100 dhe 1:20 për detaje.
 - Vizatimet e sistemit të furnizimit me ujë. Shkalla 1:100 dhe prezantimi i rrjetit në aksonometri
 - Vizatim i sistemit të mbrojtjes nga zjarri dhe prezantim në aksonometri
 - Vizatimet e sistemit të ngrohjes qendrore. Shkalla 1:100 dhe prezantimi i rrjetit në aksonometri.
 - Vizatimet e planit të taracës dhe catisë, plani i sistemit të ujrave të shiut, të ndërtesave dhe territorit të saj dhe lidhja e tyre me rrjetin kryesor të qytetit.
 - Vizatime të sistemit të kanalizimit dhe lidhjes me rrjetin kryesor të qytetit.
 - Vizatime të sistemeve elektrike, elektronike dhe IT, ku prezantimi i rrjetit kryesor do të paraqitet dhe ne rrafshin vertikal.
 - Vizatimet të detajeve të ndryshme arkitektonike, elektrike, MNZ, UKZ, etj.

- Vizatimet e organizimit dhe riorganizimit të ambienteve sportive të jashtme dhe ambienteve të clodhjes si dhe dhe hapësirave të tjera brenda territorit të shkollës.
(Nr. i kopjeve - 3 kopje)

Në mënyrë të detajuar këto kërkesa përshkruhen tek detyra e projektimit për objektin në fjalë.

Në procesin e përgatitjes së Projekteve të detajuara, Shoqëria Projektuese do të respektojë të gjitha standardet e projektimit për rehabilitimin e godinave shkollore ekzistuese dhe krijimin e hapësirave të të ambienteve të domosdoshme të jashme në shërbim të shkollës (rrethimi, sistemimi territori, këndet e gjelbëruara, terrene sportive, sheshe të grumbullimit të nxënësve, etj).

Gjatë ekzekutimit të projektimit, Shoqëria Projektuese, duhet të marrë parasysh si minimum kushtet e mëposhtme:

- Fondi rezerve i parashikuar ne preventivin e rikonstruksionit të objektit, do të jetë 5% .
 - Projektet do jenë të realizuara duke përdorur programet CAD dhe 3D.
 - Sigurimi i nje plan-rilevimi të plotë të terrenit të shkollës , sipas gjendjes faktike, duke përfshirë rrugët e hyrjes dhe daljes, porta dytësore, me asfaltim, shtigje, kullim të vendit dhe mur/gardhe rrethuese, këndet sportive , etj.
2. Raportet formale të dorëzueshme, përveç 3 kopjeve të printuara, do të dorëzohen edhe në dy kopje CD.

(d) Preventivat e punimeve të detajuara në sasi dhe me cmime të pasqyruara sipas sistemit e-albania, dhe të shoqëruar me librezë paraprake masash, ku të jenë përshkruar të gjitha aktivitetet që duhet të kryhen për ndërtimin e punimeve të projektuara.

Në permatat e paraqitura në projekt, çdo detaj dhe planimetri, duhet të detajohet në në mënyrën që të matet dhe llogaritet lehtësisht gjatë procesit të kryerjes së punimeve nga mbikëqyrja e punimeve dhe sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit.

Sigurohuni që materialet e vendosura në projekt, të jenë të një cilësie të lartë dhe të qëndrueshme, duke i specifikuar në specifikimet teknike dhe pasqyruar në çmimet e vendosura në preventiv.

(Nr. i kopjeve - 3 kopje)

(e) Specifikimet teknike, duhet të përshkruaj të gjitha materialet dhe procedurat që do të ndiqen nga kontraktori gjatë kryerjes së punimeve. Në këto specifikime, të gjitha materialet duhet të respektojnë kërkesat e specifikimeve të Standarteve të projektimit për shkollat dhe duhet të jenë të përbëra nga materiale të cilësisë së lartë të destinuara për zonën me frekuencë të lartë dhe të përdorshme për fëmijë.

Këto specifikime duhet të jenë në shkallën që të lejojnë Kontraktorët e ekzekutimit të punimeve të jenë në gjendje të vlerësojnë saktësisht çdo artikull të përmendur pa ekuivoqe dhe ngjashmëri.

(Nr. i kopjeve - 3 kopje)

- (f) **Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis** do të përfshijë një raport të shkurtër të gjendjes ekzistuese dhe asaj që do rikonstruktohet.
(Nr. i kopjeve - 3 kopje)

G. TË DHËNAT DHE DOKUMENTET TEKNIKE TË SIGURUARA NGA BASHKIA

1. Të dhënat që do të ofrohen nga Bashkia do të përfshijnë informacionin për objektin ekzistues të shkollës dhe përbërjen e dhomave brenda saj. Numri i nxënësve dhe mësuesve në shkolla dhe organizimi i procedurave mësimore.
2. Bashkia do t'u sigurojë dokumentet ligjore të pronës së tokës së shkollës nga zyra e regjistrimit të pronave, ku Kartela e pasurisë duhet të jete brenda 10 ditëve nga fillimi i projektit.
3. Normat standarde dhe kriteret e projektimit janë të përshkruara të detajuara në Detyrën e projektimit.
4. Çmimet do jenë sipas përshkrimit të bërë më sipër, të hedhura në sistemin e- albania.

H. KOHA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

1. Konsulenti duhet të përgatisë dhe dorëzojë në Europartners Development, dokumentet e kerkuara, duke respektuar planin e mëposhtëm:
 - Draft plane arkitektonike me zgjidhje dhe 3D për miratim paraprak – dy javë nga nënshkrimi i kontratës.
 - Përfundimi i diskutimit me autoritetet e shkollës dhe dorëzimi i procesverbalit të mbledhjes – dy javë pas lidhjes së kontratës, duke paraqitur projektin arkitektonik
 - Projekti i plotë me të gjitha kërkesat e mësipërme të detajuara si : Porjekti arkitektonik dhe ai i konstruksionit (ku duhet)+specifikime + deklarata te projektuesve + Polica e sigurimit + pershkrimin e punimeve + preventivin përfundimtar, në tre kopje të printuara dhe të firmosura nga gjithë ekipet e projektimit dhe kopja dixhitale do jetë e firmosur elektronikisht (në CD) do të dorëzohen me proces-verbal, brënda 45 ditëve nga nënshkrimit të kontratës.

SEKSIONI 6

KRITERET MINIMALE TË PJESËMARRJES

Nr.	Kriteret e Pjesëmarrjes	Dokumentacioni i Kërkuar
1	Ofertues duhet të jetë një entitet i regjistruar prej të paktën 3 (tre) vjetësh, të cilit i lejohet ofrimi i shërbimeve të kërkuara.	Certifikatë Regjistrimi Ekstrakt QKB
2	Ofertuesi duhet të jetë i licënuar për të ofruar shërbimet e kërkuara	Licencë në Projektim: - Kategoria 2, b2; - Kategoria 3.a; - Kategoria 4 a,b,f; - Kategoria 9, a. <i>Licenca duhet të zotërohet nga Shoqëria ofertuese ose individualisht nga stafi i propozuar. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, plotësimi i këtij kriteri cilësohet i përmbushur edhe nëse operatorët i zotërojnë bashkarisht licencat e përmendura.</i>
3	Ofertuesi duhet të zotërojë kapacitetin ekonomik për ofrimin e shërbimeve të kërkuara	Vërtetim i xhiros i tre viteve të fundit ku xhiro minimale vjetore për të tre vitet të jetë të paktën 3,000,000 (tre milion) Lekë. Vërtetim që ofertuesi nuk ka detyrime tatimore, qëndrore apo lokale.
4	Ofertuesi duhet të ketë përvojën e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të kërkuara, duke provuar që gjatë viteve të fundit ka përmbushur me sukses të paktën 2 (dy) punë të ngjashme në studim-projektimin e ndërtesave shkollore, ndërtesave komunitare apo ndërtesave civile të së njëjtës madhësi e kompleksitet.	Vërtetim të Realizimit të Kontratës ose Kontratën së bashku me faturën tatimore ku të jenë detajuar shërbimet e ofruara.
5	Ofertuesi duhet të zotërojë kapacitetin teknik për ofrimin e shërbimeve të kërkuara.	CV, Diploma, Licenca dhe Kontrata e punës ose Kontrata e Angazhimit për ekspertët e mëposhtëm: 1 (një) Arkitekt Projektues me të paktën 10 vjet përvojë; 1 (një) Inxhinier Konstruktor me të paktën 10 vjet përvojë; 1 (një) Inxhinier Mekanik me të paktën 7 vjet përvojë; 1 (një) Inxhinier Elektrik me të paktën 7 vjet përvojë.

SEKSIONI 7**KRITERET TEKNIKE E VLERËSIMIT**

Kriteret, nën kriteret dhe sistemi i pikëve për vlerësimin e Propozimeve Teknike janë:

Nr	Përmbledhje e Kritereve Teknike të Vlerësimit	Pikët Maximale
1	Kualifikimet, Kapaciteti dhe Përvoja e Ofertuesit	40
2	Kualifikimet dhe Përvoja e Stafit të Propozuar	60
3	Totali	100

Nr	Kualifikimet, Kapaciteti dhe Përvoja e Ofertuesit	Pikët Maximale
1	Eksperiencia e mëparshme në projektimin e shkollave	15
2	Madhësia e organizatës në terma të numrit të punonjësve dhe xhiros vjetore	10
3	Kuptueshmëria e detyrave të kërkuara dhe cilësia e Ofertës	10
4	Zotërimi i çertifikimeve të tjera si ISO, etj.	5
5	Totali	40

Nr	Kualifikimet dhe Përvoja e Stafit të Propozuar	Pikët Maximale
1	Arkitekt Projektues	15
2	Inxhinier Konstruktor	15
3	Inxhinier Mekanik	15
4	Inxhinier Elektrik	15
5	Nën-Totali	60



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

MIRATOHET

PJERIN NDREU
KRYETAR



DETYRË PROJEKTIMI

PËR REALIZIMIN E STUDIM PROJEKTIMIT:

RIKONSTRUKSION, SHTESE ANESORE 3 KAT, RIKONTRUKSION I PALESTRES, RIKONTRUKSION I PJESHEM I SISTEMIT ELEKTRIK, SISTEMI I PJESHEM I OBORRIT TE SHKOLLES 9 – VJEÇARE, 3 KAT, “GJERGJ FISHTA” LEZHE ,

Lezhë
Korrik 2024

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
Institucioni përfitues	3
Arsyetimi i nevojës për ndërhyrje.	3
Baza ligjore.	3
Qëllimi i projektit të investimit.	3
Objektivat e projektit të investimit.	3
PËRSHKRIM I DETYRËS SË PROJEKTIMIT	4
Qëllimi	4
Objektivat	4
Përshkrim i përgjithshëm	4
Pozicionimi i parcelës që zhvillohet	4
Gjendja faktike	7
Kërkesat teknike planimetriko – kompozicionale dhe infrastrukturore	12
Kërkesat teknike kundrejt projektit arkitekturor.	14
Hapësirat e brendshme të sanitarisë	16
Trajtimi i ujërave të zeza dhe atmosferike	16
Drenazhimi i lokacionit	16
Sistemi i drenazhit të ujërave atmosferikë	16
Drenazhimi i kulmit	16
Ajrosja e mjediseve	17
Sistemet dhe rregullat për mbrojtje nga zjarri	17
Qasja në lokacion	17
Pajisjet e fikjes së zjarrit	17
Mbrojtja nga rrufetë	18
Projektimi për personat me nevoja të veçanta	19
Kërkesat teknike kundrejt projektit konstruktiv.	20
Mbulesa	20
Soletat	21
Suvatimet.	21
Lyerja e mureve të brendshëm dhe të jashtëm	21
Fasada	21
Shtresat e pllakave	21
Shkallët	21
Dyer, dritare	21
Kërkesat teknike kundrejt projektit hidrosanitar.	22
Kërkesat teknike kundrejt projektit elektrik dhe elektronik.	23

Rrjeti telefonik dhe kompjuterik	24
Sistemi elektrik, ndriçimi i emergjencës dhe sigurisë.	24
Kërkesat teknike kundrejt projektit mekanik	25
Kërkesat teknike kundrejt projektit të mbrojtjes nga zjarri	25
Kërkesat kundrejt raportit dhe auditimit të efikasitetit energjetic.	26
Kërkesat teknike kundrejt shërbimeve që i takojnë nëntokës.	26
Kërkesa të përgjithshme.	26
Kërkesa të veçanta.	27
SHËRBIMET E KËRKUARA SIPAS FAZAVE.	27
Hartimin e projekt preventivitet duhet të përfshijë fazat si vijon:	27
Faza I - Aplikimi për VNM paraprake.	27
Faza I.	28
Faza II.	28
Faza III.	28
STANDARDE NË PROJEKTIM	28
Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik	28
REALIZIMI I PROJEKTIT	29
Faza e I: Analiza e detyrës së projektimit e cila përfshin:	29
Faza e II : Projekt-ideja përfundimtare (sistemet dhe planifikimi i integruar)	29
Faza e III : Projekti për miratimin e lejës së ndërtimit.	29
Faza e IV: Projekti i Zbatimit	29
Rekomandime për projektuesin	30
Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar	30
RAPORTIMI	31
Oponenca teknike	31
Paraqitja e vizatimeve.	32
Faza e V: Projekti i Zbatimit	32
Investimi Themelor	33
Sqarime të fundit	33

HYRJE

Institucioni përfitues

Institucioni përfitues i shërbimit në fushën e projektimit është Bashkia Lezhë. Përfituesi i këtij shërbimi është Institucion Publik.

Misioni i këtij institucioni është të sigurojë një infrastrukturë sa më cilësore arsimore për popullatën dhe posaçërisht për shëndetin e nënës dhe fëmijës së porsalindur.

Përfituesi i projektit është sistemi arsimor, për infrastrukturën fizike të të cilit është përgjegjës pushteti vendor.

Arsyetimi i nevojës për ndërhyrje.

Problematika që sjell nevojën e investimit. Në rast se nuk ka problematikë por përputhet me strategjinë e zhvillimit shtjellohet strategjia që e bën të nevojshëm investimin.

Ky projekt është nevojë e rëndësishme e momentit e institucionit për realizimin e veprimtarisë së tij institucionale, si dhe përputhet me strategjinë e zhvillimit të Bashkisë Lezhë dhe orientimeve të ministrisë së linjës

Baza ligjore.

Bazuar në statusin ligjor të institucionit, ky shërbim në fushën e projektimit duhet të përmbushë kërkesat dhe të marrë në konsideratë referencat si vijon:

1. Ligj Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i përditësuar
2. Rregulloren e Zhvillimit të Territorit (në fuqi).
3. VKM Nr.1503, datë 19.11.2008 “Për miratimin e Rregullores “Për shfrytëzimin e hapsirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””.
4. Ligj Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.
5. Ligj Nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë”.
6. “Rregullore për formatin e auditimit energjistik dhe pagesën e audituesit energjistik”, miratuar me Urdhër Nr. 5, datë 12.01.2021 të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë.
7. Manualët, standardet dhe kushtet teknike shtetërore dhe evropiane të projektimit të objekteve spitalore.
8. VNM
9. Çdo ligj, apo manual tjetër, të lidhur me projektimin e ndërtesave të kësaj natyre.

Qëllimi i projektit të investimit.

Qëllimi i rikonstruksionit është që të përmirësohet infrastruktura e procesit mësimor në shkollën 9-vjeçare “Gjergj Fishta”, Lezhë nëpërmjet rikonstruksionit të godinës dhe mjediseve sportive, në mënyrë që të rritet edhe cilësia e mësimdhënies dhe nxënies.

Objektivat e projektit të investimit.

Objektivi kryesor i këtij projekti është të sigurojë ambiente të projektuara dhe të përshtatura në përputhje me kërkesat dhe nevojat e veprimtarisë arsimore, në respektim të standardeve bashkëkohore infrastrukturore dhe çdo akti juridik, normativ, apo standard në fushën e projektimit të ndërtesave arsimore në Republikën e Shqipërisë dhe më gjerë, në shërbim të rritjes së cilësisë së ofrimit të shërbimeve.

Objektivat specifikë të këtij projekti investimi përmbledhen në vazhdim:

- Organizimi funksional i mjediseve shkollore dhe zonimi hapësinor i tyre, në përputhje me kërkesat dhe standardet infrastrukturore për objektet arsimor të mesëm ulët.
- Pajisja e objektit me sisteme, rrjete dhe materiale ndërtimore bashkëkohore.
- Përmirësimi i gjendjes fizike të ndërtesës për të përmbushur kriteret infrastrukturore për efikasitetin energjetic, komoditetin termoakustik, mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, kërkesat higjieno - sanitare dhe përshtatjen e mjediseve për personat me aftësi të kufizuara.
- Përmirësimi i mjediseve sportive të shkollës në përputhje me kërkesat për mjedise rekreative, kërkesat drenazhimit e ujërave të shiut, ato për mbrojtjen e mjedisit dhe kriteret për orientimin e fluksit të nxënësve.

PËRSHKRIM I DETYRËS SË PROJEKTIMIT

Qëllimi

Detyra e Projektimit ka për qëllim parashtrimin e të dhënave thelbësore, njohëse, kërkesave dhe nevojave specifike të institucionit përfitues, në cilësinë e Porositësit, kundrejt shërbimit të kërkuar, si dhe orientimet mbi problematikën aktuale të shtruar për zgjidhje, mbi bazën e të cilave, grupi i projektimit, do të hartojë projektin për Rikonstruksionin e Shkollës 9-vjeçare "Gjergj Fishta".

Objektivat

Detyra e projektimit ka këto objektiva:

- Të prezantojë grupin e projektimit me vendndodhjen, infrastrukturën dhe problematikën e gjendjes faktike të objektit që i nënshtrohet ndërhyrjes.
- Të përshkruajë kërkesat sasiore dhe cilësore kundrejt shërbimit të porositur.
- Të evidentojë kërkesat profesionale kundrejt grupit të projektimit.
- Të shtjellojë formën, mënyrën dhe afatet e raportimit të materialeve pranë Porositësit.

Përshkrim i përgjithshëm

Pozicionimi i parcelës që zhvillohet

Vendndodhja: Lezhe, Bashkia Lezhe



Fragment i Hartës Treguese të Pasurive



Foto te objektit

Përshkrim: Shkolla 9 - vjeçare ‘Gjergj Fishta’, 3 kat, Lezhe, është ndërtuar në vitin 1979 dhe rikonstruktuar në vitin 2015. Godina e shkollës është objekt tre katësh dhe mbulesa është e tipit terrace e sheshte. (Solete). Ka rampë. Nuk ka banjo për fëmijë me PAK. Gjendja e ndërtesës është e mirë. Ka sistem kaldaje me naftë, por nuk funksionon sepse mungon kaldaja dhe ngrohja bëhet me enegji elektrike. Dritaret janë me dopio xham.

Kapaciteti: Në total frekuentojnë mësimin rreth 538 nxënës, të cilët e zhvillojnë mësimin në 20 klasa, të cilat ofrojnë kushtet për mësim. Mësimi zhvillohet me një turn.

Të dhëna statistikore për vitin shkollor 2023-2024- Numri i nxënësve të regjistruar sipas klasave

Klasa e pare		Klasa e dyte		Klasa e trete		Klasa e katert		Klasa e peste		Klasa e gjashte		Klasa e shtate		Klasa e tete		Klasa e nente		Klasa e pare deri e nente		
Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	M
59	34	59	28	54	26	57	27	79	34	58	27	56	26	60	27	56	27	538	266	282

Nxenes me aftesi e kufizuar				Nxenes Rom				Nxenes Egjiptian			
Mendore		Fizike		Cikli fillor		Cikli larte		Cikli fillor		Cikli larte	
Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F
7	1	0	0	13	5	5	2	10	7	11	3

Gjendja faktike

Vlerësimi fizik i objektit: Megjithëse shkolla është e mirëmbajtur, vërehen probleme të cilat kërkojnë ndërhyrje. Nga një vlerësim paraprak rezulton se :


- Objekti ka nevojë për një shtesë anesore 3 kat, në të cilën do të projektohen nyjet hidrosanitare dhe ambiente shtesë për klasa të reja.
- Ka nevojë për ndërtimin e sistemit të drenazhimit në ambientet e jashtme.
- Sistemi elektrik duhet të rishikohet pasi nuk mban ngarkesë.
- Shkolla nuk ka një sistem kaldaje apo ndonjë sistem ngrohje funksionale, ndaj duhet parë mundësia e zhblokimit të oxhakëve për ngrohje.
- Permiresim i sistemit të MNZ-së (mungojnë shkallet e emergjences).
- Ka nevojë për hidroizolim sepse kati i tretë ka shumë lagështirë.
- Tualetet e vajzave janë në gjendje shumë të keqe sepse futet lagështirë dhe ka krijuar myk.
- Shkolla ka tualete për djem, vajza dhe mësues vetëm në katin e parë, është e domosdoshme të shtohen tualete edhe në katet e tjera në mënyrë që të krijohet një mjedis më i sigurt dhe më higjienik për nxënësit dhe stafin. Aktualisht stafi ndihmës për të pastruar katin e dytë dhe të tretë ujin e merr në tualetet e katit të parë.
- Duhet të mbulohen tubat e laboratorit dentar që është krijuar në katin e dytë i ka kaluar tubat në tualetin e vajzave.
- Ka nevojë për lyerjen e korridoreve dhe klasave.

- Është shumë e domosdoshme krijimi i sallës së mësuesve në katin e tretë. Ndarje me kartongjes ose vetratë alumini në korridorin e katit të tretë (80 m²).
- Ka nevojë për rregullimin e palestrës sepse punimet pas ndërtimit të saj janë lënë përgjysëm, ka nevojë për shtimin e saj me parket pasi është lënë vetëm me fazën e nivelimit të betonit, ka nevojë për ndërrimin e mbulesës pasi mushamaja është dëmtuar nga era, gjithashtu ka nevojë edhe për arredimin e saj në mënyrë që ora e edukimit fizik të zhvillohet në kushte të përshtatshme dhe pa rrezikuar shëndetin e nxënësve.

Foto te gjendjes egzistuese tobjektit:









Kërkesat teknike planimetrike – kompozicionale dhe infrastrukture

Projektuesi duhet të kryejë të gjithë punën në përputhje me standardet e projektimit dhe ndërtimit që janë në fuqi në Shqipëri.

Perpara hartimit të projektit është e domosdoshme të bëhet një Akt – Ekspertimi nga Instituti i Ndërtimit për të përcaktuar qendrushmerinë e objektit nga pikepamja konstruktive.

Gjatë hartimit të meren parasysh kondicionet e PPV Bashkisë Lezhë. Projektuesi duhet të marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi për ndërtimet, kryesisht: Ligji 107/2014 Për planifikimin e zhvillimit të territorit i ndryshuar; Ligji 69/2012 Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar; Ligji nr 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar; Ligji 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” i ndryshuar; Ligj nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”; Ligji nr. 152/2015 Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin. Projektuesi do të përdorë edhe standardet në fuqi të projektimit të hartuara nga MASH për objektet arsimore: VKM 319 datë 12.04.2018.

Hartimi i projekteve specifike, të shtjelluar në vijim, duhet të mbështetet në studimet e thelluara të gjendjes faktike. Çdo dokument teknik që disponohet nga institucioni në shërbim të procesit të projektimit do t’i vendoset në dispozicion grupit të projektimit. Grupi i projektimit duhet të hartojë projektet mbështetur në shërbimin topografik të parcelës dhe shërbimet që i takojnë nëntokës, pa anashkaluar kriteret për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e eficensës energjitike.

Gjithashtu Grupi i projektimit do të duhet të bëjë një rilevim faktik arkitektoniko-konstruktiv të ndërtesës.

Shkolla 9 - vjeçare ‘Gjergj Fishta’ Lezhe propozohet për: shtese anesore 3kat, rikonstrukcion palestere, permiresim i sistemit të MNZ-së (mungojne shkallet e emergjences), nderhyrje ne sistemin elektrik, ndertim i sistemit ‘Kapote, etj. per efficensen energjitike, sistemimin e ujërave të shiut.

Shkolla “Gjergj Fishta” klasifikohet si pjese e sistemit bazik/themelor dhe klasifikohet si shkolle e Arsimit të Mesëm të Ulet. Shkollat e arsimit të mesëm të ulët: Ndërtesa për nivelin e arsimit të mesëm të ulët përbëhet nga hapësirat kryesore të arsimit, siç janë dhomat mësimore, biblioteka, hapësira për qëllime të shumëfishta, laborator i përgjithshëm për shkencë (biologji, kimi dhe fizikë), laborator të TIK dhe hapësirat përcjellëse që përfshijnë zonat administrative dhe ato të shërbimeve (përcjellëse teknike)

Gjate hartimit të projektit projektuesi duhet të ketë planifikojë intervistim të perfaqesues të sistemit arsimor dhe të vete shkolles për të mbledhur një informacion paraprak për të hartuar një përmbledhje informative dhe orjentuese.

Përmbledhja përbën pikën e fillimit të punës së ekipit të projektimit. Përgatitja e saj duhet të bëhet mbi këto baza:

- Përshkrimi i një dite të zakonshme të shkollës në këtë moment dhe se si do të ndryshojë ajo me agjendën transformuese;
- Struktura organizative e shkollës, përfshirë drejtimin, departamentet, mbështetjen këshilluese joformale dhe kështu me radhë;
- Etikën dhe vlerat e shkollës;
- Aktivitetet që do të vendosen në shkollë, duke përfshirë edhe jashtë orarit për nevojat e komunitetit si dhe llojin e aktiviteteve që kërkohen;

- Shpeshhtësinë e aktiviteteve të ndryshme - nivelet e përdorimit të llojeve të ndryshme të akomodimit;
- Afërsinë e kërkuar në mes të aktiviteteve të ndryshme, departamenteve etj;
- Mënyrat për qasjen e komunitetit dhe nivelet e duhura të sigurisë;
- Mënyrat sipas së cilave shkolla mund të ndryshojë në të ardhmen e afërt, në llogari të ndryshimeve pedagogjike, organizimeve joformale këshilluese dhe metodave të reja të mësimdhënies.
- Të gjitha këto informata janë shumë të dobishme për projektuesit/dizajnerët e shkollës prandaj duhet të përfshihet në përmbledhje të detajuara si informata.

Pasi të jenë zgjedhur të gjitha këto çështje, faza tjetër e hartimit të përmbledhjes është përpilimi i detajuar i planit të akomodimit/detyrës projektuese (fleta që liston të gjitha hapësirat e nevojshme) Këtu duhet të mbahen parasysh ambientet që përmendëm: Biblioteka, palestra, dhoma e mjekut., dhoma e psikologut, ambienti i qeverisë së nxënësve. Kjo detyrë projektuese (plani i akomodimit) do të listojë saktësisht numrin e klasave të duhura dhe madhësitë minimale të dhomave mësimore të tyre, si dhe kapacitetin e parashikuar të shkollës të dhënë më termat e numrit të përgjithshëm të vendeve të nxënësve dhe grupeve. Informata të mëtejshme lidhur me dhomat e veçanta janë të listuara në atë që zakonisht njihet si fleta me të dhëna për të gjitha llojet e dhomave mësimore. Detyra do të shtohet deri në një sipërfaqe të përgjithshme në të cilën synohet të bëhet ndërtimi në mënyrë që të sigurojë që limitet financiare të mos jenë tejkaluar.

Projektuesit duhet të analizojnë madhësitë e klasave eksistuese dhe të propozojnë modifikime të mundshme duke patur parasysh përafrimin me standartin e treguar në tabelën e mëposhtme;

Ciklet e plota	Zonat urbane me densitet të lartë			
	Parafillor	Fillor	M. I ulët	M. i lartë
Vitet:	1	5	4	3
3	3	15		
4	4	20		
5	5	25	20	
6	6	30	24	18
7			28	21
8			32	24
9			36	27
10				30
11				33

Madhesia e shkollave

Përveç kësaj, projektuesi duhet të bëjë vlerësimin dhe të kuptojë se si ligjërohet kurrikulumit dhe se si do të shfrytëzohen klasat e mësimit në mënyrë që ai të mund të del me zgjidhje të reja për llojin e aktiviteteve që do të zhvillohen në klasat e mësimit. Ai gjithashtu duhet të vlerësojë dhe të marrë në konsideratë ndërveprimin dhe qasjen në hapësirat e tjera, siç janë (i) hapësirat përcjellëse që ju përshtaten nxënësve që punojnë, (ii) zonat depove dhe ato për mbështetje të mësimdhënësve, (iii) vendet për ruajtjen e rrobave dhe çantave të nxënësve; (iv) hapësirat sociale dhe rekreative.

Përsa i takon mashësisë së klasave projektuesi duhet të ketë parasysh të dhënat në tabelën e mëposhtme;

Niveli i arsimit	Vende për nxënësit		Sipërfaqja në M2		M2/vend të nxënësit	
	Ulët	Lartë	Ulët	Lartë	Ulët	Lartë
Parafillor	24	30-36	48	65	2.0	1.8-2.2
Fillor	24	30-36	44	58	1.8	1.6-1.9
Mesëm i nllt	24	30-36	45	58	1.9	1.6-1.9

Mesëm i lartë	24	30-36	nuk ka	58	nuk ka	1.6-1.9
---------------	----	-------	--------	----	--------	---------

Madhësia e dhomave mësimore

Projektuesi duhet të këtë në konsideratë parime të funksionalitetit duke u kujdesur që gjatë projektimit të ndërtesës shkollë, të krijohet një bilanc mes cilësisë së funksionimit dhe efikasitetit të kostos. Ky bilanc mund të arrihet me mjete të ndryshme, siç janë:

- Dimensionet racionale të hapësirave:
- Zonat e përshtatura të qarkullimit: hapësirat e qarkullimit nuk duhet të kalojnë 25% të sipërfaqes së dobishme të ndërtuar. Ato duhet të kenë dimensione dhe të përshtaten sipas shfrytëzuesve të shkollës, ato duhet të jenë funksionale dhe të respektojnë kërkesat për siguri;
- Numri optimal i hapësirave: numri i hapësirave fillimisht përcaktohet sipas shfrytëzimit. Në rast se norma e pranueshme nuk mund të arrihet, në veçanti për hapësirat për mësimdhënie të specializuar, hapësirat për qëllime të shumëfishta duhet të merren parasysh;
- Përshtatshmëri maksimale: hapësirat duhet të projektohen me një përshtatshmëri maksimale, që i mundëson ato të përshtaten për lëndë dhe ndryshime të ndryshme, në ato raste kur kjo përshtatet me kërkesat e tyre funksionale;
- Grupimi i hapësirave: hapësirat duhet të grupohen në blloqe sipas funksionit dhe ndërlidhjes. Kjo do të sigurojë një identifikim të lehtë të veprimtarive dhe hapësirave të tyre korresponduese, një komunikim të lehtë mes hapësirave të ndryshme, pa pengesa nëpër zonat e qarkullimit dhe ato të pritjes, një vëzhgim të lehtë të hapësirave dhe një shfrytëzim optimal të tokës në dispozicion;
- Integrimi i nevojave: lokacioni i hapësirave brenda shkollës duhet të ndjekë domosdoshmëritë themelore siç janë rregullat e sanitarisë dhe higjienës, rregulloret e komoditetit funksional dhe të sigurisë, si dhe komoditetin akustik, vizual e atë klimatik.

Kërkesat teknike kundrejt projektit arkitekturor.

Projektuesi duhet të kujdeset që të analizoje dhe të propozojë në respektim të parametrave të komoditetit, duke adresuar tri burime kryesore të mungesës së komoditetit fizik që trupi mund të përjetojë: temperatura, ndriçimi dhe zëri.

Një vëmendje e shtuar duhet t'i kushtohet Komoditetit termik, i cili zakonisht i atribuohet dy parametrave kryesorë: (i) ndjenjës së komoditetit termik si rezultat i bilancit në mes të kalorive të akumuluar dhe të humbura në trup, dhe (ii) kontrollit të kushteve klimatike, duke përfshirë pozitën e diellit dhe rrezatimit, temperaturën, lagështinë dhe erërat.

Përmirësimi i komoditetit termik do duhet të përqendrohet në masa artificiale ose aktive, që përfshijnë mjetet mekanike ose ato elektrike, siç është ngrohja, ajrosja apo kondicionimi i ajrit. Projektuesi duhet të vlerësojë edhe masa si:

- Sipërfaqet e mbjella: mbjellja e bimëve që mund të luajë një rol thelbësor në krijimin e mikroklimës, kur është e nevojshme. Mbjellja e bimëve kontribuon në mënyrë efektive në mbrojtjen nga pluhuri, erërat dhe rrezet e diellit. Përveç kësaj, mbjellja e shkurreve dhe kaçubave bëjnë të mundur mbrojtjen kundër reflektimit të rrezeve të diellit nga toka;
- Elementet e duhura të ndërtesës: kjo përfshihet kullimi i duhur nga çatia/terrace dhe kullimin rreth ndërtesës, krijimin e hijeve me kanate të rregullueshme nëpër dritare, ndalesa të diellit, perde për diell, çadra dhe/apo galeri që mund të sjellin mbrojtje shtesë nga rrezet e diellit, sidomos kur orientimi i ndërtesës nuk është i favorshëm.
- Materialet e duhura të ndërtimit, që përfshijnë materialet e fasadave me reflektim të mundshëm të diellit, materialet izoluese për rritjen e veprimit termik të mureve dhe të kulmit.

Projektuesi duhet të mbajë parasysh që për realizimin e komoditetit termik të mësimdhënies duhet të synohen parametrat e dhënë në tabelën e mëposhtme

<i>Klasat e mësimit</i>	<i>19°C</i>
<i>Depot</i>	<i>16°C</i>
<i>Korridoret</i>	<i>15°C</i>
<i>Zonat e sanitarisë</i>	<i>16°C</i>
<i>Punëtoritë</i>	<i>16°C</i>
<i>Sallat për qëllime të shumëfishta</i>	<i>19°C</i>
<i>Zyrat e administratës</i>	<i>19°C</i>
<i>Dhoma e mjekut</i>	<i>22°C</i>

Temperaturat minimale te rekomanduara

Me një vëmendje të shtuar, projektuesi duhet të vlerësojë masat projektuese për rritjen e efikasitetit energjetic të ndërtesës qëpërmes rritjes së cilësisë së termoizolimit të strukturës. Ai duhet të vlerësojë edhe cilësinë e materialeve të kaviteteve dhe të propozojë eventualisht edhe përmirësimin e sipërfaqeve të dritës.

Me qëllim rritjen e efikasitetit energjetic të godinës projekti duhet të parashikojë veshjen termoizoluese të të gjithë kapsulës veshëse të jashtme të godinës. Projekti arkitekturor duhet të mbajë në konsideratë përshtatjen e objektit për personat me aftësi të kufizuara, referuar kategorizimeve të kufizimeve të ndryshme. Materialet e propozuara për të gjithë elementët ndarës dhe veshës, termoizolues, hidroizolues etj., duhet të jenë bashkëkohorë, të plotësojnë kushtet higjieno sanitare dhe të shmangin elementët e rrezikshmërisë. Rëndësi duhet ti kushtohet akustikës së ambienteve, izolimit nga zhurmat, luhatjet e temperaturës dhe lagështirës.

Gjatë të gjithë procesit të projektimit është e rëndësishme që të bashkëpunohet ngushtë ndërmjet të gjithë specialistëve të përfshirë, pasi projekti arkitekturor duhet të reflektojë kërkesat e projektit strukturor, kërkesat e projekteve të sistemeve teknike, kërkesat e aspekteve arkitekturore të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, kërkesat për efikasitetin energjetic, kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe çdo kërkesë tjetër, të gjykuar si të nevojshme nga specialistët e përfshirë.

Sa i takon komoditetin vizual, projektuesi duhet të ketë parasysh se nevoja për standarde të larta dhe një ndriçim i projektuar mirë për ndërtesat shkollë bazohet në: (i) ndriçimin natyror që rezulton nga drita e diellit e drejtpërdrejtë apo ajo e tërthortë e reflektuar nga toka dhe sipërfaqet e tjera të jashtme apo ato të brendshme.

Projektuesit duhet të ndërmarrin masa të duhura për të siguruar komoditetin e ndriçimit që është esencial për një performancë të mirë dhe komoditet vizual të nxënësve dhe personelit të shkollës. Ato janë:

Ndriçimi natyror:

- Për të kufizuar përdorimin e ndriçimit të shtrenjtë artificial, plani(projekti) i ndërtesës dhe i dhomave mësimore duhet të maksimizojë përdorimin e dritës natyrore dhe në këtë mënyrë do të minimizohet rrezatimi i mundshëm që mund të ndodhë gjatë periudhave të caktuara të ditës;
- Niveli i mirë i ndriçimit është i rëndësishëm në zonat e qarkullimit për të minimizuar rrezikun nga aksidentet;
- Distanca mes balleve duhet të lejojë depërtimin e mjaftueshëm të dritës nëpër ndërtesa. Këto rekomandime mbi këtë lloj distance zbatohen edhe për komoditetin klimatik;
- Numri, dimensionin, vendosja dhe aranzhimet e dritareve duhet të jenë në përputhje me sasinë e kërkuar të dritës (dhe rrjedhën e ajrit). Duke pas parasysh rëndësinë e ndriçimit natyror, rekomandohet që e tërë sipërfaqja e dritareve në hapësirat e mësimit të jetë 15 deri 20% e sipërfaqes së dyshemesë;
- Thellësia e sallave mund të ndikojë në ndriçimin natyror për hapësirat në anën e kundërt të dritareve. Andaj rekomandohet që të shmangen thellësitë e sallave që tejkalojnë 7.00 m;
- Kur kemi streha, amortizatorë dritarësh apo grila për mbrojtjen e dritareve, efekti i tyre në dritën e ditës duhet të studiohet me kujdes;

- Mbjellja e drunjve dhe shkurreve mund të kufizojë intensitetin e dritës, varësisht nga përmasat dhe format, si dhe llojet e gjetheve dhe distanca nga ndërtesat.

Ndriçimi artificial:

- Disa aktivitete shkollore në mënyrë të domosdoshme kërkojnë ndriçim të duhur artificial, në veçanti gjatë kohës së dimrit dhe në fund të ditës apo gjatë ditëve me re.
- Instalimi i pajisjeve të ndriçimit gjithashtu mund të mundësojë zgjatjen e orëve të punës (ndërrimet e dyfishta, mësimet e natës, takimet...);
- Lloji i pajisjeve të ndriçimit që duhet të instalohen varet nga intensiteti i dritës që kërkohet dhe nga lloji i aktivitetit përkatës. Megjithatë tubat fluoreshente, krahasuar me poçet inkandeshente, kanë përparësinë e reflektimit të ulët të sipërfaqeve, efikasitet të lartë, shpërndarje të mirë të dritës, prodhim të ulët të nxehtësisë;

Projektuesi duhet të këtë në vëmendje projektimin për një mjedis higjienik. Për këtë qëllim ai duhet të ketë parasysh

Hapësirat e brendshme të sanitarisë

Cilësia e mjedisit higjienik në shkollë varet nga projektimi, përzgjedhja e pajisjeve për shfrytëzim nga nxënësit, personeli (mësimdhënës, administrativë, shërbyes), si dhe nga mysafirët, por edhe nga mirëmbajtja dhe menaxhimi i shfrytëzimit të këtyre pajisjeve. Këto pajisje, nëse mirëmbahen mirë do të sigurojnë nivelin e tualeteve, banjave dhe furnizimit me ujë që kërkohet brenda ndërtesave shkollore. Përveç këtyre ekzistojnë edhe komponentët e jashtëm të këtyre shërbimeve, menaxhimi i mirë i të cilave është thelbësor për higjienën dhe funksionimin e vazhdueshëm të pajisjeve të brendshme.

Trajtimi i ujërave të zeza dhe atmosferike

Në përgjithësi, ekzistojnë 2 lloje të ujërave që duhet të trajtohen dhe të qiten jashtë ndërtesave shkollore. Këto janë: (i) të gjitha ujërat e tualeteve; dhe (iii) ujërat nga shirat, nga kulmet apo hapësirat e jashtme.

Të gjitha ujërat mund të dërgohen drejtpërdrejtë në rrjetin e kanalizimit. Rekomandohet që ujërat atmosferike nga kulmet të grumbullohen në një rezervuar të ndarë në mënyrë që ai ujë të shfrytëzohet për ujitjen e hapësirave të gjelbëruara në oborr të shkollës.

Për ruajtjen e ujit kërkohet cisterna e prodhuar nga çeliku i galvanizuar apo nga material tjetër që është rezistues dhe që plotëson kushtet higjienike për depozitimin e ujit të pijshëm. Pozita apo vendndodhja e këtyre cisternave do të rregullohet në atë mënyrë që të ekzistojë rënia e lirë e duhur kurdo që kërkohet për furnizim me ujë të të gjitha pjesëve të shkollës.

Drenazhimi i lokacionit

Drenazhimi i lokacionit të shkollës përfshinë shkallëzimin e përgjithshëm të lokacionit, sistemin e drenazhimit të ujërave pas shtrëngatave dhe atë të ujërave atmosferike.

Sistemi i drenazhit të ujërave atmosferikë

I tërë drenazhimi i lokacionit nga ndërtimet e reja apo nga ndërtesat ekzistuese lidhen me sistemin ekzistues të drenazhimit të ujërave atmosferikë dhe të gjitha rrjedhat e ujërave atmosferikë nga hapësirat e shtruara (terrenet sportive, ato për lojërë, rrugët, vend parkimet, dhe shtigjet) mbledhen në kanalet për drenazhim të ujërave atmosferike apo në kanale të hapura dhe do të barten përmes gypave nëntokësorë në vendgrumbullim të ujërave, në rezervuare të ujërave apo në rrjetin e kanalizimit të qytetit.

Drenazhimi i kulmit

Kulmi i ndërtesave duhet të planifikohet në atë mënyrë që të mundësojë drenazhimin e ujërave atmosferike: (i) kulmet e rrafshëta nga pllakat e çimentos duhet të kenë pjerrtësinë minimale prej 1% që shkon drejt pikave dalëse dhe tek gypat vertikalë të drenazhimit; (ii) kulmet e pjerrëta të ndërtesave disakatëshe duhet të kenë ulluqet dhe gypat vertikalë të drenazhimit, të lidhura me sistemin kryesor të drenazhimit në lokacion.

Në lidhje me sigurinë e objektit ndaj zjarrit duhet të kihet parasysh

Ajrosja e mjediseve

Ajrosja e mjediseve të shkollës përmirëson shumë higjienën brenda objektit, duke eliminuar lagështinë, lagështinë nga muret, nga ndarjet e hapësirave dhe nga hapjet, si dhe duke larguar insektet që bartin sëmundje. Përveç kësaj, lëvizjet e ajrit ndihmojnë në zvogëlimin e disa sëmundjeve, siç janë mukozat, duke zvogëluar temperaturën trupore, dhe rrjedhimisht duke zvogëluar djersitjen e nxënësve dhe të punonjësve përmes avullimit dhe rrymimit. Ajrosja e ndërtesave shkollore mund të bëhet përmes:

Sistemet dhe rregullat për mbrojtje nga zjarri

Masat paraprake që duhet të ndërmerren nga projektuesit e shkollave përfshijnë një grup masash për kufizimin e rreziqeve nga zjarri, lehtësimin e evakuimit të shfrytëzuesve të ndërtesave dhe lehtësimin e qasjes së ekipeve të shpëtimit. Kjo përfshinë metoda të ndryshme të mbrojtjes dhe sisteme të sigurisë ndaj zjarrit të cilat janë përshkruar shkurtimisht në vijim:

Qasja në lokacion

Për sa i përket mbrojtjes nga aksidentet, lokacioni i shkollës duhet të vendoset sa më larg që është e mundur nga zonat që paraqesin rrezik nga zjarri (punëtoritë, fabrikat, depot, pompat e benzinës...), dhe rruga e qasjes për në ndërtesa duhet të jetë, së paku, 8.0 m e gjerë (të shqyrtohet me shërbimet lokale të shpëtimit) dhe duhet të jetë e përshtatshme për vetura dhe kamionë, përfshirë ambulancat dhe automjetet e shpëtimit të zjarrfikësve.

Tubacionet dhe hidrantët e fikjes së zjarrit: tubacionet e fikjes së zjarrit instalohen nëpër ndërtesa dhe pajisjen me valvula në mënyrë që shërbimet e zjarrfikjes dhe të shpëtimit të mund të lidhin tubat për ujë për të fikur zjarrin brenda ndërtesës. Ato mund të jenë të llojit “të thatë” që zakonisht janë të zbrazëta dhe furnizohen përmes një tubi nga pajisjet pompuese të shërbimit të zjarrfikjes dhe të shpëtimit, ose të jenë edhe të llojit të “lagësht” ku ato mbahen me plot ujë dhe furnizohen nga rezervarët dhe pompat në ndërtesë. Duhet të ekzistojë edhe një pajisje për t’i mundësuar sistemit të lagësht që të rimbushet nga pajisjet e pompimit në rast të emergjencave.

Pajisjet e fikjes së zjarrit

Hetimi automatik i zjarrit: Zbulimi i hershëm automatik dhe alarmimi i zjarrit ndihmojnë në daljen e shpejtë dhe të sigurt të personave, apo e trajtojnë zjarrin kur ai gjendet në fazën e parë të zhvillimit. Kjo do të mundësojë thirrjen e ndihmës profesionale pa ndonjë vonesë gjë që do të ulte dëmtimet e shkaktuara të ndërtesës dhe përmbajtjes së saj. Shembuj të këtyre pajisjeve përfshijnë pajisjet mbaj-dhe-hap të derve kundër zjarrit, sistemet e nxjerrjes së tymit apo sistemet e ajrosjes, sistemet e presimit dhe valvulave të zjarrit në tubacionin e ajrosjes.

Shenjat dhe njoftimet: Të gjitha shenjat dhe njoftimet duhet të vendosen në mënyrë që ato të shihen dhe të kuptohen me lehtësi. Shenjat duhet të përdoren, aty ku është e nevojshme, për t’ju ndihmuar personave që t’i identifikojnë rrugët e daljes dhe daljet, të gjejnë pajisjet e zjarrfikjes dhe telefonat emergjent në rast të zjarrit. Lajmërimet duhet të përdoren, aty ku është e nevojshme, për të dhënë udhëzime se si të përdoren pajisjet kundër zjarrit, rreth veprimeve që duhet të ndërmerren në rast të zjarrit dhe informatave rreth shërbimit kundër zjarrit dhe të shpëtimit.

Ndriçimi emergjent: ndriçimi emergjent nevojitet për të treguar dhe ilustruar në mënyrë të qartë rrugët dhe shenjat e daljes, përfshirë këtu rrugët e daljes që janë jashtë ndërtesës, për të siguruar që ndryshimet e kateve dhe të drejtimeve të tregohen dhe për të siguruar që pikat e thirrjes së alarmit të zjarrit dhe pajisjet e zjarrfikjes të mund të gjenden me lehtësi.

Kontrolli i tymit: ekzistojnë katër arsye kryesore për kontrollimin e shpërndarjes së tymit, që janë, mbrojtja e rrugëve të daljes, asistimi i fikjes së zjarrit, kufizimi i rrezikut ndaj shfrytëzuesve të objektit në sallat që nuk janë në afërsi të zjarrit dhe minimizimi i dëmit nga tymi ndaj përmbajtjes së ndërtesës. Në shumicën e rasteve kjo arrihet përmes përdorimit të masave të përmbajtjes, siç janë dyert dhe muret. Megjithatë në disa rrethana sistemet e ajrosjes të tymit apo sistemet e shtypjes mund të jenë të nevojshme apo të dëshirueshme.

Ndihma e parë e zjarrfikjes: fikësit e zjarrit duhet të përmbushin funksionin për sigurinë e jetës nëse mënyra më e sigurt e ikjes nga efektet e zjarrit është fikja e tij. Ata gjithashtu kanë një rol të dukshëm në mbrojtjen e pronës, nëse zjarri mund të luftohet para se të bëhet shumë i madh. Llojet e ndryshme të fikësve të zjarrit përdoren për llojet e ndryshme të zjarrit: në tabelën 3.6 më poshtë janë paraqitur llojet kryesore të fikësve të zjarrit, llojet e zjarrit për të cilët ata janë të përshtatshëm dhe lokacionin e përgjithshëm të pajisjeve të zjarrfikjes.

Kur rreziku nga zjarri nuk është i kufizuar në ndonjë lokacion të caktuar, p.sh. zjarret e kategorisë A, fikësit e zjarrit duhet të vendosen në rrugët e daljes, afër daljes nga dhoma apo në dysheme, apo në daljen e fundit nga ndërtesa.

Sistemet e spërkatjes: Sistemet e spërkatjes përfshijnë njehsorët e rrjedhjes të lidhur me alarme, dhe nëse instalohet një sistem i fikjes së zjarrit në tërë ndërtesën do të kenë një bonus shtesë që janë hetuesit e nxehtësisë në tërë shkollën që mund të shpijnë në kursime të përgjithshme. Megjithatë, ky sistem mund të jetë shumë i shtrenjtë dhe projektuesi mund të duhet të zgjedhë një tipar të kufizuar të kompensimit për të trajtuar rreziqet specifike përmes mbrojtjes së vetëm një ndërtese apo vetëm ndonjë pjese të ndërtesës.

Dyert kundër zjarrit: dyert e vendosura në muret rezistuese ndaj zjarrit apo në muret ndarëse duhet të jenë dyer kundër zjarrit, të dizajnuara që të rezistojnë kalimin e zjarrit dhe të tymit. Dyert e zjarrit përdoren në rrugët e daljes për të ndarë korridoret e gjata duke siguruar kështu që jo më shumë se një pjesë e shkurtë e korridorit që shpie në dalje të mbushet me tym gjatë ndonjë zjarri. Dyert e zjarrit duhet të përdoren për të ndarë shkallët nga rrugët e qarkullimit në mënyrë që shkallët të mbrohen nga hyrja e tymit.

Dyert e zjarrit në përgjithësi do të kenë panele të qelqit për t'i ndihmuar shfrytëzuesve për të parë më tej, përfshirë ata me nevoja të veçanta, gjatë lëvizjes së tyre. Panelet e pamjes gjithashtu do të jenë të dobishme në rast të zjarrit për t'ju mundësuar njerëzve që të shohin nëse hapësira nga ana tjetër është prekur nga tymi apo jo. Përdorimi i qelqit varet në atë nëse ai ofron izolim si dhe integritet për nivelin e duhur të rezistencës ndaj zjarrit për së paku 60 minuta..

Mbrojtja nga rrufetë

Sistemi për mbrojtje nga rrufetë është një masë e rëndësishme mbrojtëse që duhet të kihet parasysh nga projektuesit e shkollave. Sistemi është i projektuar për të mbrojtur ndërtesat dhe përmbajtjen e tyre nga dëmtimi për shkak të goditjeve, duke i ndërprerë ato dhe duke e përcjellë pa rrezik rrymat e tyre të tensionit të lartë në tokë. Shumica e sistemeve për mbrojtje nga rrufetë përmbajnë në vete një rrjet të përbërë nga tri elemente. Ato janë:

- shufrat rrufepritëse ose terminalët ajrore që zakonisht janë të vendosura në ose përgjatë pikave më të larta të strukturës së kulmit, dhe të lidhura elektrikisht me njëra tjetrën përmes përçuesve të lidhur;
- përçuesit metalik të vendosur teposhtë që gjithashtu quhen “të drejtuar teposhtë”, të cilët janë të lidhur në rrugën më direkte për te njëri ose më shumë vendshkarkues në tokë. Lidhjet për

elektrodat e vendosura në tokë nuk duhet të kenë vetëm rezistencë të ulët, por duhet të kenë edhe vetë-induktancë të ulët;

- elektrodat e tokëzimit ose "tokëzimi" i bërë nga shufrat, pllakat metalike ose rrjetat.

Objekti duhet të adresojë edhe kërkesa të posaçme


Projektimi për personat me nevoja të veçanta

Projektimi/dizajnimi i ndërtesave shkollore duhet të siguroj qasjen e papenguar, lëvizjes, qëndrimin dhe mësimnxënies të nxënësve me nevoja të veçanta, referuar legjislacionit perkates, per kete kategori. prandaj, projektuesit duhen të bazohen në këtë legjislacion por edhe në këtë udhëzues ku janë paraqitur kushtet teknike më specifike për ndërtesat shkollore. Llojet e nevoja të veçanta për të cilat mund të përkujdesemi në një shkollë standarde do të kufizohen, për arsye praktike, në ato me nevoja të veçanta në lëvizje, humbje të dëgjimit që korrigjohet me pajimet për dëgjim, dhe humbja e pjesërishme ose e tërësishme e të parit, pas trajnimit adekuat. Mirëpo, kategoria e fundit nuk do të jetë në gjendje të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet shkollore të mësimdhënies ose të mësimnxënies.

Personat me nevoja të veçanta mund të jenë nxënës, arsimtarë, mysafirë ose personel. Problemi i tyre kryesore është reduktuara në lëvizshmërinë e tyre për arsye se ata shfrytëzojnë karrocet e invalidëve, patericat ose bastunët. Ky problem kërkon dimensionim të veçantë të zonave të qarkullimit, hapësirave të dyerve, pajisjeve sanitare, shtigjeve të evakuimit dhe hapësirave të klasave për t'i akomoduar personat me nevoja të veçanta.


Dimensionet e personave me nevoja të veçantë nëpër karrocet e invalidëve duhet të kihet parasysh nga projektuesit gjatë caktimit të madhësisë së hapësirave të shkollës dhe qarkullimit. Karrocet e invalidëve kanë dimensione të ndryshme, sipas moshës së nxënësve dhe llojit të artikullit. Megjithatë, dimensionet e mëposhtme, përkujdes me dimensionet mesatare të personave të rritur, e që duhet të merren parasysh

- Gjerësia e karriges përgjithësisht është mes 600 dhe 700 mm
- Gjatësia është mes 1000 dhe 1250 mm
- Rrezja e jashtme është mes 1300 dhe 1500 mm



Hapësira deri ku mbërrijnë personat me nevoja të veçanta në karrocet e invalidëve definohet

- Mes 230 dhe 300 mm mbi nivelin e dyshemesë;
- Mes 1100 dhe 1300 në lartësi;
- Mes 300 dhe 400 mm nga pjesët anësore të karriges;



Kërkesat teknike kundrejt projektit konstruktiv.

Hartimi i projektit konstruktiv duhet të mbajë në konsideratë propozimin e zgjidhjeve më të përshtatshme, referuar konceptit të përgjithshëm arkitekturor dhe funksionit të ambientit.

Materialet, teknikat dhe teknologjitë e propozuara duhet të respektojnë kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Në mungesë të tyre projektuesi duhet t'u referohet Eurokodeve aktuale në përdorim.

Projekti konstruktiv duhet të respektojë kërkesat e jetëgjatësisë së projektimit, ngarkesave dhe rregullave të projektimit për sa i përket durabilitetit (Klasa e durabilitetit), në funksion të kushteve të ekspozimit të tij, bazuar në Eurokode.

Hartimi i projektit konstruktiv duhet të mbështetet në studimin gjeologjik – inxhinierik të truallit dhe studimin sizmologjik.

Mbulesa

Aktualisht objekti 3 katesh, është me terrace të sheshta beton –arme.

Projektuesi duhet të projektojë një soletë të re (për shtesën anësore), të japë të gjitha detajet arkitektonike lidhur me soletën : vendosja e kasetës së shkarkimit dhe ullukët vertikalë si dhe detaje të tjera të domosdoshme për zbatimin e punimeve duke qenë se një pjesë e ujërave të shiut janë të pasistemuar dhe grumbullohen në ambientet e shkollës. Gjithashtu duhet të tregojë, numrin e ulluqeve dhe diametrat e tyre sipas normave në fuqi. Për sasinë e reshjeve do të përdoren të dhënat e Institutit Hidrometeorologjik. Në projekt të parashikohen edhe daljet e oxhakeve egzistues, pasi ato duhet të jenë funksionale.

Struktura : ‘Palester’, është e mbulluar me material plastik, i cili është shumë i demtuar dhe jo funksional. Zhurmat e mëdha që krijohen gjatë aktivitetit të kësaj palestre, si edhe zhurmat që krijohen nga materiali i mbulesës, janë kthyer në shqetësim që të gjithë banorët e objekteve përreth shkollës.

Duhet projektuar një mbulesë e re, me materiale të qëndrueshme (anti zjarr).

Soletat

Është detyrë e konsulentit, kontrolli dhe verifikimi teknik i soletave ekzistuese të objektit, në mënyrë që të parashikohet rikonstrukcioni i tyre sidomos në rastet kur ka probleme, të lidhura me degradimin e tyre dhe me uljen e aftësive mbajtëse.

Suvatimet.

Objekti 'shtese anesore 3 kat' dhe 'rikonstrukcion palestere' duhet të suvatohet nga brenda dhe jashtë. Në pjesët e dëmtuara, suvatimet e mureve dhe tavanëve do të kryhen në të gjithë sipërfaqen përkatëse duke ruajtur shtresën e parë ekzistuese ku të mundet në mure. Të gjitha shtresat e tjera në rast se janë të dëmtuara do të hiqen pa dëmtuar muret.

Përsa i përket suvatimeve të jashtme do të jenë në varësi të llojit të ndërhyrjes që parashikon projekti, nëse do të restaurohet sipërfaqja ekzistuese ose do të rishikohet e gjitha sipas konceptit të ri që kërkon fasada.

Ne palester te parashikohen edhe shtresa zë- izoluese.

Lyerja e mureve të brendshëm dhe të jashtëm

Muret e brendshëm dhe tavanet do të lyhen me hidromat, kurse pjesa e poshtme e mureve do të lyhet me bojë akrilik me ngjyrë të ndryshme ose jo nga muret, gjë e cila do të vendoset në bashkëpunim me stafin e shkollës.

Fasada

Fasada e strukture : 'Shtese anesore 3 kat' dhe 'Rikonstrukcion palestere' , të jetë e tillë që të mirëmbahet lehtë, kurse ngjyrat e fasadës të jenë të bukura, në mënyrë që objekti të bëhet më atraktive për fëmijët. Fasadat duhet të jenë të veshura me kapotë termike antizjarr. Konsulenti duhet të përcaktojë gjithashtu vendodhjen e tabelës me emrin e shkollës.

Shtresat e pllakave

Pllakat ekzistuese të dyshemesë së vjetër te strukture : 'Rikonstrukcion palestere' së bashku me llaçin e vjetër nëse është e nevojshme do të zëvendësohen nga shtresa e re e dyshemesë, me pllaka, duke patur parasysh rinivelimin e saj me llaç – çimento si dhe me shtresat e nevojshme izoluese në rastin e ambienteve që nevojiten. Dyshemetë e tualeteve dhe muret e tyre në një lartësi të caktuar, duhet të izoloohen dhe projektuesi duhet të japë detajin e izolimit të tyre. Çdo shtresë duhet të jetë e detajuar me specifikimet përkatëse.

Pllakate strukture : 'Shtese anesore 3 kat' , duhet te jene te cilesis se larte , me shtresat perkatese sipas kushteve teknike ne fuqi.

Shkallët

Është e nevojshme përcaktimi i qartë i gjendjes së shkallëve, si nga ana funksionale në lidhje me kapacitetin ashtu edhe nga pikëpamja konstruktive ose e aftësisë mbajtëse të konstruksionit në rastin e rikonstrukcionit të godinës.

Projekti duhet të përmbajë të gjitha detajet si dhe specifikimet teknike të domosdoshme për fazën e projekt zbatimit.

Dyer, dritare

Projektuesi duhet të përcaktojë që materialet që do të përdoren për strukturen : 'Shtese anesore 3 kat' dhe 'Rikonstrukcion palestere' , të jenë të cilësisë së lartë. Nëse janë propozuar dyer prej druri, ato duhet të jenë prej druri të fortë me mentesha të forta (minimumi tre për çdo derë).

Vendosja e dyerve dhe plani i hapjes së tyre të realizohet i tillë që të plotësoje kushtet e daljes së shpejt në raste emergjencash dhe standardet e vendosura nga MAS.

Përsa i përket dritareve do të jenë duralumini të cilësisë së lartë me hapje me rrotullim dopio-xham dhe me sopralluce në ambiente që e kërkojnë atë. Gjithashtu për katet e para duhet të jetë të parashikuara të gjitha normat e sigurisë pra edhe pajisja e tyre me elementet metalike mbrojtës përkatës.

Kërkesat teknike kundrejt projektit hidrosanitar.

Projektimi i Sistemit Hidrosanitar të Furnizimit me ujë dhe shkarkimeve të ujërave të ndotura dhe atmosferike të ndërtesës dhe projektimi i rrjetit inxhinierik të ujërave në zonën përreth duhet të kryhet në përputhje me projektin arkitektonik.

Sistemi hidrosanitar i furnizimit me ujë dhe shkarkimeve të ujërave të ndotura të ndërtesës dhe jashtë saj duhet të projektohet në përputhje me Kushtet Teknike të Projektimit (KTP) në Fuqi, si dhe sipas udhëzimeve të Standardeve të projektimit shtetërore dhe ndërkombëtare. Ky sistem duhet të projektohet, në përputhje me zgjidhjet e konceptuara në projektin arkitekturor dhe duke marrë në konsideratë kërkesat bashkëkohore për funksionimin e nyjeve higjieno – sanitare.

Sistemi hidrosanitar i furnizimit me ujë duhet të sigurojë prurjen e kërkuar, me presionin e nevojshëm në çdo pajisje hidrosanitare. Ky sistem duhet të garantojë furnizimin e vazhdueshëm dhe pa ndërprerje të të gjitha nyjeve sanitare, duke vendosur një rezervë ujore rreth 24 orëshe, si dhe grup presioni për sigurimin e presionit në rastet e furnizimit me ujë nga depozita.

Sistemi hidrosanitar i kanalizimeve të ujërave të ndotura duhet të mbledhë dhe largojë me vetërrjedhje ujërat e nyjeve sanitare. Nëse ka mjedise sanitare nën nivelin e linjave të rrjetit rugor, duhet të vendosen grupe presioni tip njësi kompakte me rezervuar, të cilat të lidhen direkt me linjën e shkarkimit (të ruhet hermeticiteti i sistemit të kanalizimeve, jo me pusëtë).

Nevojitet që në ndërtesë të sigurohet furnizimi me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë, duke u bazuar në zgjidhje aktuale dhe perspektive, të cilat do të shmangnin maksimalisht nevojën për ndërhyrje të mëvonshme në objekt dhe do të realizoheshin duke mbajtur në konsideratë edhe aspektet e eficensës energjitike afatgjatë.

Për llogaritjet e parametrave hidraulikë dhe gjeometrikë të sistemit, prurjet, humbjet hidraulike, presionin e nevojshëm dhe diametrat duhet të përdoren tabelat e dhëna në kushtet teknike të sipërpërmendura. Llogaritjet e parametrave hidraulikë dhe gjeometrikë të rrjetit duhet të kryhen, duke patur parasysh edhe prurjen e grupeve përzierës (mishelatorë) të ujit apo të rubinetave të pajisjeve përkatëse.

Zgjidhjet teknike të propozuara në projektin hidrosanitar duhet të respektojnë funksionin e objektit, si dhe standardet dhe normativat e detyrueshme, të përcaktuara në aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi.

Të gjithë tubacionet dhe rakorderitë e sistemeve hidrosanitare duhet të propozohen sipas standardeve dhe certifikimeve bashkëkohore ndërkombëtare.

Të nisur nga sa më sipër gjatë hartimit të projekt-zbatimit për strukturën: 'Shtese anesore 3 kat' dhe 'Rikonstruksion palestere' duhet të meren parasysh sa më poshtë:

- Të merret në konsideratë perspektiva 10 vjeçare e rritjes së numrit të fëmijëve.
- Të merret në konsideratë rrjeti ekzistues i kanalizimeve të zonave ku ndodhen objektet, por gjithashtu konsulentit duhet të marrë në konsideratë projektin e ri të kanalizimeve për këto zona, nëse ka.

Sistemi i largimit të ujërave të bardha dhe të zeza do të jetë mik.

Në përputhje me normat, konsulenti duhet të ketë parasysh numrin e fëmijëve, stafin mësimor dhe administrativ.

Konsulenti duhet të verifikojë gjendjen teknike të banjave ekzistuese dhe duhet të përgatisë projektin e detajuar si për rikonstruksionin e atyre ekzistuese ashtu edhe të shtesës eventuale të kapacitetit (numrit) të tyre.

Rrjeti i shkarkimit të ujërave të zeza do të ndërtohet me materiale bashkohore dhe në përputhje me standardet në fuqi.

Rrjeti i amortizuar i ujësjellësit do të zëvendësohet. Gjithashtu në bashkëpunim me shoqërinë e Ujësjellës Kanalizime sh.a. do saktësohet dhe gjendja e ujësjellësit ekzistues të zonës si dhe problemet e vërejtura në këtë zonë gjatë periudhës së furnizimit me ujë duke përcaktuar edhe kapacitetin depozitues për furnizim me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje gjatë ditës .

Materialet që do përdoren për rrjetin e brendshëm të ujësjellësit do jenë tuba polietileni me densitet të lartë për ujë të pijshëm me diametër dhe aftësi mbajtëse në përputhje me prurjet dhe presionet llogaritëse.

Për nyjen e marrjes nga rrjeti i zonës do të parashikohet puseta me kapak b/a, përmasat e të cilave duhet të realizohen sipas kushteve teknike dhe të sigurojnë kushte normale manovrimi dhe riparimi. Nëse është e domosdoshme, projektuesi duhet të parashikojë zëvendësimin dhe nxjerrjen jashtë pune të sistemit të vjetër të furnizimit me ujë.

Projektuesi të parashikojë në projekt/preventivin e objektit, vlerën e furnizimit dhe vendosjes së linjës së furnizimit me ujë nga pika e marrjes së dhënë nga Ujësjellës Kanalizime sh.a. Lezhe deri tek matësi i ujit.

Të parashikohet realizimi i depozitave të ujit, të nevojshme në raste emergjence si dhe lidhja e tyre në, me të paktën dy prej lavamanëve dhe nyjeve sanitareve si dhe depozitat e ujit për MNZ.

Kërkesat teknike kundrejt projektit elektrik dhe elektronik.

Projekti elektrik duhet të përshtatet me kërkesat dhe nevojat funksionale të secilit ambient.

Projekti duhet të përmbajë rrjetin e ndriçimit, ku përfshihet edhe ndriçimi i ambienteve të jashtëm dhe ndriçimi i emergjencës, rrjetin e prizave të furnizimit me energji, të prizave të UPS, rrjetin e furnizimit me energji elektrike nga OSHEE, sistemin e telefonisë, rrjetit LAN, sinjalizimit të zjarrit, sistemin video, acces-control, sistemin e vëzhgimit me kamera, sistemin e rrufepritjes etj., në harmoni me kërkesat e projektit arkitekturor.

Pozicionimi i ndriçuesve për secilin ambient duhet të përputhet me konceptin arkitekturor të përgjithshëm, në përputhje me funksionin e ambientit dhe standardet kundrejt tij.

Ndriçuesit e propozuar duhet të shmangin elementët e rrezikshmërisë, emetimin e lëndëve të rrezikshme për shëndetin, përdorimin materialeve që shkaktojnë mbejtje të dëmshme për jetën dhe shëndetin e përdoruesve të ambienteve.

Ndriçimi në ambiente duhet të jetë shpłodhës dhe plotësojë normativat e detyrueshme nga tipologjia funksionale e tyre. Shpërndarja e ndriçuesve në ambient duhet të përshtatet me kërkesat funksionale të tij, duke ruajtur sipas rastit një shpërndarje të njëtrajtshme të dritës, apo duke shtuar ndriçuesat pranë tavolinave, ose zonave të punës. Kjo zgjidhje duhet gjithsesi të përmbushë kërkesat nominale të ambientit për ndriçim, sipas tipologjisë, pa cënuar konceptin e përgjithshëm të pasqyruar në projektin arkitekturor mbi estetikën, zgjidhjen e tavanëve, mureve dhe hapsirave të punës dhe ndriçimin e përgjithshëm të interierit. Tipologjia, estetika, këndi i hedhjes së dritës dhe gjeometria e secilit ndriçues duhet të përcaktohet në bashkëpunim me projektuesin arkitekt duke mbajtur në konsideratë lartësinë e ambientit dhe tavaneve të varur (në rast se janë propozuar). Drita ideale duhet të vijë në tavolinën e punës me kënd anësor dhe jo pingul. Shkëlqimi i sipërfaqeve duhet të kufizohet.

Pavarësisht referencave më sipër, nisur nga specifikat e veçanta të secilit ambient funksional, mbetet në gjykimin e projektuesit përdorimi i një standardi minimal ndriçimi, ose një tjetri, bazuar në kërkesat e saktësuara për secilin ambient, në përputhje me veprimtarinë dhe proceset e punës, për të cilët është projektuar.

Vendosja e prizave elektrike, Lan, sistemeve audio video etj. duhet të përputhet me hapsirat e punës të propozuara nga arkitekti në projektin e mobilimit.

Në tërësi në hartimin e projektit do të mbahen parasysh këto kërkesa për projektimin dhe zbatimin e rrjetit elektrik dhe elektronik:

Të gjithë instalimet elektrike, kabllo dhe ndriçuesit, çelësat, prizat etj. duhet të jenë hermetikë.

Ndriçimi elektrik duhet të zbatohet sipas normat e CE.

Sistemi elektronik duhet të konceptohet me server (servera) qendror të veçantë.

Në projektin elektrik duhet të parashikohet edhe instalimi i ndriçimit të emergjencës, në rastet e shkeputjeve të rrymës, apo emergjence të çfarëdo lloji.

Në ndërtesë duhet të parashikohet projektimi dhe instalimi i sistemit të tokëzimit dhe mbrojtjes atmosferike.

Në ndërtesë duhet të parashikohen sisteme elektrike dhe elektronike të nevojshme për mirëfunksionimin e ndërtesës si institucion publik. Krahas sa më sipër, të shqyrtohet mundësia e integritit të burimeve të rinovueshme të energjisë.

Rikonstrukcioni i objekteve duhet të përfshijë edhe instalimin e ri elektrik, telefonik dhe rrjetin e internetit në laboratorin e informatikës dhe zyrave të administratës.

Konsulenti duhet të parashikojë ndriçimin e ambienteve me ndriçues me fuqi të mjaftueshme për të garantuar një ndriçim në përputhje me normat në fuqi, dhe një numër të mjaftueshëm prizash për secilin ambient, sipas destinacionit të tyre. Projektuesi duhet të japë detajin e fiksimit të ndriçuesve si dhe dimensionet e elementeve në të cilat ato do të kapen.

Panelet e komandimit të vendosen të rinj sipas standardeve bashkëkohore.

Në këto kushte projektuesi duhet të parashikojë nqs nevojitet dhe instalimin e rrjetit elektrik trefazor me fuqi të tillë që të sigurojë funksionim normal të sistemit elektrik me të gjitha pajisjet e saj.

Projektuesi duhet të sigurojë Miratimin e projekteve elektrike në OSHEE, si dhe të përcaktojë edhe pikën e lidhjes me energji elektrike, nga rrjeti i fuqisë (kabina ose transformatori i zonës).

Projektuesi duhet të parashikojë vendosjen e matësit elektrik trefazor, dhe vlerën e përafërt të shtrimit të kablilit nga sahati deri te pika e lidhjes së miratuar.

Projekti elektrik të jetë i shoqëruar me licencën e noteruar të inxhinierit elektrik, e cila do të shërbejë për procedurat e mëtejshme për miratimin e pikës së lidhjes me OSHEE -n. Në projekt-preventiv duhet të parashikohen edhe llambat me bateri të karikueshme, në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike.

Rrjeti telefonik dhe kompjuterik

Në objekt të shikohet mundësia e sistemit telefonike të godinës që të mund të përdoret në çdo moment. Godina duhet të jetë e pajisur me sistem telefonik, rrjetin data dhe sistemi vëzhgimit me kamera CCTV, shoqëruar me sistemin e kontrollit të hyrje/daljeve “access control”.

Sistemi elektrik, ndriçimi i emergjencës dhe sigurisë.

Ndriçuesit luminisht dhe prozhektorët të zëvendësohen me ndriçues led, si ndriçues më ekonomik.

Ndriçimi i emergjencës duhet të futet automatikisht në punë dhe të ketë një kohë pune të paktën 1 orë në rast se stakohet tensioni. Ndriçimi i emergjencës dhe i sigurisë duhet të vendoset në ambientet e mëposhtme:

- Korridore, të cilat shërbejnë edhe si rrugë largimi emergjence;
- Dhoma që shërbejnë si pika grumbullimi;
- Në ambientet që nuk kanë dritare;

Projektuesi duhet të parashikojë ndriçimin e dhomave me ndriçues me fuqi të mjaftueshme për të garantuar një ndriçim në përputhje me normat në fuqi, dhe një numër të mjaftueshëm prizash për secilin ambient, sipas destinacionit të tyre.

Në projekt-preventiv duhet të parashikohen edhe ndriçuesit e emergjencës, në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike.

Kërkesat teknike kundrejt projektit mekanik

Projekti i sistemit të ngrohje – ftohjes dhe ventilimit duhet të përfshijë:

Llogaritjet e ngarkesave termike të nevojave për ngrohje – ftohje të secilit ambient dhe nevojave të veçanta të gjithësecilit prej tyre. Projekti i ngrohje/ftohjes/ventilimit duhet të mbështetet në normativat e përcaktura në Standartet ASHRAE, në të dhënat klimatike për qytetin e Lezhës, normat ndërkombetare, si dhe normat Evropiane, apo çdo standard tjetër të pranuar në Republikën e Shqipërisë.

Hartimin e projektit të zbatimit të instalimeve të brendëshme të sistemit të ajrit të kondicionuar.

Hartimin e preventivit të sistemit të ajrit të kondicionuar me zëra pune.

Specifikimet teknike për të gjithë materialet sipas normave të prodhimit të CE dhe pajisjet që do të përdoren nga projektuesit gjatë hartimit të projektit në fjalë.

Relacionin teknik të hollësishëm për zbatimin me korrektësi të punimeve të projektit.

Sistemi i propozuar nuk duhet të bjerë ndesh me funksionin e ndërtesës. Si i tillë, komforti termik, qarkullimi i mirë i ajrit dhe lagështia relative e krijuar në ambient është shumë e rëndësishme. Zgjidhjet për sistemin e ngrohjes, ftohjes dhe ventilimit duhet të përfshijnë të gjithë ambientet, duke ruajtur parametrat e këshillueshëm për tipologjinë e secilit ambient, në përputhje me nevojat funksionale të tij.

Projekti mekanik duhet të harmonizohet me konceptin e përgjithshëm arkitekturor të shprehur në projektin përkatës. Krahas sa më sipër, të shqyrtohet mundësia e integritit të burimeve të rinovueshme të energjisë për ngrohje dhe përdorimit të sistemeve me ndikim minimal në mjedis.

Sistemi i ngrohje-ftohjes, do të realizohet nëpërmjet sistemit qendror. Sistemi i ngrohjes do të bëhet sipas standarteve që kërkon shërbimi spitalor.

Kërkesat teknike kundrejt projektit të mbrojtjes nga zjarri

Projekti për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin duhet të realizohet në nivel godine në bazë të standardeve dhe normave lokale, si dhe ato të vendeve të Komunitetit European. Sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit duhet të respektojë të gjitha kërkesat e detyrueshme shtetërore që kanë të bëjnë me normat / standardet që janë në fuqi aktualisht në Shqipëri si dhe normat Evropiane.

Ligjet, rregulloret, normat dhe standardet, mbi të cilët duhet të hartohet projekti, objekt i kësaj detyre projektimit janë paraqitur në vijim: - Ligji nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"; - Rregullore "Mbi masat e mbrojtjes kundër zjarrit në projektimin e ndërtesave të çdo lloji "Vendim nr.162 datë 19.4.1965, e ripunuar; - Udhëzim i Ministrisë së Punëve të Brendshme nr.425

date 24.7.2015 “Për pranimin, administrimin e dokumentacionit teknik dhe grafik të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dhe lëshimin e akteve teknike”.

Projektimi i masave për mbrojtjen kundër zjarrit dhe shpëtimit nuk duhet të trajtohen të ndara nga pregatitja e projekteve specifike; projektit arkitekturor, konstruktiv, hidrosanitar, elektrik dhe mekanik. Masat e nevojshme për mbrojtjen nga zjarri duhet të reflektohen edhe në projektet më sipër cituar, në përputhje me udhëzimet dhe zgjidhjet e trajtuara në projektin e mbrojtjes kundra zjarrit.

Në projektin e mbrojtjes kundra zjarrit duhet të përfshihen të gjitha masat aktive dhe pasive, për mbrojtjen nga zjarri të ndërtesës që projektohet. Relacioni teknik i mbrojtjes nga zjarri duhet të përmbajë minimalisht të dhënat sipas pikës 5 të Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.425 date 24.7.2015 “Për pranimin, administrimin e dokumentacionit teknik dhe grafik të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dhe lëshimin e akteve teknike”.

Kërkesat kundrejt raportit dhe auditimit të eficensës energjitike.

Mbështetur në VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 (hyrja në fuqi 21.05.2015) “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e azhurnuar, pjesë e dokumentacionit për marrjen e Lejes së Ndërtimit duhet të jetë edhe projekti i eficensës energjetike, në rastet kur është e detyrueshme me ligj.

Pjesë e dokumentacionit të projektimit duhet të jetë edhe Raporti mbi eficensën e energjitike të ndërhyrjes së propozuar. Projekti i propozuar dhe specifikimet teknike duhet të përmbushin kriteret për eficensën e energjisë, në përputhje me propozimet dhe masat e reflektuara në këtë raport.

Kur projektohet një ndërtesë e re ose kur një ndërtesë duhet t'i nënshtrohet një rinovimi të rëndësishëm, subjekti që ka apo do të ketë në pronësi apo përgjegjësi administrimi këtë ndërtesë, duhet të marrë në konsideratë zbatimin e kërkesave të Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes së performancës së energjisë së ndërtesave dhe të analizojë mundësinë e përdorimit të sistemeve me një performancë të lartë të energjisë, të parashikuara në Ligjin 116/2016 “PËR PERFORMANCËN E ENERGISË SË NDËRTESAVE” neni 8 e vijues.

Hartimi i propozimeve të zgjidhjeve teknike në respektim të kriterëve të eficensës energjitike të ndërtesës së parashikura, duhet të kryhet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet të gjithë specialistëve të përfshirë, më qëllim që në të gjithë projektet specifike të mbahen në konsideratë kriteret e eficensës energjitike, për arritjen e një performancë sa më të mirë energjitike të të gjithë ndërtesës.

Hartimi i Raportit të eficensës energjitike duhet të kryhet në përputhje me metodologjinë kombëtare të llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa, sipas nenit 5 të Ligjit 116/2016 më sipër cituar.

Gjatë procesit të projektimit duhet paraprakisht të kryhet vlerësimi i mundësisë së përdorimit të sistemeve alternative me eficensë të lartë energjie. Gjatë vlerësimit teknik të mundësisë së përdorimit të sistemeve alternative me eficensë të lartë energjie, duhet të merren në konsideratë çështjet mjedisore dhe ekonomike.

Projekti i propozuar dhe specifikimet teknike duhet të përmbushin kriteret për eficensën e energjisë, në përputhje me propozimet dhe masat e reflektuara në këtë raport.

Kërkesat teknike kundrejt shërbimeve që i takojnë nëntokës.

Shërbimet që i takojnë nëntokës duhet të paraprijnë procesin e projektimit. Hartimi i tyre duhet të respektojë kuadrin ligjor në fuqi dhe eurokodet aktuale.

Kërkesa të përgjithshme.

Gjatë hartimit të projektit do të mbahet kontakt i vazhdueshëm me autoritetet e Institucionit dhe grupin e punës së përpilimit të detyrës së projektimit, i cili do të vendosë në dispozicion të grupit të

punës për hartimin e projektit një fotokopje të dokumentacionit tekniko – juridik që disponon, në shërbim të procesit të projektimit;

Autorët e projekteve duhet të marrin përsipër përveç realizimit të planeve dhe skicave (vizatimet teknike) të përshkruajnë në mënyrë të detajuar të gjitha zërat e punimeve që do të përmbajë preventivi;

Projekti të shoqërohet me një relacion teknik ku të përshkruhen saktë zgjidhjet e ofruara teknike, avantazhet dhe prioritetet e tyre, materialet dhe paisjet e përdorura, vetitë dhe karakteristikat e tyre;

Gjithashtu, grupi i projektimit duhet të marrë përsipër konsultat me zbatuesin si dhe predispozicionin për tu angazhuar në ndryshimet e mundëshme që mund të lindin, si pasojë e situatave të paparashikuara apo shmangieve si evoluim i kërkesave të investitorit në procesin e realizimit;

Projekti duhet të përfshijë dhe specifikimet teknike për materialet që do përdoren, por projektuesi duhet të ketë kujdes të mos përcaktojë markën apo çdo detaj tjetër që identifikon prodhuesin;

Në përgatitjen e projekt–preventivit të merret në konsideratë funksionimi, komoditeti dhe estetika e ambienteve të tij. Gjithashtu, preventivat e punimeve të jenë të ndara me grupe zërash pune, spas ambienteve që të mund të kryhen në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri.

Kërkesa të veçanta.

Zgjidhjet dhe ndërhyrjet e propozuara duhet të bazohen në kritere të tilla:

Të kenë ndikim minimal në mjedis.

Të jenë propozuar në përputhje me funksionin e ambientit.

Të respektojnë Legjislacionin në Fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë këtu legjislacionin në fushën higjieno – sanitare dhe legjislacionin në fushën e mbrotjes nga zjarri.

Çdo ndërhyrje të jetë e mirëjustifikuar nga pikëpamja teknike dhe funksionale.

Shërbimet e kërkuara sipas fazave.

Grupi i projektimit duhet të kryejë shërbimet e mëposhtme:

Hartimin i projekt preventivit duhet të përfshijë fazat si vijon:

Kosto totale do të përcaktohet nga preventivi përfundimtar i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike, relacionin, si dhe duke marrë parasysh dhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standardet e pranuar.

Në hartimin e preventivit çmimet e referencës do të jenë sipas legjislacionit, mbështetur në Manualin Teknik të Çmimeve në fuqi, **ne sistemin e integruar ne e –albania** . Për zërat e punimeve që nuk gjenden në manual, projektuesi duhet të hartojë analiza përkatëse, të cilat do ti bashkëlidhen të detajuara projekt zbatimit, kjo për të siguruar kursimin dhe eficientën e përdorimit të fondeve.

Faza I - Analiza e detyrës së projektimit / përcaktimi i bazës së projektit.

Faza III - Projektideja përfundimtare.

Faza IV - Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit.

Faza V - Projekti i zbatimit.

Faza VI - Preventivi përfundimtar bazuar ne manualin 2023.

Shërbimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis duhet të përfshijë fazat si vijon:

Faza I - Aplikimi për VNM paraprake.

Shërbimi Topografik duhet të përfshijë fazat si vijon:

Faza I - Analiza e detyrës së projektimit/precaktimi i bazës së projektit

Faza II - Planet e pozicionimit dhe rievimit

Faza IV - Vizatime te piketave

Faza V - Projekt zbatimi Piketat për qëllime planifikimi

Shërbimet që i takojnë nëntokës dhe punimeve në themele duhet të përfshijnë fazat si vijon:

Faza I.

1. Qartësimi i kërkesave të projektit

2. Përcaktimi i strukturës së tokës nga dokumentet ekzistuese, duke specifikuar dhe prezantuar strukturën e nëntokës, sipas testeve të kërkuara.

Faza II.

Analizimi dhe prezantimi i rezultateve të testeve laboratorike dhe në terren për strukturën e nëntokës,

Vlerësimi i gamës së lëkundjeve të tokës me përmbajtje uji,

Vlerësimi i nëntokës, specifikimi i parametrave kryesorë në strukturën e tokës.

Faza III.

Paraqitja e rekomandimeve për qëndrueshmërinë e themeleve dhe presionet e lejuara në tokë, në rast të veçantë propozohet dhe dimensionimi i themelit.

Deklaratë mbi cedimet e pritura nga realizimi i veprës për të realizuar shërbimet bazë të përfshira në projektin final për veprat inxhinierike sipas nenit 39.

Udhëzimet për të gërmuar themelet dhe për të mbajtur edhe strukturën e thatë, edhe kontrollimin e ndikimit të projektit në strukturat ngjitur.

Standarde në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për personat me aftësi të kufizuar, të verbrit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihen parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për planifikimin e territorit” I ndryshuar .

Realizimi i Projektit

Projekti i paraqitur për struktura ‘Rikonstrukcion, shtese anesore 3 Kat, rikonstrukcion i palestres, rikonstrukcion i pjesshem i sistemit elektrik, sistemi i pjesshem i oborrit te Shkolles 9 – Vjeçare, 3 Kat, “Gjergj Fishta” Lezhe,

Duke iu referuar VKM Nr. 354, datë 11.5.2016 “Për Miratimin e manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Terriori, Projektim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim” duhet të kalojë në këto faza:

Faza e I: Analiza e detyrës së projektimit e cila përfshin:

Shërbimet bazë:

- Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit.
- Dhënia e konsultave mbi nevojën edhe shkallët e shërbimit.
- Përmbledhja e rezultateve

Shërbimet të veçanta

- Studimi i gjendjes
- Analiza e vendodhjes
- Planifikimi i punës
- Verifikimi i rëndësisë së mjesisidit
- Verifikimi i pajtueshmërisë me mjedisin

Faza e II: Projekt-ideja përfundimtare (sistemet dhe planifikimi i integruar)

Projekt Idea duhet të realizohet në jo më pak se një variant, ku për secilin variant duhet të paraqitet relacioni teknik mbi ndërhyrjet, projekti i ndërhyrjeve, kostoja e ndërtimit për secilin variant dhe specifikimet teknike. Paraqitja e varianteve duhet të bëhet në bazë të ndërhyrjes, të rezultateve të vlerësimit të koston së ndërtimit dhe asaj të shfrytëzimit.

Varianti me treguesit më social - ekonomik dhe teknik që do përzgjidhet , do vazhdoj procedurën e hartimit të projekt zbatimi.

Faza e III: Projekt për miratimin e lejës së ndërtimit.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, i cili duhet të mbështetet në ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” I ndryshuar .

Faza e IV: Projekt i Zbatimit

Të kryhet hartimi i Projekt - Zbatimit të objektit ‘me përmbajtjen si më poshtë :

- Raporti Teknik
- Topografinë e gjendjes ekzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjëndjen e sotme (me leje dhe pa leje)
- Projektin arkitektonik: Relacion arkitektonik i objektit, Fasadat, Planimetritë ekzistuese dhe të reja të objektit, Prerjet e godinës, Plan mobilimin e ambienteve, Plani i mbulesës, etj;
- Projektin e zbatimit/konstrukcionin të objektit: Plani i strukturave dhe detajet, Plani i themeleve, etj.
- Projekt Zbatimin e instalimeve hidrosanitare, të kanalizimeve
- Projekt Zbatimin e instalimeve elektrike, të shoqëruara me licencën e noteruar të projektuesit

- Projekt Zbatimin e instalimit te sistemit të ngrohjes, të mbrojtjes kundër zjarrit të strukturës të miratuar nga Drejtoria e Zjarrit dhe Shpëtimit
- Projektin e eficenses energjitiqe , dhe miratimin perkates nga Ministria
- Projektin e sistemit dhe të gjelbërimit të oborrit, projektin e ambienteve të lojrave;
- Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen.
- Grafikon e punimeve te detajuar sipas zërave të punës
- Rekomandime për materialet e ndërtimit që do të përdoren
- Relacionin gjeologjik për shtesat e reja të parashikuara,
- Relacion sismik
- Eficensa energjitiqe
- Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)
- Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujërave të shiut
- Analizat teknike të çmimeve të zërave të punime që nuk janë në manual;
- Plan organizimim e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve që do jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur në grafikun e punimeve;
- Licencë të firmës projektuese, licencë të ekspertit mjedisor dhe ekstrakt i regjistrit tregtar.

Rekomandime për projektuesin

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me zonën ku ndodhet shkolla. Sistemin ekzistues të largimit të ujërave, Sistemin e furnizimit të zonës me ujë të pijshëm, Sistemin ndriçues rrugor, distancat e lejuara si dhe kriteret urbane të zonës në fjalë.
- Projektuesi duhet të përdore studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia e Lezhe , seksioni i Urbanistikës dhe nga kadastra.
- Konsulentit do t’i vihet në dispozicion nga Drejtoria Arsimore Lezhe edhe një Program Standard i ambienteve ku janë përcaktuar standardet minimale të organizimit të hapësirave të brendshme, lloji i ambienteve të detyrueshme, instruksione mbi funksionet që duhet të akomodohen, sipërfaqet funksionale të rrethimeve dhe sistemeve të jashtme, etj.
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standardin e kërkuar.

Gjithashtu projektuesi duhet të paraqesë

- Plani i vendosjes së strukturës i cili do të hartohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë së Lezhe.
- Rilevim topografik te sheshit te shkolles .
- Licencë të shoqërisë projektuese + ekstrakt të Regjistrit Tregtar
- Licenca të inxhinierëve projektues, licenca të ekspertit mjedisor + deklarata noteriale të inxhinierëve projektues.
- Projekti i plotë elektrik (planvendosjen e të gjitha pajisjeve elektrike, sistemi data - telefoni, projekti i MNZ, i mbrojtjes atmosferike dhe tokëzimit) të printuara në formatin A3, shkalla 1:1000 në 3 kopje origjinale; Kopja e noterizuar e licencës së inxhinierit elektrik që ka kryer projektin
- Planvendosja e objektit në shkallën 1 : 1000 format A3 .

Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar

Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë e Lezhes . Staf i kërkuar duhet të mbulojë :

- Arkitekt
- Inxhinier ndërtimi strukturist (konstruktor)
- Inxhinier gjeodet
- Inxhinier hidroteknik/hidraulik

- Inxhinier për sistemet e ngrohjes
- Inxhinier gjeolog, në rastin kur ndërhyrje në konstruksionin e objektit
- Inxhinier elektrik
- Preventivues
- Inxhinier mjedisi;
- Ekspert të efikasitetit energjetic
- Staf mbështetës për fushat e mësipërme.

Raportimi

Raportet dhe dokumentat duhet të jenë në 5 (pesë) kopje, në gjuhën shqipe ku njëra nga kopjet të jetë e printuar me ngjyra. Vizatimet duhet të jenë të lexueshme në formatin “dëg” (AutoCad 2007-2012). Të gjitha materialet do të dorëzohen edhe në soft-copy (në 5 CD).

Relacioni teknik që shoqëron projektin duhet të përmbajë:

- Raportin teknik të projektimit arkitektonik
- Raportin teknik të projektimit konstruktiv ku duhet të përfshihet edhe raporti mbi llogaritjet për gjithë strukturat (themelet, shkallëve, soletave, arkitrarëve, trarëve, etj.) si dhe masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, siguria e kalimit në objekt gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit. Në këtë raport do të bashkëngjiten dhe anekset përkatëse ku janë të gjitha llogaritjet përfshirë modelin kompjuterik të llogaritjeve për kontrollet eventuale nga ana e investitorit.
- Relacionin sizmologjik të truallit (kur nuk ka studim, një përshkrim i përgjithshëm)
- *Specifikimet Teknike të cilat duhet të jepen për çdo zë pune.*
- Relacionin gjeologjik dhe vetitë fiziko-mekanike të dherave ku duhet të paraqiten.
- *Cilësitë fiziko-mekanike të dherave dhe të shtresave në themelet e objektit ekzistues.*
- *Rekomandime dhe propozime për raste të veçanta.*
- Certifikata e Performances së Energjisë

Gjithashtu për këtë projekt, bazuar në Ligjin Nr 124/2015 “Për Efikasitetin e Energjisë” si dhe Vendimit Nr.537, datë 08/07/2020 për miratimin e kërkesave minimale të performances së energjisë së ndërtësive dhe elementeve të ndërtësive duhet të realizohet raporti i auditimit të energjisë dhe Certifikata e Performances së Energjisë.

Oponenca teknike

Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik. Me “objekte me akses publik”, sipas këtij neni, do të kuptohen të gjitha objektet, ku pavarësisht statusit të pronësisë së tyre, qytetarët kanë akses të lirë hyrjeje, si: kinema, teatro, stadione, markete etj.”.

- Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (nese e kerkon ligji)
- Raport elektrik.
- Raport hidro, kush, kuz.
- Raport i sistemeve mekanike, ngrohje – ftohje, mnz. etj...
- Raport teknik; Preventiv; Rilevimi.
- Grafiku i punimeve.
- Licensat e stafit projektues.
- Deklaratat e pergjegjesis profesionale te stafit pjesmarres ne hartimin e projektit. Dorëzimi final, fizik, i projektit të zbatimit, do të konsiderohet ai, i cili do të ketë kaluar të gjitha fazat e mësipërme, si të dhe bazuara në: Ligji 107/2014 Për planifikimin e zhvillimit të territorit i

ndryshuar ; Ligji 69/2012 Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar ;Ligji nr 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar ;Ligji 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” i ndryshuar ;Ligj nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave” ;Ligji nr. 152/2015 Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin. Projektuesi do të përdorë edhe standardet në fuqi të projektimit të hartuara nga MASH për objektet arsimore: VKM 319 datë 12.04.2018.

Paraqitja e vizatimeve.

Vizatimet në fazë projekt zbatimi duhet të paraqiten në format A3, të jenë të lexueshme dhe të përmbajnë si minimum fletët si më poshtë:

- Topografinë e gjendjes ekzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjëndjen e sotme (me leje dhe pa leje)
- Planimetria e përgjithshme e objektit në Shk. 1:200; 1:500
- Planimetritë e kateve ekzistuese Shk. 1:100, 1:50
- Planimetritë e objektit pas ndryshimeve Shk. 1:100; 1:50
- Fasadat ekzistuese Shk.1:100
- Fasadat e reja në 2D dhe 3D Shk.1:100
- Prerjet e godinës (në të dy drejtimet) Shk.1:100
- Planimetria e themeleve Shk.1:100
- Prerje të themeleve dhe detajet Shk.1:20; 1:10
- Plani i strukturave detaje Shk.1:100; Shk.1:50
- Planimetritë e mobilimit të shkollës Shk.1:100
- Planimetria e rrjetit të kanalizimeve në shkallën Shk. 1: 100
- Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve Shk.1:10, 1:20
- Planimetria e furnizimit me ujë në Shk. 1: 200, 1:100
- Skemat aksonometrike të furnizimit me ujë, detaje të pajisjeve hidrosanitare Shk.1:100
- Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të ujësjellësit Shk.1:20, 1:10
- Planimetria, aksonometria dhe detaje të sistemit të ngrohjes Shk.1:100
- Planimetria dhe detaje të sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit Shk.1:100
- Planimetria e dhomës së kaldajës, konstruksioni, detaje Shk.1:100;1:50
- Planimetri dhe detaje për ndriçimin, fiksimin e ndriçuesve në tavan, instalimin e kuadrit kryesor etj. Shk.1:100;1:50
- Planimetria e skemës së shpërndarjes së fuqisë në të gjithë objektin, Shk. 1:100
- Planimetritë për telefoninë, rrjetin e internetit Shk.1:100; 1:50
- Planimetria e ndriçimit të jashtëm dhe detaje të tij Shk.1:100; 1:50
- Planimetria e ambienteve sportive dhe ambienteve të gjelbëruara dhe detaje Shk.1:100; 1:50
- Planimetria e murit rrethues, tipin dhe detajin e fiksimit të stolave Shk.1:100; 1:50.
- Planimetria disiplinimit dhe shkarkimit të ujërave sipërfaqësore dhe detajet përkatëse shk.1: 100; 1:50.
- Planimetria e Shpronësimeve, Kjo planimetri do të identifikojë pronat dhe godinat që preken nga realizimi i projektit dhe gjithashtu të bëhet llogaritja e sipërfaqes që preket për arsye shpronësimi.

Faza e V: Projekti i Zbatimit

Preventivi i plotë i kushtimit të veprës. Përgatitja e preventivit të detajuar sipas specifikimeve të projektit me programin e punimeve të ndara sipas kategorive dhe zërave të punës. Harmonizimi dhe kordinimi i kategorive të punës së projektit të bëra nga specialistet e përfshirë në planifikimin e projektit.

Investimi Themelor

Investimi themelor do të dal nga varianti më i mirë tekniko-ekonomik i aprovuar nga Bashkia Lezhe.

Sqarime të fundit

Të dhënat e nevojshme për projektim, siç janë: gjendja e rrjetit ekzistues të ujësjellësit, të kanalizimeve, ndriçimit, kabinat e tensionit të lartë, planin rregullues të zonës, etj, do t'i bashkëngjiten kësaj detyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

MIRATOHET

PJERIN NDREU
KRYETAR



DETYRË PROJEKTIMI

PËR REALIZIMIN E STUDIM PROJEKTIMIT:

**RIKONSTRUKSION SHKOLLE SHITESE ANESORE 3 KAT NDERTIM
PALESTRE DHE SISTEMIMI I TERRENEVE SPORTIVE TË SHKOLLES 9 –
VJEÇARE 'MARASH GJONI' RRILE , LEZHE**

Lezhë
Korrik 2024

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
Institucioni përfitues	3
Arsyetimi i nevojës për ndërhyrje.	3
Baza ligjore.	3
Qëllimi i projektit të investimit.	3
Objektivat e projektit të investimit.	3
PËRSHKRIM I DETYRËS SË PROJEKTIMIT	4
Qëllimi	4
Objektivat	4
Përshkrim i përgjithshëm	4
Pozicionimi i parcelës që zhvillohet	4
Gjendja faktike	7
Kërkesat teknike planimetriko – kompozicionale dhe infrastrukturore	11
Kërkesat teknike kundrejt projektit arkitekturor.	13
Hapësirat e brendshme të sanitarisë	15
Trajtimi i ujërave të zeza dhe atmosferike	16
Drenazhimi i lokacionit	16
Sistemi i drenazhit të ujërave atmosferikë	16
Drenazhimi i kulmit	16
Ajrosja e mjediseve	17
Sistemet dhe rregullat për mbrojtje nga zjarri	17
Qasja në lokacion	17
Pajisjet e fikjes së zjarrit	17
Mbrojtja nga rrufetë	18
Projektimi për personat me nevoja të veçanta	18
Kërkesat teknike kundrejt projektit konstruktiv.	20
Mbulesa	Error! Bookmark not defined.
Soletat	Error! Bookmark not defined.
Suvatimet.	21
Lyerja e mureve të brendshëm dhe të jashtëm	21
Fasada	21
Shtresat e pllakave	21
Shkallët	21
Dyer, dritare	21
Kërkesat teknike kundrejt projektit hidrosanitar.	22
Kërkesat teknike kundrejt projektit elektrik dhe elektronik.	23

Rrjeti telefonik dhe kompjuterik	24
Sistemi elektrik, ndriçimi i emergjencës dhe sigurisë,	24
Kërkesat teknike kundrejt projektit mekanik	25
Kërkesat teknike kundrejt projektit të mbrojtjes nga zjarri	25
Kërkesat kundrejt raportit dhe auditimit të efikasitetit energjetic.	26
Kërkesat teknike kundrejt shërbimeve që i takojnë nëntokës,	26
Kërkesa të përgjithshme.	26
Kërkesa të veçanta.	27
SHËRBIMET E KËRKUARA SIPAS FAZAVE.	27
Hartimin e projekt preventivitet duhet të përfshijë fazat si vijon:	27
Faza I - Aplikimi për VNM paraprake.	27
Faza I.	28
Faza II.	28
Faza III.	28
STANDARDE NË PROJEKTIM	28
Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik	28
REALIZIMI I PROJEKTIT	29
Faza e I: Analiza e detyrës së projektimit e cila përfshin:	29
Faza e II : Projekt-ideja përfundimtare (sistemet dhe planifikimi i integruar)	29
Faza e III : Projekti për miratimin e lejës së ndërtimit.	29
Faza e IV: Projekti i Zbatimit	29
Rekomandime për projektuesin	30
Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar	30
RAPORTIMI	31
Oponenca teknike	31
Paraqitja e vizatimeve.	32
Faza e V: Projekti i Zbatimit	32
Investimi Themelor	32
Sqarime të fundit	33

HYRJE

Institucioni përfitues

Institucioni përfitues i shërbimit në fushën e projektimit është Bashkia Lezhë. Përfituesi i këtij shërbimi është Institucion Publik.

Misioni i këtij institucioni është të sigurojë një infrastrukturë sa më cilësore arsimore për popullatën dhe posaçërisht për shëndetin e nënës dhe fëmijës së porsalindur.

Përfituesi i projektit është sistemi arsimor, për infrastrukturën fizike të të cilit është përgjegjës pushteti vendor.

Arsyetimi i nevojës për ndërhyrje.

Problematika që sjell nevojën e investimit. Në rast se nuk ka problematikë por përputhet me strategjinë e zhvillimit shtjellohet strategjia që e bën të nevojshëm investimin.

Ky projekt është nevojë e rëndësishme e momentit e institucionit për realizimin e veprimtarisë së tij institucionale, si dhe përputhet me strategjinë e zhvillimit të Bashkisë Lezhë dhe orientimeve të ministrisë së linjës.

Baza ligjore.

Bazuar në statusin ligjor të institucionit, ky shërbim në fushën e projektimit duhet të përmbushë kërkesat dhe të marrë në konsideratë referencat si vijon:

1. Ligj Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i përditësuar
2. Rregulloren e Zhvillimit të Territorit (në fuqi).
3. VKM Nr.1503, datë 19.11.2008 "Për miratimin e Rregullores "Për shfrytëzimin e hapsirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara".
4. Ligj Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".
5. Ligj Nr. 124/2015 "Për efikasitetin e energjisë".
6. "Rregullore për formatin e auditimit energjistik dhe pagesën e audituesit energjistik", miratuar me Urdhër Nr. 5, datë 12.01.2021 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.
7. Manualet, standardet dhe kushtet teknike shtetërore dhe evropiane të projektimit të objekteve spitalore.
8. VNM
9. Çdo ligj, apo manual tjetër, të lidhur me projektimin e ndërtesave të kësaj natyre.

Qëllimi i projektit të investimit.

Qëllimi i rikonstruksionit është që të përmirësohet infrastruktura e procesit mësimor në shkollën 9-vjeçare "Marash Gjoni", Rrilë, Lezhë nëpërmjet rikonstruksionit të godinës dhe mjediseve sportive, në mënyrë që të rritet edhe cilësia e mësimdhënies dhe nxënies.

Konsulentit duhet të vlerësojë mundësinë e rindërtimit të një godine të re nga fillimi. Në rast se vlerësimi i kushteve paraprake nuk e lejon një gjë të tillë, do vlerësohet mundësia e një rikonstruksioni.

Gjithashtu duhet vlerësuar mundësia e ndërtimit të një kopshti për fëmijë brenda të njëjtit shesh ndërtimor.

Objektivat e projektit të investimit.

Objektivi kryesor i këtij projekti është të sigurojë ambiente të projektuara dhe të përshtatura në përputhje me kërkesat dhe nevojat e veprimtarisë arsimore, në respektim të standardeve bashkëkohore infrastrukturore dhe çdo akti juridik, normativ, apo standard në fushën e projektimit të ndërtesave arsimore në Republikën e Shqipërisë dhe më gjerë, në shërbim të rritjes së cilësisë së ofrimit të shërbimeve.

Objektivat specifikë të këtij projekti investimi përmbledhen në vazhdim:

- Organizimi funksional i mjediseve shkollore dhe zonimi hapësinor i tyre, në përputhje me kërkesat dhe standardet infrastrukturore për objektet arsimor të mesëm ulët.
- Pajisja e objektit me sisteme, rrjete dhe materiale ndërtimore bashkëkohore.
- Përmirësimi i gjendjes fizike të ndërtesës për të përmbushur kritere infrastrukturore për efciensën energjitike, komoditetin termoakustik, mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, kërkesat higjieno - sanitare dhe përshtatjen e mjediseve për personat me aftësi të kufizuara.
- Përmirësimi i mjediseve sportive të shkollës në përputhje me kërkesat për mjedisë rekreative, kërkesat drenazhimin e ujërave të shiut, ato për mbrojtjen e mjedisit dhe kriteret për orientimin e fluksit të nxënësve.

PËRSHKRIM I DETYRËS SË PROJEKTIMIT

Qëllimi

Detyra e Projektimit ka për qëllim parashtrimin e të dhënave thelbësore, njohëse, kërkesave dhe nevojave specifike të institucionit përfitues, në cilësinë e Porositësit, kundrejt shërbimit të kërkuar, si dhe orientimet mbi problematikën aktuale të shtuar për zgjidhje, mbi bazën e të cilave, grupi i projektimit, do të hartojë projektin për Rikonstruksionin e Shkollës 9-vjeçare “Marash Gjoni”.

Objektivat

Detyra e projektimit ka këto objektiva:

- Të prezantojë grupin e projektimit me vendndodhjen, infrastrukturën dhe problematikën e gjendjes faktike të objektit që i nënshtrohet ndërhyrjes.
- Të përshkruajë kërkesat sasiore dhe cilësore kundrejt shërbimit të porositur.
- Të evidentojë kërkesat profesionale kundrejt grupit të projektimit.
- Të shtjellojë formën, mënyrën dhe afatet e raportimit të materialeve pranë Porositësit.

Përshkrim i përgjithshëm

Pozicionimi i parcelës që zhvillohet

Vendndodhja: Rrile , Njësia Administrative Shenkoll ,Bashkia Lezhe



Pozicionimi i objektit lidhur me qendrën e qytetit të Lezhës



Pozicioni i objektit në hartë kadastrale dhe ortofoto



Fragment i Hartës Treguese të Pasurive



Foto te objektit

Përshkrim: Shkolla 9 - vjeçare ‘Marash Gjoni 3 kat , Rrile, është ndërtuar në vitin 1986 dhe rikonstruktuar në vitin 2011. Godina e shkollës është objekt tre katësh dhe mbulesa është e tipit terrace e sheshte .

Kapaciteti: Në total frekuentojnë mësimin rreth 322 nxënës, të cilët e zhvillojnë mësimin në 18 klasa, të cilat ofrojnë kushtet për mësim .Mësimi zhvillohet me një turn.

Të dhëna statistikore për vitin shkollor 2023-2024

- Numri i nxënësve të regjistruar sipas klasave

Kopesh t		Klasa e pare		Klasa e dyte		Klasa e trete		Klasa e katert		Klasa e peste		Klasa e gjashte		Klasa e shtate		Klasa e tete		Klasa e nente		Klasa e pare deri e nente			
Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	M	
77	32		1		1		1		1		1		1		1		1		1		1		1
		26	6	40	7	35	5	27	17	37	19	47	24	48	29	30	4	32	21	322	17	2	150

Nxenes me aftesi e kufizuar				Nxenes Rom				Nxenes Egjiptian			
Mendore		Fizike		Cikli fillor		Cikli larte		Cikli fillor		Cikli larte	
Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F
1	1	0	0	0	0	0	0	9	6	9	5

Gjendja faktike

Vlerësimi fizik i objektit: Megjithëse shkolla është e mirëmbajtur, vërehen probleme të cilat kërkojnë ndërhyrje sa më parë për t'i eliminuar dhe mos të rëndohen më tepër. Nga një vlerësim paraprak rezulton se:

- Shkolla nuk ka palestër.
- Ka nevojë për sistemi të ujërave të shiut, duke qenë të pasistemuara ato depërtojnë në ambientet e brendshme të shkollës .
- Ka nevojë për ndërtimin e sistemit të drenazhimit në ambientet e jashtme sportive.
- Nyjet sanitare rrjedhin dhe japin lagështi në klasa, pajisjet hidrosanitare janë pjesërisht jashtë funksionit. Ato janë vetëm në katin e perdhje të objektit (mungojnë në dy katet e tjera)
- Mungon sistemi i ngrohjes, ngrohja pjesërisht me soba druri dhe rezistencë.
- Sistemi elektrik duhet të rishikohet pasi nuk mban ngarkesë.
- Nuk ka sistem të MNZ-së.
- Dyert kanë nevojë për riparime dhe zëvendësime si dhe dritaret.
- Ka nevojë për rrethim të terreneve sportive si dhe për riparime të tyre.
- Ka nevojë për riparim të rrethimit egzistues.

Me poshte jane disa foto te gjendjes aktuale te ambjenteve te shkolles :









Kërkesat teknike planimetriko – kompozicionale dhe infrastrukurore

Projektuesi duhet të kryejë të gjithë punën në përputhje me standardet e projektimit dhe ndërtimit që janë në fuqi në Shqipëri.

Perpara hartimit të projektit është e domosdoshme të bëhet një Akt – Ekspertimi nga Instituti i Ndërtimit për të përcaktuar qëndrueshmërinë e objektit nga pikepamja konstruktive.

Gjatë hartimit të meren parasysh kondicionet e PPV Bashkisë Lezhë. Projektuesi duhet të marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi për ndërtimet, kryesisht: Ligji 107/2014 Për planifikimin e zhvillimit të territorit i ndryshuar; Ligji 69/2012 Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar; Ligji nr 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar; Ligji 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” i ndryshuar; Ligj nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”; Ligji nr. 152/2015 Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin. Projektuesi do të përdorë edhe standardet në fuqi të projektimit të hartuara nga MASH për objektet arsimore: VKM 319 datë 12.04.2018.

Hartimi i projekteve specifike, të shtjelluar në vijim, duhet të mbështetet në studimet e thelluara të gjendjes faktike. Çdo dokument teknik që disponohet nga institucioni në shërbim të procesit të projektimit do t’i vendoset në dispozicion grupit të projektimit. Grupi i projektimit duhet të hartojë projektet mbështetur në shërbimin topografik të parcelës dhe shërbimet që i takojnë nëntokës, pa anashkaluar kriteret për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e eficientësisë energjetike.

Gjithashtu Grupi i projektimit do të duhet të bëjë një rievim faktik arkitektoniko-konstruktiv të ndërtesës.

Shkolla 9 - vjeçare ‘Marash Gjoni’ Rrile, propozohet për : shtese anesore 3kat(ne anen veriore) , ndërtim palestere(ne anen jugore) , rikonstrukcion të pjesshëm të godinës, ndërtimi i sistemit të MNZ, ndërtim i sistemit ‘Kapote, etj’ për eficientësinë energjetike , sistemimin e ujërave të shiut, zëvendësim të pajisjeve sanitare, pllakave, dyerve dhe dritareve të dëmtuara, riorganizim dhe gjelbërim të ambientit të jashtëm dhe terreneve sportive . Për të ruajtur pastërtinë e oborrit të shkollës apo ambienteve të jashtme, në projekt/preventiv të vlerësohet që të parashikohet vendosja e koshave për mbeturinat.

Gjatë hartimit të projektit projektuesi duhet të ketë planifikojë intervistim të përfaqësuesve të sistemit arsimor dhe të vetë shkollës për të mbledhur një informacion paraprak për të hartuar një përmbledhje informative dhe orjentuese.

Përmbledhja përbën pikën e fillimit të punës së ekipit të projektimit. Përgatitja e saj duhet të bëhet mbi këto baza:

- Përshkrimi i një dite të zakonshme të shkollës në këtë moment dhe se si do të ndryshojë ajo me agjendën transformuese;
- Struktura organizative e shkollës, përfshirë drejtimin, departamentet, mbështetjen këshilluese joformale dhe kështu me radhë;
- Etikën dhe vlerat e shkollës;
- Aktivitetet që do të vendosen në shkollë, duke përfshirë edhe jashtë orarit për nevojat e komunitetit si dhe llojin e aktiviteteve që kërkohen;
- Shpeshtësinë e aktiviteteve të ndryshme - nivelet e përdorimit të llojeve të ndryshme të akomodimit;
- Afërsinë e kërkuar në mes të aktiviteteve të ndryshme, departamenteve etj;
- Mënyrat për qasjen e komunitetit dhe nivelet e duhura të sigurisë;
- Mënyrat sipas së cilave shkolla mund të ndryshojë në të ardhmen e afërt, në llogari të ndryshimeve pedagogjike, organizimeve joformale këshilluese dhe metodave të reja të mësimdhënies.
- Të gjitha këto informata janë shumë të dobishme për projektuesit/dizajnerët e shkollës prandaj duhet të përfshihet në përmbledhje të detajuara si informata.

Pasi të jenë zgjedhur të gjitha këto çështje, faza tjetër e hartimit të përmbledhjes është përpilimi i detajuar i planit të akomodimit/detyrës projektuese (fleta që liston të gjitha hapësirat e nevojshme) Këtu duhet të mbahen parasysh ambientet që përmendëm: Biblioteka, palestra, dhoma e mjekut., dhoma e psikologut, ambienti i qeverisë së nxënësve. Kjo detyrë projektuese (plani i akomodimit) do të listojë saktësisht numrin e klasave të duhura dhe madhësitë minimale të dhomave mësimore të tyre, si dhe kapacitetin e parashikuar të shkollës të dhënë më termat e numrit të përgjithshëm të vendeve të nxënësve dhe grupeve. Informata të mëtejshme lidhur me dhomat e veçanta janë të listuara në atë që zakonisht njihet si fleta me të dhëna për të gjitha llojet e dhomave mësimore. Detyra do të shtohet deri në një sipërfaqe të përgjithshme në të cilën synohet të bëhet ndërtimi në mënyrë që të sigurojë që limitet financiare të mos jenë tejkaluar.

Projektuesit duhet të analizojnë madhësitë e klasave eksistuese dhe të propozojnë modifikime të mundshme duke patur parasysh përafrimin me standartin e treguar në tabelën e mëposhtme;

Ciklet e plota	Zonat urbane me densitet të lartë			
	Parafillor	Fillor	M. i ulët	M. i lartë
Vitet:	1	5	4	3
3	3	15		
4	4	20		
5	5	25	20	
6	6	30	24	18
7			28	21
8			32	24
9			36	27
10				30
11				33

Madhesia e shkollave

Përveç kësaj, projektuesi duhet të bëjë vlerësimin dhe të kuptojë se si ligjërohet kurrikulumit dhe se si do të shfrytëzohen klasat e mësimin në mënyrë që ai të mund të del me zgjidhje të reja për llojin e aktiviteteve që do të zhvillohen në klasat e mësimin. Ai gjithashtu duhet të vlerësojë dhe të marrë në konsideratë ndërveprimin dhe qasjen në hapësirat e tjera, siç janë (i) hapësirat përcjellëse që ju përshtaten nxënësve që punojnë, (ii) zonat depove dhe ato për mbështetje të mësimdhënësve, (iii) vendet për ruajtjen e rrobave dhe çantave të nxënësve; (iv) hapësirat sociale dhe rekreative.

Përsa i takon mashësisë së klasave projektuesi duhet të ketë parasysh të dhënat në tabelën e mëposhtme;

<i>Niveli i arsimit</i>	<i>Vende për nxënësit</i>		<i>Sipërfaqja në M2</i>		<i>M2/vend të nxënësit</i>	
	<i>Ulet</i>	<i>Lartë</i>	<i>Ulet</i>	<i>Lartë</i>	<i>Ulet</i>	<i>Lartë</i>
<i>Parafillor</i>	24	30-36	48	65	2.0	1.8-2.2
<i>Fillor</i>	24	30-36	44	58	1.8	1.6-1.9
<i>Mesëm i ulët</i>	24	30-36	45	58	1.9	1.6-1.9
<i>Mesëm i lartë</i>	24	30-36	nuk ka	58	nuk ka	1.6-1.9

Madhësia e dhomave mësimore

Projektuesi duhet të ketë në konsideratë parime të funksionalitetit duke u kujdesur që gjatë projektimit të ndërtesës shkollë, të krijohet një bilanc mes cilësisë së funksionimit dhe efikasitetit të kostos. Ky bilanc mund të arrihet me mjete të ndryshme, siç janë:

- Dimensionet racionale të hapësirave:
- Zonat e përshtatura të qarkullimit: hapësirat e qarkullimit nuk duhet të kalojnë 25% të sipërfaqes së dobishme të ndërtuar. Ato duhet të kenë dimensione dhe të përshtaten sipas shfrytëzuesve të shkollës, ato duhet të jenë funksionale dhe të respektojnë kërkesat për siguri;
- Numri optimal i hapësirave: numri i hapësirave fillimisht përcaktohet sipas shfrytëzimit. Në rast se norma e pranueshme nuk mund të arrihet, në veçanti për hapësirat për mësimdhënie të specializuar, hapësirat për qëllime të shumëfishta duhet të merren parasysh;
- Përshtatshmëri maksimale: hapësirat duhet të projektohen me një përshtatshmëri maksimale, që i mundëson ato të përshtaten për lëndë dhe ndryshime të ndryshme, në ato raste kur kjo përshtatet me kërkesat e tyre funksionale;
- Grupimi i hapësirave: hapësirat duhet të grupohen në blloqe sipas funksionit dhe ndërlidhjes. Kjo do të sigurojë një identifikim të lehtë të veprimtarive dhe hapësirave të tyre korresponduese, një komunikim të lehtë mes hapësirave të ndryshme, pa pengesa nëpër zonat e qarkullimit dhe ato të pritjes, një vëzhgim të lehtë të hapësirave dhe një shfrytëzim optimal të tokës në dispozicion;
- Integrimi i nevojave: lokacioni i hapësirave brenda shkollës duhet të ndjekë domosdoshmëritë themelore siç janë rregullat e sanitarisë dhe higjienës, rregulloret e komoditetit funksional dhe të sigurisë, si dhe komoditetin akustik, vizual e atë klimatik.

Kërkesat teknike kundrejt projektit arkitekturor.

Projektuesi duhet të kujdeset që të analizoje dhe të propozojë në respektim të parametrave të komoditetit, duke adresuar tri burime kryesore të mungesës së komoditetit fizik që trupi mund të përjetojë: temperatura, ndriçimi dhe zëri.

Një vëmendje e shtuar duhet t'i kushtohet Komoditetit termik, i cili zakonisht i atribuohet dy parametrave kryesorë: (i) ndjenjës së komoditetit termik si rezultat i bilancit në mes të kalorive të akumuluar dhe të humbura në trup, dhe (ii) kontrollit të kushteve klimatike, duke përfshirë pozitën e diellit dhe rrezatimit, temperaturën, lagështinë dhe erërat.

Përmirësimi i komoditetit termik do duhet të përqendrohet në masa artificiale ose aktive, që përfshijnë mjetet mekanike ose ato elektrike, siç është ngrohja, ajrosja apo kondicionimi i ajrit. Projektuesi duhet të vlerësojë edhe masa si:

- Sipërfaqet e mbjella: mbjellja e bimëve që mund të luajë një rol thelbësor në krijimin e mikroklimës, kur është e nevojshme. Mbjellja e bimëve kontribuon në mënyrë efektive në mbrojtjen nga pluhuri, erërat dhe rrezet e diellit. Përveç kësaj, mbjellja e shkurreve dhe kaçubave bëjnë të mundur mbrojtjen kundër reflektimit të rrezeve të diellit nga toka;

- Elementet e dhura të ndërtesës: kjo përfshihet kullimi i dhur nga çatia/terrace dhe kullimin rreth ndërtesës, krijimin e hijeve me kanate të rregullueshme nëpër dritare, ndalesa të diellit, perde për diell, çadra dhe/apo galeri që mund të sjellin mbrojtje shtesë nga rrezet e diellit, sidomos kur orientimi i ndërtesës nuk është i favorshëm.
- Materialet e dhura të ndërtimit, që përfshijnë materialet e fasadave me reflektim të mundshëm të diellit, materialet izoluese për rritjen e veprimit termik të mureve dhe të kulmit.

Projektuesi duhet të mbajë parasysh që për realizimin e komoditetit termik të mësimdhënies duhet të synohen parametrat e dhënë në tabelën e mëposhtme

<i>Klasat e mësimi</i>	<i>19°C</i>
<i>Depot</i>	<i>16°C</i>
<i>Korridoret</i>	<i>15°C</i>
<i>Zonat e sanitarisë</i>	<i>16°C</i>
<i>Punëtoritë</i>	<i>16°C</i>
<i>Sallat për qëllime të shumëfishta</i>	<i>19°C</i>
<i>Zyrat e administratës</i>	<i>19°C</i>
<i>Dhoma e mjekut</i>	<i>22°C</i>

Temperaturat minimale të rekomanduara

Me një vëmendje të shtuar, projektuesi duhet të vlerësojë masat projektuese për rritjen e efikasitetit energjetic të ndërtesës përmasës së cilësisë së termoizolimit të strukturës. Ai duhet të vlerësojë edhe cilësinë e materialeve të kaviteteve dhe të propozojë eventualisht edhe përmirësimin e sipërfaqeve të dritës.

Me qëllim rritjen e efikasitetit energjetic të godinës projekti duhet të parashikojë veshjen termoizoluese të të gjithë kapsulës veshëse të jashtme të godinës. Projekti arkitekturor duhet të mbajë në konsideratë përshtatjen e objektit për personat me aftësi të kufizuara, referuar kategorizimeve të kufizimeve të ndryshme. Materialet e propozuara për të gjithë elementët ndarës dhe veshës, termoizolues, hidroizolues etj., duhet të jenë bashkëkohorë, të plotësojnë kushtet higjieno sanitare dhe të shmangin elementët e rrezikshmërisë. Rëndësi duhet ti kushtohet akustikës së ambienteve, izolimit nga zhurmat, luhatjet e temperaturës dhe lagështirës.

Gjatë të gjithë procesit të projektimit është e rëndësishme që të bashkëpunohet ngushtë ndërmjet të gjithë specialistëve të përfshirë, pasi projekti arkitekturor duhet të reflektojë kërkesat e projektit strukturor, kërkesat e projekteve të sistemeve teknike, kërkesat e aspekteve arkitekturore të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, kërkesat për efikasitetin energjetic, kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe çdo kërkesë tjetër, të gjykuar si të nevojshme nga specialistët e përfshirë.

Sa i takon komoditetin vizual, projektuesi duhet të ketë parasysh se nevoja për standarde të larta dhe një ndriçim i projektuar mirë për ndërtesat shkollë bazohet në: (i) ndriçimin natyror që rezulton nga drita e diellit e drejtpërdrejtë apo ajo e tërthortë e reflektuar nga toka dhe sipërfaqet e tjera të jashtme apo ato të brendshme.

Projektuesit duhet të ndërmarrin masa të dhura për të siguruar komoditetin e ndriçimit që është esencial për një performancë të mirë dhe komoditet vizual të nxënësve dhe personelit të shkollës. Ato janë:

Ndriçimi natyror:

- Për të kufizuar përdorimin e ndriçimit të shtrenjtë artificial, plani(projekti) i ndërtesës dhe i dhomave mësimore duhet të maksimizojë përdorimin e dritës natyrore dhe në këtë mënyrë do të minimizohet rrezatimi i mundshëm që mund të ndodhë gjatë periudhave të caktuara të ditës;
- Niveli i mirë i ndriçimit është i rëndësishëm në zonat e qarkullimit për të minimizuar rrezikun nga aksidentet;

- Distanca mes balleve duhet të lejojnë depërtimin e mjaftueshëm të dritës nëpër ndërtesa. Këto rekomandime mbi këtë lloj distance zbatohen edhe për komoditetin klimatik;
- Numri, dimensionimi, vendosja dhe aranzhimet e dritareve duhet të jenë në përputhje me sasinë e kërkuar të dritës (dhe rrjedhën e ajrit). Duke pas parasysh rëndësinë e ndriçimit natyror, rekomandohet që e tërë sipërfaqja e dritareve në hapësirat e mësimi të jetë 15 deri 20% e sipërfaqes së dyshemesë;
- Thellësia e sallave mund të ndikojë në ndriçimin natyror për hapësirat në anën e kundërt të dritareve. Andaj rekomandohet që të shmangen thellësitë e sallave që tejkalojnë 7.00 m;
- Kur kemi streha, amortizatorë dritarësh apo grila për mbrojtjen e dritareve, efekti i tyre në dritën e ditës duhet të studiohet me kujdes;
- Mbjellja e drunjve dhe shkurreve mund të kufizojë intensitetin e dritës, varësisht nga përmasat dhe format, si dhe llojet e gjetheve dhe distanca nga ndërtesat.

Ndriçimi artificial:

- Disa aktivitete shkollore në mënyrë të domosdoshme kërkojnë ndriçim të duhur artificial, në veçanti gjatë kohës së dimrit dhe në fund të ditës apo gjatë ditëve me re.
- Instalimi i pajisjeve të ndriçimit gjithashtu mund të mundësojë zgjatjen e orëve të punës (ndërrimet e dyfishta, mësimet e natës, takimet...);
- Lloji i pajisjeve të ndriçimit që duhet të instalohen varet nga intensiteti i dritës që kërkohet dhe nga lloji i aktivitetit përkatës. Megjithatë tubat fluoreshente, krahasuar me poçet inkandeshente, kanë përparësinë e reflektimit të ulët të sipërfaqeve, efikasitet të lartë, shpërndarje të mirë të dritës, prodhim të ulët të nxehtësisë;

Projektuesi duhet të ketë në vëmendje projektimin për një mjedis higjienik. Për këtë qëllim ai duhet të ketë parasysh

Hapësirat e brendshme të sanitarisë

Cilësia e mjedisit higjienik në shkollë varet nga projektimi, përzgjedhja e pajisjeve për shfrytëzim nga nxënësit, personeli (mësimdhënës, administrativë, shërbyes), si dhe nga mysafirët, por edhe nga mirëmbajtja dhe menaxhimi i shfrytëzimit të këtyre pajisjeve. Këto pajisje, nëse mirëmbahen mirë do të sigurojnë nivelin e tualeteve, banjave dhe furnizimit me ujë që kërkohet brenda ndërtesave shkollore. Përveç këtyre ekzistojnë edhe komponentët e jashtëm të këtyre shërbimeve, menaxhimi i mirë i të cilave është thelbësor për higjienën dhe funksionimin e vazhdueshëm të pajisjeve të brendshme.

Në bashkëpunim me stafin mësimor, konsulenti duhet të parashikojë ambiente sanitare të përshtatshme për fëmijët e grupmoshës 6 deri 15 vjeç dhe atyre të sistemit parashkollorë.

Nyjet sanitare të jenë të veçanta dhe lavamanët të jenë të mjaftueshëm për numrin e nxënësve. Të sigurohet ujë i vazhdueshëm dhe i ngrohtë në lavamanë, për këtë arsye të shikohet mundësia e instalimit të bolierëve si dhe realizimi i rrjetit të nevojshëm hidraulik.

Banja dhe parabanja të jenë të ajrosura, të ndriçuara dhe të ventiluar. Kur s'ka ajrim direkt duhet të pajisen me impiant ajrimi dhe ventilimi. Kollonat e shkarkimit të jenë të shkëputura nga kanalet e ventilimit, me ajrim në tarracë dhe shkarkimet të jenë të kontrollueshme.

Banjat të kenë porta të hapshme nga jashtë dhe të shkëputura nga dyshemeja dhe të përjashtohet hapja nga brenda, për raste emergjence.

Ambientet sportive

Për terrenet e jashtme sportive ka nevojë për ndërtimin e sistemit të drenazhimit. Terrenet e jashtme sportive kanë nevojë për sistemim dhe mobilim urban .

Sistemimet e jashtme dhe ambientet e gjelbëruara

Sistemimit të oborrit të shkollës duhet ti kushtohet një rëndësi e veçantë. Ai duhet të rezultojë me rrethim transparent (kangjella, etj) dhe të garantojë të gjitha normat e sigurisë dhe standardeve për ndërtime të këtij lloji. Ambientet e jashtme janë ambiente që kryesisht shërbejnë për qëndrim, çlodhje prandaj rëndësi të veçantë ka edhe krijimi i një sipërfaqeje të gjelbër dhe me pemë. Projektuesi duhet të japë të detajuara shtresat përkatëse dhe teknologjinë e zbatimit të tyre, dhe të kombinojë ambientet e qëndrimit/rreshtimit me ambientet e gjelbëruara.

Konsulenti duhet t'i jap rëndësi dhe të parashikojë dhe ndriçimin e jashtëm të objektit, në përputhje me planin urbanistik të kësaj zone dhe në përputhje me kërkesat e veçanta për rrjetin e ndriçimit të dhënë në këtë detyrë projektimi.

Për të mbajtur pastërtinë e oborrit të shkollës, në projekt/preventiv të parashikohet vendosja e koshave për mbeturinat, sidomos në afërsi të stolave.

T'i kushtohet kujdes i veçantë, sistemimit dhe disiplinimit të ujërave sipërfaqësore të cilat janë problematike për këtë objekt.

Trajtimi i ujërave të zeza dhe atmosferike

Në përgjithësi, ekzistojnë 2 lloje të ujërave që duhet të trajtohen dhe të qiten jashtë ndërtesave shkollë. Këto janë: (i) të gjitha ujërat e tualeteve; dhe (ii) ujërat nga shirat, nga kulmet apo hapësirat e jashtme.

Të gjitha ujërat mund të dërgohen drejtpërdrejtë në rrjetin e kanalizimit. Rekomandohet që ujërat atmosferike nga kulmet të grumbullohen në një rezervuar të ndarë në mënyrë që ai ujë të shfrytëzohet për ujitjen e hapësirave të gjelbëruara në oborr të shkollës.

Për ruajtjen e ujit kërkohet cisterna e prodhuar nga çeliku i galvanizuar apo nga material tjetër që është rezistues dhe që plotëson kushtet higjienike për depozitimin e ujit të pijshëm. Pozita apo vendndodhja e këtyre cisternave do të rregullohet në atë mënyrë që të ekzistojë rënia e lirë e duhur kurdo që kërkohet për furnizim me ujë të të gjitha pjesëve të shkollës.

Drenazhimi i lokacionit

Drenazhimi i lokacionit të shkollës përfshinë shkallëzimin e përgjithshëm të lokacionit, sistemin e drenazhimit të ujërave pas shtrëngatave dhe atë të ujërave atmosferike.

Sistemi i drenazhit të ujërave atmosferikë

I tërë drenazhimi i lokacionit nga ndërtimet e reja apo nga ndërtesat ekzistuese lidhen me sistemin ekzistues të drenazhimit të ujërave atmosferikë dhe të gjitha rrjedhat e ujërave atmosferikë nga hapësirat e shtruara (terrenet sportive, ato për lojëra, rrugët, vend parkimet, dhe shtigjet) mblidhen në kanalet për drenazhim të ujërave atmosferike apo në kanale të hapura dhe do të barten përmes gypave nëntokësorë në vendgrumbullim të ujërave, në rezervuare të ujërave apo në rrjetin e kanalizimit të qytetit.

Drenazhimi i kulmit

Kulmi i ndërtesave duhet të planifikohet në atë mënyrë që të mundësojë drenazhimin e ujërave atmosferike: (i) kulmet e rrafshëta nga pllakat e çimentos duhet të kenë pjerrtësinë minimale prej 1% që shkon drejt pikave dalëse dhe tek gypat vertikalë të drenazhimit; (ii) kulmet e pjerrëta të ndërtesave disakatëshe duhet të kenë ulluqet dhe gypat vertikalë të drenazhimit, të lidhura me sistemin kryesor të drenazhimit në lokacion.

Në lidhje me sigurinë e objektit ndaj zjarrit duhet të kihet parasysh

Ajrosja e mjediseve

Ajrosja e mjediseve të shkollës përmirëson shumë higjienën brenda objektit, duke eliminuar lagështinë, lagështinë nga muret, nga ndarjet e hapësirave dhe nga hapjet, si dhe duke larguar insektet që bartin sëmundje. Përveç kësaj, lëvizjet e ajrit ndihmojnë në zvogëlimin e disa sëmundjeve, siç janë mukozat, duke zvogëluar temperaturën trupore, dhe rrjedhimisht duke zvogëluar djersitjen e nxënësve dhe të punonjësve përmes avullimit dhe rrymimit. Ajrosja e ndërtesave shkollë mund të bëhet përmes:

Sistemet dhe rregullat për mbrojtje nga zjarri

Masat paraprake që duhet të ndërmerren nga projektuesit e shkollave përfshijnë një grup masash për kufizimin e rreziqeve nga zjarri, lehtësimin e evakuimit të shfrytëzuesve të ndërtesave dhe lehtësimin e qasjes së ekipeve të shpëtimit. Kjo përfshinë metoda të ndryshme të mbrojtjes dhe sisteme të sigurisë ndaj zjarrit të cilat janë përshkruar shkurtimisht në vijim:

Qasja në lokacion

Për sa i përket mbrojtjes nga aksidentet, lokacioni i shkollës duhet të vendoset sa më larg që është e mundur nga zonat që paraqesin rrezik nga zjarri (punëtoritë, fabrikat, depot, pompat e benzinës...), dhe rruga e qasjes për në ndërtesa duhet të jetë, së paku, 8.0 m e gjerë (të shqyrtohet me shërbimet lokale të shpëtimit) dhe duhet të jetë e përshtatshme për vetura dhe kamionë, përfshirë ambulancat dhe automjetet e shpëtimit të zjarrfikësve.

Tubacionet dhe hidrantët e fikjes së zjarrit: tubacionet e fikjes së zjarrit instalohen nëpër ndërtesa dhe pajisjen me valvula në mënyrë që shërbimet e zjarrfikjes dhe të shpëtimit të mund të lidhin tubat për ujë për të fikur zjarrin brenda ndërtesës. Ato mund të jenë të llojit “të thatë” që zakonisht janë të zbrazëta dhe furnizohen përmes një tubi nga pajisjet pompuese të shërbimit të zjarrfikjes dhe të shpëtimit, ose të jenë edhe të llojit të “lagësht” ku ato mbahen me plot ujë dhe furnizohen nga rezervarët dhe pompat në ndërtesë. Duhet të ekzistojë edhe një pajisje për t’i mundësuar sistemit të lagësht që të rimbushet nga pajisjet e pompimit në rast të emergjencave.

Pajisjet e fikjes së zjarrit

Hetimi automatik i zjarrit: Zbulimi i hershëm automatik dhe alarmimi i zjarrit ndihmojnë në daljen e shpejtë dhe të sigurt të personave, apo e trajtojnë zjarrin kur ai gjendet në fazën e parë të zhvillimit. Kjo do të mundësojë thirrjen e ndihmës profesionale pa ndonjë vonesë gjë që do të ulte dëmtimet e shkaktuara të ndërtesës dhe përmbajtjes së saj. Shembuj të këtyre pajisjeve përfshijnë pajisjet mbaj-dhe-hap të dyerve kundër zjarrit, sistemet e nxjerrjes së tymit apo sistemet e ajrosjes, sistemet e presimit dhe valvulave të zjarrit në tubacionin e ajrosjes.

Shenjat dhe njoftimet: Të gjitha shenjat dhe njoftimet duhet të vendosen në mënyrë që ato të shihen dhe të kuptohen me lehtësi. Shenjat duhet të përdoren, aty ku është e nevojshme, për t’ju ndihmuar personave që t’i identifikojnë rrugët e daljes dhe daljet, të gjejnë pajisjet e zjarrfikjes dhe telefonat emergjent në rast të zjarrit. Lajmërimet duhet të përdoren, aty ku është e nevojshme, për të dhënë udhëzime se si të përdoren pajisjet kundër zjarrit, rreth veprimeve që duhet të ndërmerren në rast të zjarrit dhe informatave rreth shërbimit kundër zjarrit dhe të shpëtimit.

Ndriçimi emergjent: ndriçimi emergjent nevojitet për të treguar dhe ilustruar në mënyrë të qartë rrugët dhe shenjat e daljes, përfshirë këtu rrugët e daljes që janë jashtë ndërtesës, për të siguruar që ndryshimet e kateve dhe të drejtimeve të tregohen dhe për të siguruar që pikat e thirrjes së alarmit të zjarrit dhe pajisjet e zjarrfikjes të mund të gjenden me lehtësi.

Kontrolli i tymit: ekzistojnë katër arsye kryesore për kontrollimin e shpërndarjes së tymit, që janë, mbrojtja e rrugëve të daljes, asistimi i fikjes së zjarrit, kufizimi i rrezikut ndaj shfrytëzuesve të objektit në sallat që nuk janë në afërsi të zjarrit dhe minimizimi i dëmit nga tymi ndaj përmbajtjes së ndërtesës.

Në shumicën e rasteve kjo arrihet përmes përdorimit të masave të përmbajtjes, siç janë dyert dhe muret. Megjithatë në disa rrethana sistemet e ajrosjes të tymit apo sistemet e shtypjes mund të jenë të nevojshme apo të dëshirueshme.

Ndihma e parë e zjarrfikjes: fikësit e zjarrit duhet të përmbushin funksionin për sigurinë e jetës nëse mënyra më e sigurt e ikjes nga efektet e zjarrit është fikja e tij. Ata gjithashtu kanë një rol të dukshëm në mbrojtjen e pronës, nëse zjarri mund të luftohet para se të bëhet shumë i madh. Llojet e ndryshme të fikësve të zjarrit përdoren për llojet e ndryshme të zjarrit: në tabelën 3.6 më poshtë janë paraqitur llojet kryesore të fikësve të zjarrit, llojet e zjarrit për të cilët ata janë të përshtatshëm dhe lokacionin e përgjithshëm të pajisjeve të zjarrfikjes.

Kur rreziku nga zjarri nuk është i kufizuar në ndonjë lokacion të caktuar, p.sh. zjarret e kategorisë A, fikësit e zjarrit duhet të vendosen në rrugët e daljes, afër daljes nga dhoma apo në dysheme, apo në daljen e fundit nga ndërtesa.

Sistemet e spërkatjes: Sistemet e spërkatjes përfshijnë njehsorët e rrjedhjes të lidhur me alarme, dhe nëse instalohet një sistem i fikjes së zjarrit në tërë ndërtesën do të kenë një bonus shtesë që janë hetuesit e nxehtësisë në tërë shkollën që mund të shpijnë në kursime të përgjithshme. Megjithatë, ky sistem mund të jetë shumë i shtrenjtë dhe projektuesi mund të duhet të zgjedhë një tipar të kufizuar të kompensimit për të trajtuar rreziqet specifike përmes mbrojtjes së vetëm një ndërtese apo vetëm ndonjë pjesë të ndërtesës.

Dyert kundër zjarrit: dyert e vendosura në muret rezistuese ndaj zjarrit apo në muret ndarëse duhet të jenë dyer kundër zjarrit, të dizajnuara që të rezistojnë kalimin e zjarrit dhe të tymit. Dyert e zjarrit përdoren në rrugët e daljes për të ndarë korridoret e gjata duke siguruar kështu që jo më shumë se një pjesë e shkurtër e korridorit që shpie në dalje të mbushet me tym gjatë ndonjë zjarri. Dyert e zjarrit duhet të përdoren për të ndarë shkallët nga rrugët e qarkullimit në mënyrë që shkallët të mbrohen nga hyrja e tymit.

Dyert e zjarrit në përgjithësi do të kenë panele të qelqit për t'i ndihmuar shfrytëzuesve për të parë më tej, përfshirë ata me nevoja të veçanta, gjatë lëvizjes së tyre. Panelet e pamjes gjithashtu do të jenë të dobishme në rast të zjarrit për t'ju mundësuar njerëzve që të shohin nëse hapësira nga ana tjetër është prekur nga tymi apo jo. Përdorimi i qelqit varet në atë nëse ai ofron izolim si dhe integritet për nivelin e duhur të rezistencës ndaj zjarrit për së paku 60 minuta.

Mbrojtja nga rrufetë

Sistemi për mbrojtje nga rrufetë është një masë e rëndësishme mbrojtëse që duhet të kihet parasysh nga projektuesit e shkollave. Sistemi është i projektuar për të mbrojtur ndërtesat dhe përmbajtjen e tyre nga dëmtimi për shkak të goditjeve, duke i ndërprerë ato dhe duke e përcjellë pa rrezik rrymat e tyre të tensionit të lartë në tokë. Shumica e sistemeve për mbrojtje nga rrufetë përmbajnë në vete një rrjet të përbërë nga tri elemente. Ato janë:

- shufrat rrufepritëse ose terminalet ajrore që zakonisht janë të vendosura në ose përgjatë pikave më të larta të strukturës së kulmit, dhe të lidhura elektrikisht me njëra tjetrën përmes përçuesve të lidhur;
- përçuesit metalik të vendosur teposhtë që gjithashtu quhen "të drejtuar teposhtë", të cilët janë të lidhur në rrugën më direkte për te njëri ose më shumë vendshkarkues në tokë. Lidhjet për elektrodën e vendosura në tokë nuk duhet të kenë vetëm rezistencë të ulët, por duhet të kenë edhe vetë-induktancë të ulët;
- elektrodën e tokëzimit ose "tokëzimi" i bërë nga shufrat, pllakat metalike ose rrejetat.

Objekti duhet të adresojë edhe kërkesa të posaçme


Projektimi për personat me nevoja të veçanta

Projektimi/dizajnimi i ndërtesave shkollore duhet të siguroj qasjen e papenguar, lëvizjes, qëndrimin dhe mësimnxënies të nxënësve me nevoja të veçanta, referuar legjislacionit perkates, per kete kategori. prandaj, projektuesit duhen të bazohen në këtë legjislacion por edhe në këtë udhëzues ku jane paraqitur kushtet teknike më specifike për ndërtesat shkollore. Llojet e nevoja të veçanta për të cilat mund të përkujdesemi në një shkollë standarde do të kufizohen, për arsye praktike, në ato me nevoja të veçanta në lëvizje, humbje të dëgjimit që korrigohet me pajimet për dëgjim, dhe humbja e pjesërishme ose e tërësishme e të parit, pas trajnimit adekuat. Mirëpo, kategoria e fundit nuk do të jetë në gjendje të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet shkollore të mësimdhënies ose të mësimnxënies.

Personat me nevoja të veçanta mund të jenë nxënës, arsimtarë, mysafirë ose personel. Problemi i tyre kryesore është reduktuara në lëvizshmërinë e tyre për arsye se ata shfrytëzojnë karrocet e invalidëve, patericat ose bastunët. Ky problem kërkon dimensionim të veçantë të zonave të qarkullimit, hapësirave të dyerve, pajisjeve sanitare, shtigjeve të evakuimit dhe hapësirave të klasave për t'i akomoduar personat me nevoja të veçanta.

Dimensionet e personave me nevoja të veçantë nëpër karrocet e invalidëve duhet të kihet parasysh nga projektuesit gjatë caktimit të madhësisë së hapësirave të shkollës dhe qarkullimit. Karrocet e invalidëve kanë dimensione të ndryshme, sipas moshës së nxënësve dhe llojit të artikullit. Megjithatë, dimensionet e mëposhtme, përkojnë me dimensionet mesatare të personave të rritur, e që duhet të merren parasysh


- Gjerësia e karriges përgjithësisht është mes 600 dhe 700 mm
- Gjatësia është mes 1000 dhe 1250 mm
- Rrezja e jashtme është mes 1300 dhe 1500 mm



Hapësira deri ku mbërrijnë personat me nevoja të veçanta në karrocet e invalidëve definohet

- Mes 230 dhe 300 mm mbi nivelin e dyshemesë;
- Mes 1100 dhe 1300 në lartësi;

- Mes 300 dhe 400 mm nga pjesët anësore të karriges;



Kërkesat teknike kundrejt projektit konstruktiv.

Hartimi i projektit konstruktiv duhet të mbajë në konsideratë propozimin e zgjidhjeve më të përshtatshme, referuar konceptit të përgjithshëm arkitekturor dhe funksionit të ambientit.

Materialet, teknikat dhe teknologjitë e propozuara duhet të respektojnë kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Në mungesë të tyre projektuesi duhet t’u referohet Eurokodeve aktuale në përdorim.

Projekti konstruktiv duhet të respektojë kërkesat e jetëgjatësisë së projektimit, ngarkesave dhe rregullave të projektimit për sa i përket durabilitetit (Klasa e durabilitetit), në funksion të kushteve të ekspozimit të tij, bazuar në Eurokode.

Hartimi i projektit konstruktiv duhet të mbështetet në studimin gjeologjiko – inxhinierik të truallit dhe studimin sizmologjik.

Catia

Aktualisht objekti 3 katesh, është me tarrace te sheshte beton –arme.

Projektuesi duhet te projektoje nje cati te re , të japë të gjitha detajet arkitektonike lidhur me soleten : vendosja e kasetës së shkarkimit dhe ullukët vertikalë si dhe detaje të tjera të domosdoshme për zbatimin e punimeve duke qenë se një pjesë e ujërave të shiut janë të pasistemuar dhe grumbullohen në ambientet e shkollës. Gjithashtu duhet të tregojë, numrin e ulluqeve dhe diametrat e tyre sipas normave në fuqi. Për sasitë e reshjeve do të përdoren të dhënat e Institutit Hidrometeorologjik.

Ne projekt te parashikohen edhe daljet e oxhakeve egzistues , pasi ato duhet te jene funksionale.

Soletat

Është detyrë e konsulentit, kontrolli dhe verifikimi teknik i soletave ekzistuese të objektit, në mënyrë që të parashikohet rikonstrukcioni i tyre sidomos në rastet kur ka probleme, të lidhura me degradimin e tyre dhe me uljen e aftësive mbajtëse.

Muret

Konsulenti do të japë të gjitha detajet e përforcimit të muraturës mbajtëse në rastin kur ajo paraqitet me probleme. Në rast të mureve me çarje, konsulenti do të tregojë mënyrën e riparimit/konsolidimit të tyre

Suvatimet.

Objekti i rikonstruktuar duhet të suvatohet nga brenda dhe jashtë. Në pjesët e dëmtuara, suvatimet e mureve dhe tavaneve do të kryhen në të gjithë sipërfaqen përkatëse duke ruajtur shtresën e parë ekzistuese ku të mundet në mure, kurse tavanet të pastrohen dhe të risuvatohen. Të gjitha shtresat e tjera në rast se janë të dëmtuara do të hiqen pa dëmtuar muret.

Përsa i përket suvatimeve të jashtme do të jenë në varësi të llojit të ndërhyrjes që parashikon projekti, nëse do të restaurohet sipërfaqja ekzistuese ose do të rishikohet e gjitha sipas konceptit të ri që kërkon fasada.

Lyerja e mureve të brendshëm dhe të jashtëm

Muret e brendshëm dhe tavanet do të lyhen me hidromat, kurse pjesa e poshtme e mureve do të lyhet me bojë akrilik me ngjyrë të ndryshme ose jo nga muret, gjë e cila do të vendoset në bashkëpunim me stafin e shkollës.

Fasada

Fasada e shkollës, të jetë e tillë që të mirëmbahet lehtë, kurse ngjyrat e fasadës të jenë të bukura, në mënyrë që objekti të bëhet më atraktive për fëmijët. Fasadat duhet të jenë të veshura me kapotë termike antizjarr. Konsulenti duhet të përcaktojë gjithashtu vendodhjen e tabelës me emrin e shkollës.

Shtresat e pllakave

Pllakat ekzistuese të dyshemesë së vjetër së bashku me llaçin e vjetër nëse është e nevojshme do të zëvendësohen nga shtresa e re e dyshemesë, me pllaka, duke patur parasysh rinivelimin e saj me llaç – çimento si dhe me shtresat e nevojshme izoluese në rastin e ambienteve që nevojiten. Dyshemetë e tualeteve dhe muret e tyre në një lartësi të caktuar, duhet të izoloohen dhe projektuesi duhet të japë detajin e izolimit të tyre. Çdo shtresë duhet të jetë e detajuar me specifikimet përkatëse.

Shkallët

Është e nevojshme përcaktimi i qartë i gjendjes së shkallëve të jashtme, si nga ana funksionale në lidhje me kapacitetin ashtu edhe nga pikëpamja konstruktive ose e aftësisë mbajtëse të konstruksionit në rastin e rikonstruksionit të godinës. Edhe nëse shkallët nuk kanë nevojë për rikonstruksion, bazamakët dhe parapetet duhet të ribëhen.

Projekti duhet të përmbajë të gjitha detajet si dhe specifikimet teknike të domosdoshme për fazën e projekt zbatimit.

Dyer, dritare

Projektuesi duhet të përcaktojë që materialet që do të përdoren të jenë të cilësisë së lartë. Nëse janë propozuar dyer prej druri, ato duhet të jenë prej druri të fortë me mentesha të forta (minimumi tre për çdo derë).

Vendosja e dyerve dhe plani i hapjes së tyre të realizohet i tillë që të plotësojë kushtet e daljes së shpejt në raste emergjencash dhe standardet e vendosura nga MAS.

Përsa i përket dritareve do të jenë duralumini të cilësisë së lartë me hapje me rrotullim dopio-xham dhe me sopralue në ambiente që e kërkojnë atë. Gjithashtu për katet e para duhet të jetë të

parashikuara të gjitha normat e sigurisë pra edhe pajisja e tyre me elementet metalike mbrojtës përkatës.

Kërkesat teknike kundrejt projektit hidrosanitar.

Projektimi i Sistemit Hidrosanitar të Furnizimit me ujë dhe shkarkimeve të ujërave të ndotura dhe atmosferike të ndërtesës dhe projektimi i rrjetit inxhinierik të ujërave në zonën përreth duhet të kryhet në përputhje me projektin arkitektonik.

Sistemi hidrosanitar i furnizimit me ujë dhe shkarkimeve të ujërave të ndotura të ndërtesës dhe jashtë saj duhet të projektohet në përputhje me Kushtet Teknike të Projektimit (KTP) në Fuqi, si dhe sipas udhëzimeve të Standardeve të projektimit shtetërore dhe ndërkombëtare. Ky sistem duhet të projektohet, në përputhje me zgjidhjet e konceptuara në projektin arkitekturor dhe duke marrë në konsideratë kërkesat bashkëkohore për funksionimin e nyjeve higjieno – sanitare.

Sistemi hidrosanitar i furnizimit me ujë duhet të sigurojë prurjen e kërkuar, me presionin e nevojshëm në çdo pajisje hidrosanitare. Ky sistem duhet të garantojë furnizimin e vazhdueshëm dhe pa ndërprerje të të gjitha nyjeve sanitare, duke vendosur një rezervë ujore rreth 24 orëshe, si dhe grup presioni për sigurimin e presionit në rastet e furnizimit me ujë nga depozita.

Sistemi hidrosanitar i kanalizimeve të ujërave të ndotura duhet të mbledhë dhe largojë me vetërrjedhje ujërat e nyjeve sanitare. Nëse ka mjedise sanitare nën nivelin e linjave të rrjetit rrugor, duhet të vendosen grupe presioni tip njësi kompakte me rezervuar, të cilat të lidhen direkt me linjën e shkarkimit (të ruhet hermeticiteti i sistemit të kanalizimeve, jo me pusëtë).

Nevojitet që në ndërtesë të sigurohet furnizimi me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë, duke u bazuar në zgjidhje aktuale dhe perspektive, të cilat do të shmangnin maksimalisht nevojën për ndërhyrje të mëvonshme në objekt dhe do të realizoheshin duke mbajtur në konsideratë edhe aspektet e eficensës energjitike afatgjatë.

Për llogaritjet e parametrave hidraulikë dhe gjeometrikë të sistemit, prurjet, humbjet hidraulike, presionin e nevojshëm dhe diametrat duhet të përdoren tabelat e dhëna në kushtet teknike të sipërpërmendura. Llogaritjet e parametrave hidraulikë dhe gjeometrikë të rrjetit duhet të kryhen, duke patur parasysh edhe prurjen e grupeve përzierës (mishelatorë) të ujit apo të rubinetave të pajisjeve përkatëse.

Zgjidhjet teknike të propozuara në projektin hidrosanitar duhet të respektojnë funksionin e objektit, si dhe standardet dhe normativat e detyrueshme, të përcaktuara në aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi.

Të gjithë tubacionet dhe rakorderitë e sistemeve hidrosanitare duhet të propozohen sipas standardeve dhe certifikimeve bashkëkohore ndërkombëtare.

Të nisur nga sa më sipër gjatë hartimit të projekt-zbatimit duhet të meren parasysh sa më poshtë:

- Të merret në konsideratë perspektiva 10 vjeçare e rritjes së numrit të fëmijëve.
- Të merret në konsideratë rrjeti ekzistues i kanalizimeve të zonave ku ndodhen objektet, por gjithashtu konsulenti duhet të marrë në konsideratë projektin e ri të kanalizimeve për këto zona, nëse ka.

Sistemi i largimit të ujërave të bardha dhe të zeza do të jetë miks.

Në përputhje me normat, konsulenti duhet të ketë parasysh numrin e fëmijëve, stafin mësimor dhe administrativ.

Konsulenti duhet të verifikojë gjendjen teknike të banjave ekzistuese dhe duhet të përgatisë projektin e detajuar si për rikonstrukcionin e atyre ekzistuese ashtu edhe të shtesës eventuale të kapacitetit (numrit) të tyre.

Rrjeti i shkarkimit të ujërave të zeza do të ndërtohet me materiale bashkohore dhe në përputhje me standardet në fuqi.

Rrjeti i amortizuar i ujësjellësit do të zëvendësohet. Gjithashtu në bashkëpunim me shoqërinë e Ujësjellës Kanalizime sh.a. do saktësohet dhe gjendja e ujësjellësit ekzistues të zonës si dhe problemet e vërejtura në këtë zonë gjatë periudhës së furnizimit me ujë duke përcaktuar edhe kapacitetin depozitues për furnizim me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje gjatë ditës .

Materialet që do përdoren për rrjetin e brendshëm të ujësjellësit do jenë tuba polietileni me densitet të lartë për ujë të pijshëm me diametër dhe aftësi mbajtëse në përputhje me prurjet dhe presionet llogaritëse.

Për nyjen e marrjes nga rrjeti i zonës do të parashikohet puseta me kapak b/a, përmasat e të cilave duhet të realizohen sipas kushteve teknike dhe të sigurojnë kushte normale manovrimi dhe riparimi. Nëse është e domosdoshme, projektuesi duhet të parashikojë zëvendësimin dhe nxjerrjen jashtë pune të sistemit të vjetër të furnizimit me ujë.

Projektuesi të parashikojë në projekt/preventivin e objektit, vlerën e furnizimit dhe vendosjes së linjës së furnizimit me ujë nga pika e marrjes së dhënë nga Ujësjellës Kanalizime sh.a. Lezhe deri tek matësi i ujit.

Të parashikohet realizimi i depozitave të ujit, të nevojshme në raste emergjence si dhe lidhja e tyre në, me të paktën dy prej lavamanëve dhe nyjeve sanitareve si dhe depozitat e ujit për MNZ.

Kërkesat teknike kundrejt projektit elektrik dhe elektronik.

Projekti elektrik duhet të përshtatet me kërkesat dhe nevojat funksionale të secilit ambient.

Projekti duhet të përmajë rrjetin e ndriçimit, ku përfshihet edhe ndriçimi i ambienteve të jashtëm dhe ndriçimi i emergjencës, rrjetin e prizave të furnizimit me energji, të prizave të UPS, rrjetin e furnizimit me energji elektrike nga OSHEE, sistemin e telefonisë, rrjetit LAN, sinjalizimit të zjarrit, sistemin video, acces-control, sistemin e vëzhgimit me kamera, sistemin e rufepitjes etj., në harmoni me kërkesat e projektit arkitekturor.

Pozicionimi i ndriçuesve për secilin ambient duhet të përputhet me konceptin arkitekturor të përgjithshëm, në përputhje me funksionin e ambientit dhe standardet kundrejt tij.

Ndriçuesit e propozuar duhet të shmangin elementët e rrezikshmërisë, emetimin e lëndëve të rrezikshme për shëndetin, përdorimin materialeve që shkaktojnë mbejtje të dëmshme për jetën dhe shëndetin e përdoruesve të ambienteve.

Ndriçimi në ambiente duhet të jetë shplohës dhe plotësojë normativat e detyrueshme nga tipologjia funksionale e tyre. Shpërndarja e ndriçuesve në ambient duhet të përshtatet me kërkesat funksionale të tij, duke ruajtur sipas rastit një shpërndarje të njëtrajtshme të dritës, apo duke shtuar ndriçuesat pranë tavolinave, ose zonave të punës. Kjo zgjidhje duhet gjithsesi të përmbushë kërkesat nominale të ambientit për ndriçim, sipas tipologjisë, pa cënuar konceptin e përgjithshëm të pasqyruar në projektin arkitekturor mbi estetikën, zgjidhjen e tavanëve, mureve dhe hapsirave të punës dhe ndriçimin e përgjithshëm të interierit. Tipologjia, estetika, këndi i hedhjes së dritës dhe gjeometria e secilit ndriçues duhet të përcaktohet në bashkëpunim me projektuesin arkitekt duke mbajtur në konsideratë lartësinë e ambientit dhe tavaneve të varur (në rast se janë propozuar). Drita ideale duhet të vijë në tavolinën e punës me kënd anësor dhe jo pingul. Shkëlqimi i sipërfaqeve duhet të kufizohet.

Pavarësisht referencave më sipër, nisur nga specifikat e veçanta të secilit ambient funksional, mbetet në gjykimin e projektuesit përdorimi i një standardi minimal ndriçimi, ose një tjetri, bazuar në kërkesat e saktësuara për secilin ambient, në përputhje me veprimtarinë dhe proceset e punës, për të cilët është projektuar.

Vendosja e prizave elektrike, Lan, sistemeve audio video etj. duhet të përputhet me hapsirat e punës të propozuara nga arkitekti në projektin e mobilimit.

Në tërësi në hartimin e projektit do të mbahen parasysh këto kërkesa për projektimin dhe zbatimin e rrjetit elektrik dhe elektronik:

Të gjithë instalimet elektrike, kabllot dhe ndriçuesit, çelësat, prizat etj. duhet të jenë hermetikë.

Ndriçimi elektrik duhet të zbatohet normat e CE.

Sistemi elektronik duhet të konceptohet me server (servera) qendror të veçantë.

Në projektin elektrik duhet të parashikohet edhe instalimi i ndriçimit të emergjencës, në rastet e shkeputjeve të rrymës, apo emergjence të çfarëdo lloji.

Në ndërtesë duhet të parashikohet projektimi dhe instalimi i sistemit të tokëzimit dhe mbrojtjes atmosferike.

Në ndërtesë duhet të parashikohen sisteme elektrike dhe elektronike të nevojshme për mirëfunksionimin e ndërtesës si institucion publik. Krahas sa më sipër, të shqyrtohet mundësia e integritit të burimeve të rinovueshme të energjisë.

Rikonstruksioni i objekteve duhet të përfshijë edhe instalimin e ri elektrik, telefonik dhe rrjetin e internetit në laboratorin e informatikës dhe zyrave të administratës.

Konsulenti duhet të parashikojë ndriçimin e ambienteve me ndriçues me fuqi të mjaftueshme për të garantuar një ndriçim në përputhje me normat në fuqi, dhe një numër të mjaftueshëm prizash për secilin ambient, sipas destinacionit të tyre. Projektuesi duhet të japë detajin e fiksimit të ndriçuesve si dhe dimensionet e elementeve në të cilat ato do të kapen.

Panelet e komandimit të vendosen të rinj sipas standardeve bashkëkohore.

Në këto kushte projektuesi duhet të parashikojë nqs nevojitet dhe instalimin e rrjetit elektrik trefazor me fuqi të tillë që të sigurojë funksionim normal të sistemit elektrik me të gjitha pajisjet e saj.

Projektuesi duhet të sigurojë Miratimin e projekteve elektrike në OSHEE, si dhe të përcaktojë edhe pikën e lidhjes me energji elektrike, nga rrjeti i fuqisë (kabina ose transformatori i zonës).

Projektuesi duhet të parashikojë vendosjen e matësit elektrik trefazor, dhe vlerën e përafërt të shtrimit të kabllit nga sahati deri te pika e lidhjes së miratuar.

Projekti elektrik të jetë i shoqëruar me licencën e noteruar të inxhinierit elektrik, e cila do të shërbejë për procedurat e mëtejshme për miratimin e pikës së lidhjes me OSHEE -n. Në projekt-preventiv duhet të parashikohen edhe llambat me bateri të karikueshme, në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike.

Rrjeti telefonik dhe kompjuterik

Në objekt të shikohet mundësia e sistemit telefonike të godinës që të mund të përdoret në çdo moment. Godina duhet të jetë e pajisur me sistem telefonik, rrjetin data dhe sistemi vëzhgimit me kamera CCTV, shoqëruar me sistemin e kontrollit të hyrje/daljeve "access control".

Sistemi elektrik, ndriçimi i emergjencës dhe sigurisë.

Ndriçuesit luminishent dhe prozhektorët të zëvendësohen me ndriçues led, si ndriçues më ekonomik.

Ndriçimi i emergjencës duhet të futet automatikisht në punë dhe të ketë një kohë pune të paktën 1 orë në rast se stakohet tensioni. Ndriçimi i emergjencës dhe i sigurisë duhet të vendoset në ambientet e mëposhtme:

- • Korridore, të cilat shërbejnë edhe si rrugë largimi emergjence;
- • Dhoma që shërbejnë si pika grumbullimi;

- Në ambientet që nuk kanë dritare;

Projektuesi duhet të parashikojë ndriçimin e dhomave me ndriçues me fuqi të mjaftueshme për të garantuar një ndriçim në përputhje me normat në fuqi, dhe një numër të mjaftueshëm prizash për secilin ambient, sipas destinacionit të tyre.

Në projekt-preventiv duhet të parashikohen edhe ndriçuesit e emergjencës, në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike.

Kërkesat teknike kundrejt projektit mekanik

Projekti i sistemit të ngrohje – ftohjes dhe ventilimit duhet të përfshijë:

Llogaritjet e ngarkesave termike të nevojave për ngrohje – ftohje të secilit ambient dhe nevojave të veçanta të gjithësecilit prej tyre. Projekti i ngrohje/ftohjes/ventilimit duhet të mbështetet në normativat e përcaktura në Standartet ASHRAE, në të dhënat klimatike për qytetin e Lezhës, normat ndërkombetare, si dhe normat Evropiane, apo çdo standard tjetër të pranuar në Republikën e Shqipërisë.

Hartimin e projektit të zbatimit të instalimeve të brendëshme të sistemit të ajrit të kondicionuar.

Hartimin e preventivit të sistemit të ajrit të kondicionuar me zëra pune.

Specifikimet teknike për të gjithë materialet sipas normave të prodhimit të CE dhe pajisjet që do të përdoren nga projektuesit gjatë hartimit të projektit në fjalë.

Relacionin teknik të hollësishëm për zbatimin me korrektësi të punimeve të projektit.

Sistemi i propozuar nuk duhet të bjerë ndesh me funksionin e ndërtesës. Si i tillë, komforti termik, qarkullimi i mirë i ajrit dhe lagështia relative e krijuar në ambient është shumë e rëndësishme. Zgjidhjet për sistemin e ngrohjes, ftohjes dhe ventilimit duhet të përfshijnë të gjithë ambientet, duke ruajtur parametrat e këshillueshëm për tipologjinë e secilit ambient, në përputhje me nevojat funksionale të tij.

Projekti mekanik duhet të harmonizohet me konceptin e përgjithshëm arkitekturor të shprehur në projektin përkatës. Krahas sa më sipër, të shqyrtohet mundësia e integritit të burimeve të rinovueshme të energjisë për ngrohje dhe përdorimit të sistemeve me ndikim minimal në mjedis.

Sistemi i ngrohje-ftohjes, do të realizohet nëpërmjet sistemit qendror. Sistemi i ngrohjes do të bëhet sipas standarteve që kërkon shërbimi spitalor.

Kërkesat teknike kundrejt projektit të mbrojtjes nga zjarri

Projekti për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin duhet të realizohet në nivel godine në bazë të standardeve dhe normave lokale, si dhe ato të vendeve të Komunitetit Europian. Sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit duhet të respektojë të gjitha kërkesat e detyrueshme shtetërore që kanë të bëjnë me normat / standardet që janë në fuqi aktualisht në Shqipëri si dhe normat Evropiane.

Ligjet, rregulloret, normat dhe standardet, mbi të cilët duhet të hartohet projekti, objekt i kësaj detyre projektimit janë paraqitur në vijim: - Ligji nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”; - Rregullore “Mbi masat e mbrojtjes kundër zjarrit në projektimin e ndërtesave të çdo lloji “Vendim nr.162 datë 19.4.1965, e ripunuar; - Udhëzimet e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr.425 date 24.7.2015 “Për pranimin, administrimin e dokumentacionit teknik dhe grafik të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dhe lëshimin e akteve teknike”.

Projektimi i masave për mbrojtjen kundër zjarrit dhe shpëtimin nuk duhet të trajtohen të ndara nga përgatitja e projekteve specifike; projektit arkitekturor, konstruktiv, hidrosanitar, elektrik dhe mekanik. Masat e nevojshme për mbrojtjen nga zjarri duhet të reflektohen edhe në projektet më sipër cituar, në përputhje me udhëzimet dhe zgjidhjet e trajtuara në projektin e mbrojtjes kundra zjarrit.

Në projektin e mbrojtjes kundra zjarrit duhet të përfshihen të gjitha masat aktive dhe pasive, për mbrojtjen nga zjarri të ndërtesës që projektohet. Relacioni teknik i mbrojtjes nga zjarri duhet të përmbajë minimalisht të dhënat sipas pikës 5 të Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.425 date 24.7.2015 "Për pranimin, administrimin e dokumentacionit teknik dhe grafik të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dhe lëshimin e akteve teknike".

Kërkesat kundrejt raportit dhe auditimit të eficensës energjitiqe.

Mbështetur në VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 (hyrja në fuqi 21.05.2015) "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", e azhurnuar, pjesë e dokumentacionit për marrjen e Lejes së Ndërtimit duhet të jetë edhe projekti i eficensës energjetike, në rastet kur është e detyrueshme me ligj.

Pjesë e dokumentacionit të projektimit duhet të jetë edhe Raporti mbi eficiencyn e energjitiqe të ndërhyrjes së propozuar. Projekti i propozuar dhe specifikimet teknike duhet të përmbushin kriteret për eficiencyn e energjisë, në përputhje me propozimet dhe masat e reflektuara në këtë raport.

Kur projektohet një ndërtesë e re ose kur një ndërtesë duhet t'i nënshtrohet një rinovimi të rëndësishëm, subjekti që ka apo do të ketë në pronësi apo përgjegjësi administrimi këtë ndërtesë, duhet të marrë në konsideratë zbatimin e kërkesave të Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes së performancës së energjisë së ndërtesave dhe të analizojë mundësinë e përdorimit të sistemeve me një performancë të lartë të energjisë, të parashikuara në Ligjin 116/2016 "PËR PERFORMANCËN E ENERGIJË SË NDËRTEHAVE" neni 8 e vijues.

Hartimi i propozimeve të zgjidhjeve teknike në respektim të kriterëve të eficensës energjitiqe të ndërtesës së parashikura, duhet të kryhet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet të gjithë specialistëve të përfshirë, më qëllim që në të gjithë projektet specifike të mbahen në konsideratë kriteret e eficensës energjitiqe, për arritjen e një performancë sa më të mirë energjitiqe të të gjithë ndërtesës.

Hartimi i Raportit të eficensës energjitiqe duhet të kryhet në përputhje me metodologjinë kombëtare të llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa, sipas nenit 5 të Ligjit 116/2016 më sipër cituar.

Gjatë procesit të projektimit duhet paraprakisht të kryhet vlerësimi i mundësisë së përdorimit të sistemeve alternative me eficiencyn të lartë energjitiqe. Gjatë vlerësimit teknik të mundësisë së përdorimit të sistemeve alternative me eficiencyn të lartë energjitiqe, duhet të merren në konsideratë çështjet mjedisore dhe ekonomike.

Projekti i propozuar dhe specifikimet teknike duhet të përmbushin kriteret për eficiencyn e energjisë, në përputhje me propozimet dhe masat e reflektuara në këtë raport.

Kërkesat teknike kundrejt shërbimeve që i takojnë nëntokës.

Shërbimet që i takojnë nëntokës duhet të paraprijnë procesin e projektimit. Hartimi i tyre duhet të respektojë kuadrin ligjor në fuqi dhe eurokodet aktuale.

Kërkesa të përgjithshme.

Gjatë hartimit të projektit do të mbahet kontakt i vazhdueshëm me autoritetet e Institucionit dhe grupin e punës së përpilimit të detyrës së projektimit, i cili do të vendosë në dispozicion të grupit të punës për hartimin e projektit një fotokopje të dokumentacionit tekniko – juridik që disponon, në shërbim të procesit të projektimit;

Autorët e projekteve duhet të marrin përsipër përveç realizimit të planeve dhe skicave (vizatimet teknike) të përshkruajnë në mënyrë të detajuar të gjitha zërat e punimeve që do të përmbajë preventivi;

Projekti të shoqërohet me një relacion teknik ku të përshkruhen saktë zgjidhjet e ofruara teknike, avantazhet dhe prioritetet e tyre, materialet dhe paisjet e përdorura, vetitë dhe karakteristikat e tyre;

Gjithashtu, grupi i projektimit duhet të marrë përsipër konsultat me zbatuesin si dhe predispozicionin për tu angazhuar në ndryshimet e mundëshme që mund të lindin, si pasojë e situatave të paparashikuara apo shmangieje si evoluim i kërkesave të investitorit në procesin e realizimit;

Projekti duhet të përfshijë dhe specifikimet teknike për materialet që do përdoren, por projektuesi duhet të ketë kujdes të mos përcaktojë markën apo çdo detaj tjetër që identifikon prodhuesin;

Në përgatitjen e projekt–preventivit të merret në konsideratë funksionimi, komoditeti dhe estetika e ambienteve të tij. Gjithashtu, preventivat e punimeve të jenë të ndara me grupe zërash pune, spas ambienteve që të mund të kryhen në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri.

Kërkesa të veçanta.

Zgjidhjet dhe ndërhyrjet e propozuara duhet të bazohen në kritere të tilla:

Të kenë ndikim minimal në mjedis.

Të jenë propozuar në përputhje me funksionin e ambientit.

Të respektojnë Legjislacionin në Fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë këtu legjislacionin në fushën higjieno – sanitare dhe legjislacionin në fushën e mbrotjes nga zjarri.

Çdo ndërhyrje të jetë e mirëjustifikuar nga pikëpamja teknike dhe funksionale.

Shërbimet e kërkuara sipas fazave.

Grupi i projektimit duhet të kryejë shërbimet e mëposhtme:

Hartimin i projekt preventivit duhet të përfshijë fazat si vijon:

Kosto totale do të përcaktohet nga preventivi përfundimtar i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike, relacionin, si dhe duke marrë parasysh dhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standardet e pranuar.

Në hartimin e preventivit çmimet e referencës do të jenë sipas legjislacionit, mbështetur në Manualin Teknik të Çmimeve në fuqi, **ne sistemin e integruar ne e –albania** . Për zërat e punimeve që nuk gjenden në manual, projektuesi duhet të hartojë analiza përkatëse, të cilat do të bashkëlidhen të detajuara projekt zbatimit, kjo për të siguruar kursimin dhe efçencën e përdorimit të fondeve.

Faza I - Analiza e detyrës së projektimit / përcaktimi i bazës së projektit.

Faza III - Projektideja përfundimtare.

Faza IV - Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit.

Faza V - Projekti i zbatimit.

Faza VI - Preventivi përfundimtar bazuar ne \manualin 2023.

Shërbimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis duhet të përfshijë fazat si vijon:

Faza I - Aplikimi për VNM paraprake.

Shërbimi Topografik duhet të përfshijë fazat si vijon:

Faza I - Analiza e detyrës së projektimit/percaktimi i bazës së projektit

Faza II - Planet e pozicionimit dhe rilevimit

Faza IV - Vizatime te piketave

Faza V - Projekt zbatimi Piketat për qëllime planifikimi

Shërbimet që i takojnë nëntokës dhe punimeve në themele duhet të përfshijnë fazat si vijon:

Faza I.

1. Qartësimi i kërkesave të projektit

2. Përcaktimi i strukturës së tokës nga dokumentet ekzistuese, duke specifikuar dhe prezantuar strukturën e nëntokës, sipas testeve të kërkuara.

Faza II.

Analizimi dhe prezantimi i rezultateve të testeve laboratorike dhe në terren për strukturën e nëntokës,

Vlerësimi i gamës së lëkundjeve të tokës me përmbajtje uji,

Vlerësimi i nëntokës, specifikimi i parametrave kryesorë në strukturën e tokës.

Faza III.

Paraqitja e rekomandimeve për qëndrueshmërinë e themeleve dhe presionet e lejuara në tokë, në rast të veçantë propozohet dhe dimensionimi i themelit.

Deklaratë mbi cedimet e pritura nga realizimi i veprës për të realizuar shërbimet bazë të përfshira në projektin final për veprat inxhinierike sipas nenit 39.

Udhëzimet për të gërmuar themelet dhe për të mbajtur edhe strukturën e thatë, edhe kontrollimin e ndikimit të projektit në strukturat ngjitur.

Standarde në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për personat me aftësi të kufizuara, të verbrit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihet parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për planifikimin e territorit” I ndryshuar .

Realizimi i Projektit

Projekti i paraqitur për strukturën ‘shtese anesore 3 kat & rikonstrukcion palestere & rikonstrukcion i pjesshem i sistemit elektrik ,sistemin i pjesshem i oborrit te Shkolles 9 – vjeçare, 3 kat, ‘Gjergj Fishta Lezhe’,

Duke iu referuar VKM Nr. 354, datë 11.5.2016 “Për Miratimin e manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim” duhet të kalojë në këto faza:

Faza e I: Analiza e detyrës së projektimit e cila përfshin:

Shërbimet bazë:

- Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit.
- Dhënia e konsultave mbi nevojën edhe shkallët e shërbimit.
- Përmbledhja e rezultateve

Shërbimet të veçanta

- Studimi i gjendjes
- Analiza e vendodhjes
- Planifikimi i punës
- Verifikimi i rëndësisë së mjedisit
- Verifikimi i pajtueshmërisë me mjedisin

Faza e II: Projekt-ideja përfundimtare (sistemet dhe planifikimi i integruar)

Projekt Idea duhet të realizohet në jo më pak se një variant, ku për secilin variant duhet të paraqitet relacioni teknik mbi ndërhyrjet, projekti i ndërhyrjeve, kostoja e ndërtimit për secilin variant dhe specifikimet teknike. Paraqitja e varianteve duhet të bëhet në bazë të ndërhyrjes, të rezultateve të vlerësimit të kostonë së ndërtimit dhe asaj të shfrytëzimit.

Variante me treguesit më social - ekonomik dhe teknik që do përzgjidhet , do vazhdoj procedurën e hartimit të projekt zbatimi.

Faza e III: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, i cili duhet të mbështetet në ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” I ndryshuar .

Faza e IV: Projekti i Zbatimit

Të kryhet hartimi i Projekt - Zbatimit të objektit ‘me përmbajtjen si më poshtë :

- Raporti Teknik
- Topografinë e gjendjes ekzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjëndjen e sotme (me leje dhe pa leje)
- Projektin arkitektonik: Relacion arkitektonik i objektit, Fasadat, Planimetritë ekzistuese dhe të reja të objektit, Prerjet e godinës, Plan mobilimin e ambienteve, Plani i mbulesës, etj;
- Projektin e zbatimit/konstruksionin të objektit: Plani i strukturave dhe detajet, Plani i themeleve, etj.
- Projekt Zbatimin e instalimeve hidrosanitare, të kanalizimeve
- Projekt Zbatimin e instalimeve elektrike, të shoqëruara me licencën e noteruar të projektuesit
- Projekt Zbatimin e instalimit të sistemit të ngrohjes, të mbrojtjes kundër zjarrit të strukturës të miratuar nga Drejtoria e Zjarrit dhe Shpëtimit
- Projektin e eficensës energjitike , dhe miratimin perkates nga Ministria
- Projektin e sistemit dhe të gjelbërimit të oborrit, projektin e ambienteve të lojrave;

- Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen.
- Grafikon e punimeve të detajuar sipas zërave të punës
- Rekomandime për materialet e ndërtimit që do të përdoren
- Relacionin gjeologjik për shtesat e reja të parashikuara,
- Relacion sismik
- Eficensa energjike
- Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)
- Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujërave të shiut
- Analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve që nuk janë në manual;
- Plan organizimim e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve që do jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur në grafikun e punimeve;
- Licencë të firmës projektuese, licencë të ekspertit mjedisor dhe ekstrakt i regjistrit tregtar.

Rekomandime për projektuesin

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me zonën ku ndodhet shkolla. Sistemin ekzistues të largimit të ujërave, Sistemin e furnizimit të zonës me ujë të pijshëm, Sistemin ndriçues rrugor, distancat e lejuara si dhe kriteret urbane të zonës në fjalë.
- Projektuesi duhet të përdore studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia e Lezhë , seksioni i Urbanistikës dhe nga kadastra.
- Konsulentit do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria Arsimore Lezhë edhe një Program Standard i ambienteve ku janë përcaktuar standardet minimale të organizimit të hapësirave të brendshme, lloji i ambienteve të detyrueshme, instruksione mbi funksionet që duhet të akomodohen, sipërfaqet funksionale të rrethimeve dhe sistemeve të jashtme, etj.
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standardin e kërkuar.

Gjithashtu projektuesi duhet të paraqesë

- Plani i vendosjes së strukturës i cili do të hartohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë së Lezhë.
- Rilevim topografik të sheshit të shkolles .
- Licencë të shoqërisë projektuese + ekstrakt të Regjistrit Tregtar
- Licenca të inxhinierëve projektues, licenca të ekspertit mjedisor + deklarata noteriale të inxhinierëve projektues.
- Projekti i plotë elektrik (planvendosjen e të gjitha pajisjeve elektrike, sistemi data - telefoni, projekti i MNZ, i mbrojtjes atmosferike dhe tokëzimit) të printuara në formatin A3, shkalla 1:1000 në 3 kopje origjinale; Kopja e noterizuar e licencës së inxhinierit elektrik që ka kryer projektin
- Planvendosja e objektit në shkallën 1 : 1000 format A3 .

Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar

Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë e Lezhës . Stafi që kërkohet duhet të mbulojë :

- Arkitekt
- Inxhinier ndërtimi strukturist (konstruktor)
- Inxhinier gjeodet
- Inxhinier hidroteknik/hidraulik
- Inxhinier për sistemet e ngrohjes
- Inxhinier gjeolog, në rastin kur ndërhyrje në konstruksionin e objektit
- Inxhinier elektrik
- Preventivues

- Inxhinier mjedisi;
- Ekspert te eficenses energjitike
- Staf mbështetës për fushat e mësipërme.

Raportimi

Raportet dhe dokumentat duhet të jenë në 5 (pesë) kopje, në gjuhën shqipe ku njëra nga kopjet të jetë e printuar me ngjyra. Vizatimet duhet të jenë të lexueshme në formatin “dëg” (AutoCad 2007-2012). Të gjitha materialet do të dorëzohen edhe në soft-copy (në 5 CD).

Relacioni teknik që shoqëron projektin duhet të përmbajë:

- Raportin teknik të projektimit arkitektonik
- Raportin teknik të projektimit konstruktiv ku duhet të përfshihet edhe raporti mbi llogaritjet për gjithë strukturat (themelet, shkallëve, soletave, arkitrarëve, trarëve, etj.) si dhe masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, siguria e kalimit në objekt gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit. Në këtë raport do të bashkëngjiten dhe anekset përkatëse ku janë të gjitha llogaritjet përfshirë modelin kompjuterik të llogaritjeve për kontrollet eventuale nga ana e investitorit.
- Relacionin sizmologjik të truallit (kur nuk ka studim, një përshkrim i përgjithshëm)
- *Specifikimet Teknike të cilat duhet të jepen për çdo zë pune.*
- Relacioni gjeologjik dhe vetitë fiziko-mekanike të dherave ku duhet të paraqiten.
- *Cilësitë fiziko-mekanike të dherave dhe të shtresave në themelet e objektit ekzistues.*
- *Rekomandime dhe propozime për raste të veçanta.*
- Certifikata e Performances se Energjise

Gjithashtu per kete projekt, bazuar ne Ligjin Nr 124/2015 “Per Eficensen e Energjise” si dhe Vendimit Nr.537, date 08/07/2020 per miratimin e kerkesave minimale te performances se energjise se ndertesave dhe elementeve te ndertesave duhet te realizohet raporti i auditimit te energjise dhe Certifikata e Performances se Energjise.

Oponenca teknike

Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik. Me “objekte me akses publik”, sipas këtij neni, do të kuptohen të gjitha objektet, ku, pavarësisht statusit të pronësisë së tyre, qytetarët kanë akses të lirë hyrjeje, si: kinema, teatro, stadione, markete etj.”.

- Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis (nese e kerkon ligji)
- Raport elektrik.
- Raport hidro, kush, kuz.
- Raport i sistemeve mekanike, ngrohje – ftohje, mnz. etj...
- Raport teknik; Preventiv; Rilevimi.
- Grafiku i punimeve.
- Licensat e stafit projektues.
- Deklaratat e pergjegjesis profesionale te stafit pjesmarres ne hartimin e projektit.Dorëzimi final, fizik, i projektit të zbatimit, do të konsiderohet ai, i cili do të ketë kaluar të gjitha fazat e mësipërme, si te dhe bazuara në: Ligji 107/2014 Për planifikimin e zhvillimit te territorit i ndryshuar ; Ligji 69/2012 Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar ;Ligji nr 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” te ndryshuar ;Ligji 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” i ndryshuar ;Ligj nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtësave”

;Ligji nr. 152/2015 Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin. Projektuesi do të përdorë edhe standardet në fuqi të projektimit të hartuara nga MASH për objektet arsimore: VKM 319 datë 12.04.2018.

Paraqitja e vizatimeve.

Vizatimet në fazë projekt zbatimi duhet të paraqiten në format A3, të jenë të lexueshme dhe të përmbajnë si minimum fletët si më poshtë:

- Topografinë e gjendjes ekzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjëndjen e sotme (me leje dhe pa leje)
- Planimetria e përgjithshme e objektit në Shk. 1:200; 1:500
- Planimetritë e kateve ekzistuese Shk. 1:100, 1:50
- Planimetritë e objektit pas ndryshimeve Shk. 1:100; 1:50
- Fasadat ekzistuese Shk.1:100
- Fasadat e reja në 2D dhe 3D Shk.1:100
- Prerjet e godinës (në të dy drejtimet) Shk.1:100
- Planimetria e themeleve Shk.1:100
- Prerje të themeleve dhe detajet Shk.1:20; 1:10
- Plani i strukturave detaje Shk.1:100; Shk.1:50
- Planimetritë e mobilimit të shkollës Shk.1:100
- Planimetria e rrjetit të kanalizimeve në shkallën Shk. 1: 100
- Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve Shk.1:10, 1:20
- Planimetria e furnizimit me ujë në Shk. 1: 200, 1:100
- Skemat aksonometrike të furnizimit me ujë, detaje të pajisjeve hidrosanitare Shk.1:100
- Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të ujësjellësit Shk.1:20, 1:10
- Planimetria, aksonometria dhe detaje të sistemit të ngrohjes Shk.1:100
- Planimetria dhe detaje të sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit Shk.1:100
- Planimetria e dhomës së kaldajës, konstruksioni, detaje Shk.1:100;1:50
- Planimetri dhe detaje për ndriçimin, fiksimin e ndriçuesve në tavan, instalimin e kuadrit kryesor etj. Shk.1:100;1:50
- Planimetria e skemës së shpërndarjes së fuqisë në të gjithë objektin, Shk. 1:100
- Planimetritë për telefoninë, rrjetin e internetit Shk.1:100; 1:50
- Planimetria e ndriçimit të jashtëm dhe detaje të tij Shk.1:100; 1:50
- Planimetria e ambienteve sportive dhe ambienteve të gjelbëruara dhe detaje Shk.1:100; 1:50
- Planimetria e murit rrethues, tipin dhe detajin e fiksimit të stolave Shk.1:100; 1:50.
- Planimetria disiplinimit dhe shkarkimit të ujërave sipërfaqësore dhe detajet përkatëse shk.1: 100; 1:50.
- Planimetria e Shpronësimeve, Kjo planimetri do të identifikojë pronat dhe godinat që preken nga realizimi i projektit dhe gjithashtu të bëhet llogaritja e sipërfaqes që preket për arsye shpronësimi.

Faza e V: Projekti i Zbatimit

Preventivi i plotë i kushtimit të veprës. Përgatitja e preventivit të detajuar sipas specifikimeve të projektit me programin e punimeve të ndara sipas kategorive dhe zërave të punës. Harmonizimi dhe kordinimi i kategorive të punës së projektit të bëra nga specialistet e përfshirë në planifikimin e projektit.

Investimi Themelor

Investimi themelor do të dal nga varianti më i mirë tekniko-ekonomik i aprovuar nga Bashkia Lezhë.

Sqarime të fundit

Të dhënat e nevojshme për projektim, siç janë: gjendja e rrjetit ekzistues të ujësjellësit, të kanalizimeve, ndriçimit, kabinat e tensionit të lartë, planin rregullues të zonës, etj, do t'i bashkëngjiten kësaj detyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

MIRATOHET

PJERIN NDREU
KRYETAR



DETYRË PROJEKTIMI

PËR REALIZIMIN E STUDIM PROJEKTIMIT:

RIKONSTRUKSION SHKOLLE DHE SISTEMIMI I TERRENEVE SPORTIVE
TË SHKOLLES 9 – VJEÇARE ‘DODË GEGË JAKU’ MANATI, NJESIA
ADMINISTRATIVE KOLSH , LEZHE

Lezhë
Korrik 2024

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
Institucioni përfitues	3
Arsyetimi i nevojës për ndërhyrje.	3
Baza ligjore.	3
Qëllimi i projektit të investimit.	3
Objektivat e projektit të investimit.	3
PËRSHKRIM I DETYRËS SË PROJEKTIMIT	4
Qëllimi	4
Objektivat	4
Përshkrim i përgjithshëm	4
Pozicionimi i parcelës që zhvillohet	4
Gjendja faktike	7
Kërkesat teknike planimetriko – kompozicionale dhe infrastrukturore	10
Kërkesat teknike kundrejt projektit arkitekturor.	12
Hapësirat e brendshme të sanitarisë	14
Trajtimi i ujërave të zeza dhe atmosferike	15
Drenazhimi i lokacionit	15
Sistemi i drenazhit të ujërave atmosferikë	15
Drenazhimi i kulmit	16
Ajrosja e mjediseve	16
Sistemet dhe rregullat për mbrojtje nga zjarri	16
Qasja në lokacion	16
Pajisjet e fikjes së zjarrit	16
Mbrojtja nga rrufetë	17
Projektimi për personat me nevoja të veçanta	18
Kërkesat teknike kundrejt projektit konstruktiv.	19
Mbulesa	Error! Bookmark not defined.
Soletat	Error! Bookmark not defined.
Suvatimet.	19
Lyerja e mureve të brendshëm dhe të jashtëm	20
Fasada	20
Shtresat e pllakave	20
Shkallët	20
Dyer, dritare	20
Kërkesat teknike kundrejt projektit hidrosanitar.	20
Kërkesat teknike kundrejt projektit elektrik dhe elektronik.	22

Rrjeti telefonik dhe kompjuterik	23
Sistemi elektrik, ndriçimi i emergjencës dhe sigurisë.	23
Kërkesat teknike kundrejt projektit mekanik	24
Kërkesat teknike kundrejt projektit të mbrojtjes nga zjarri	24
Kërkesat kundrejt raportit dhe auditimit të efikasitetit energjitike.	24
Kërkesat teknike kundrejt shërbimeve që i takojnë nëntokës.	25
Kërkesa të përgjithshme.	25
Kërkesa të veçanta.	26
SHËRBIMET E KËRKUARA SIPAS FAZAVE.	26
Hartimin e projekt preventivit duhet të përfshijë fazat si vijon:	26
Faza I - Aplikimi për VNM paraprake.	26
Faza I.	26
Faza II.	27
Faza III.	27
STANDARDE NË PROJEKTIM	27
Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik	27
REALIZIMI I PROJEKTIT	27
Faza e I: Analiza e detyrës së projektimit e cila përfshin:	28
Faza e II : Projekt-ideja përfundimtare (sistemet dhe planifikimi i integruar)	28
Faza e III : Projekti për miratimin e lejës së ndërtimit.	28
Faza e IV: Projekti i Zbatimit	28
Rekomandime për projektuesin	29
Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar	29
RAPORTIMI	29
Oponenca teknike	30
Paraqitja e vizatimeve.	30
Faza e V: Projekti i Zbatimit	31
Investimi Themelor	31
Sqarime të fundit	31

HYRJE

Institucioni përfitues

Institucioni përfitues i shërbimit në fushën e projektimit është Bashkia Lezhë. Përfituesi i këtij shërbimi është Institucion Publik.

Misioni i këtij institucioni është të sigurojë një infrastrukturë sa më cilësore arsimore për popullatën dhe posaçërisht për shëndetin e nënës dhe fëmijës së porsalindur.

Përfituesi i projektit është sistemi arsimor, për infrastrukturën fizike të të cilit është përgjegjës pushteti vendor.

Arsyetimi i nevojës për ndërhyrje.

Problematika që sjell nevojën e investimit. Në rast se nuk ka problematikë por përputhet me strategjinë e zhvillimit shtjellohet strategjia që e bën të nevojshëm investimin.

Ky projekt është nevojë e rëndësishme e momentit e institucionit për realizimin e veprimtarisë së tij institucionale, si dhe përputhet me strategjinë e zhvillimit të Bashkisë Lezhë dhe orientimeve të ministrisë së linjës.

Baza ligjore.

Bazuar në statusin ligjor të institucionit, ky shërbim në fushën e projektimit duhet të përmbushë kërkesat dhe të marrë në konsideratë referencat si vijon:

1. Ligj Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i përditësuar
2. Rregulloren e Zhvillimit të Territorit (në fuqi).
3. VKM Nr.1503, datë 19.11.2008 “Për miratimin e Rregullores “Për shfrytëzimin e hapsirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar””.
4. Ligj Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.
5. Ligj Nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë”.
6. “Rregullore për formatin e auditimit energjistik dhe pagesën e audituesit energjistik”, miratuar me Urdhër Nr. 5, datë 12.01.2021 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.
7. Manualët, standardet dhe kushtet teknike shtetërore dhe evropiane të projektimit të objekteve spitalore.
8. VNM
9. Çdo ligj, apo manual tjetër, të lidhur me projektimin e ndërtesave të kësaj natyre.

Qëllimi i projektit të investimit.

Qëllimi i rikonstruksionit është që të përmirësohet infrastruktura e procesit mësimor në shkollën 9-vjeçare “Gjokë Dedë Jaku”, Manati, Lezhë nëpërmjet rikonstruksionit të godinës dhe mjediseve sportive, në mënyrë që të rritet edhe cilësia e mësimdhënies dhe nxënies.

Objektivat e projektit të investimit.

Objektivi kryesor i këtij projekti është të sigurojë ambiente të projektuara dhe të përshtatura në përputhje me kërkesat dhe nevojat e veprimtarisë arsimore, në respektim të standardeve bashkëkohore infrastrukturore dhe çdo akti juridik, normativ, apo standard në fushën e projektimit të ndërtesave arsimore në Republikën e Shqipërisë dhe më gjerë, në shërbim të rritjes së cilësisë së ofrimit të shërbimeve.

Objektivat specifikë të këtij projekti investimi përmbledhen në vazhdim:

- Organizimi funksional i mjediseve shkollore dhe zonimi hapësinor i tyre, në përputhje me kërkesat dhe standardet infrastrukturore për objektet arsimi të mesëm ulët.
- Pajisja e objektit me sisteme, rrjete dhe materiale ndërtimore bashkëkohore.
- Përmirësimi i gjendjes fizike të ndërtesës për të përmbushur kritere infrastrukturore për efikasitetin energjetic, komoditetin termoakustik, mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, kërkesat higjieno - sanitare dhe përshtatjen e mjediseve për personat me aftësi të kufizuara.
- Përmirësimi i mjediseve sportive të shkollës në përputhje me kërkesat për mjedise rekreative, kërkesat drenazhimit e ujërave të shiut, ato për mbrojtjen e mjedisit dhe kriteret për orientimin e fluksit të nxënësve.

PËRSHKRIM I DETYRËS SË PROJEKTIMIT

Qëllimi

Detyra e Projektimit ka për qëllim parashtrimin e të dhënave thelbësore, njohëse, kërkesave dhe nevojave specifike të institucionit përfitues, në cilësinë e Porositësit, kundrejt shërbimit të kërkuar, si dhe orientimet mbi problematikën aktuale të shtruar për zgjidhje, mbi bazën e të cilave, grupi i projektimit, do të hartojë projektin për Rikonstrukcionin e Shkollës 9-vjeçare “Dedë Gegë Jaku”.

Objektivat

Detyra e projektimit ka këto objektiva:

- Të prezantojë grupin e projektimit me vendndodhjen, infrastrukturën dhe problematikën e gjendjes faktike të objektit që i nënshtrohet ndërhyrjes.
- Të përshkruajë kërkesat sasiore dhe cilësore kundrejt shërbimit të porositur.
- Të evidentojë kërkesat profesionale kundrejt grupit të projektimit.
- Të shtjellojë formën, mënyrën dhe afatet e raportimit të materialeve pranë Porositësit.

Përshkrim i përgjithshëm

Pozicionimi i parcelës që zhvillohet

Vendndodhja: Manati , Njësia Administrative Kolsh ,Bashkia Lezhe



Pozicionimi i objektit lidhur me qendrën e qytetit të Lezhës



Pozicioni i objektit në hartë kadastrale dhe ortofoto

Përshkrim: Shkolla 9 - vjeçare ‘ Dode Gege Jaku ’ ne Manati , është ndërtuar në vitin 1946 dhe rikonstruktuar per here te fundit ne vitin 2018. Godina e shkollës është një objekt nje kat dhe mbulesa është e tipit çati tjegulle .

Siperfaqe e gjurmes : 400 m²

Siperfaqe ndertimi totale : 400 m²

Siperfaqe e prones (truall+ gjurme) : 3000 m²

Kapaciteti: Në total frekuentojnë mësimin rreth 90 nxënës nga te cilet 61 nxenes nga klasa e pare deri ne te nenten dhe 17 femije frekuentojne kopeshitin e shkolles . Mesimi zhvillohet me një turn.

Të dhëna statistikore për vitin shkollor 2023-2024 - Numri i nxënësve të regjistruar sipas klasave:

Kopësht		Klasa e pare		Klasa e dyte		Klasa e trete		Klasa e katert		Klasa e peste		Klasa e gjashte		Klasa e shtate		Klasa e tete		Klasa e nente		Klasa e pare deri e nente		
Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	M
23	7	7	3	6	1	9	6	8	5	6	2	14	7	5	0	0	0	6	1	61	25	36

Nxenes me aftesi e kufizuar				Nxenes Rom				Nxenes Egjiptian			
Mendore		Fizike		Cikli fillor		Cikli larte		Cikli fillor		Cikli larte	
Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F
1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Gjendja faktike

Vlerësimi fizik i objektit: Megjithëse shkolla është e mirëmbajtur, vërehen probleme të cilat kërkojnë ndërhyrje sa më parë për t'i eliminuar dhe mos të rëndohen më tepër. Nga një vlerësim paraprak rezulton se:

- Ka nevojë për sistemim të ujërave të shiut.
- Ka nevojë për ndërtimin e sistemit të drenazhimit në ambientet e jashtme sportive.
- Nyjet sanitare rrjedhin dhe japin lagështi në klasa, pajisjet hidrosanitare janë pjesërisht jashtë funksionit.
- Mungon sistemi i ngrohjes, ngrohja pjesërisht me soba druri dhe rezistencë.
- Sistemi elektrik duhet të rishikohet pasi nuk mban ngarkesë.
- Nuk ka sistem të MNZ-s ë .
- Dyert kanë nevojë për riparime dhe zëvendësime si dhe dritaret.
- Ka nevojë për rrethim të terreneve sportive si dhe për riparime të tyre.
- Ka nevojë për riparim të rrethimit egzistues.
- Konstruksioni mbajtes i çatise së tjegulles është komplet i demtuar dhe nuk e siguron aftësinë mbajtëse . 30 % e tjegullave ekzistuese mund të përdoren pas rikonstrukcionit .

Foto te gjendjes egzistuese te objektit







Kërkesat teknike planimetriko – kompozicionale dhe infrastrukturore

Projektuesi duhet të kryejë të gjithë punën në përputhje me standardet e projektimit dhe ndërtimit që janë në fuqi në Shqipëri.

Perpara hartimit të projektit është e domosdoshme të bëhet një Akt – Ekspertimi nga Instituti i Ndërtimit për të përcaktuar qendrueshmërinë e objektit nga pikepamja konstruktive.

Gjatë hartimit të meren parasysh kondicionet e PPV Bashkisë Lezhë. Projektuesi duhet të marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi për ndërtimet, kryesisht: Ligji 107/2014 Për planifikimin e zhvillimit të territorit i ndryshuar; Ligji 69/2012 Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar; Ligji nr 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar; Ligji 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” i ndryshuar; Ligj nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”; Ligji nr. 152/2015 Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin. Projektuesi do të përdorë edhe standardet në fuqi të projektimit të hartuara nga MASH për objektet arsimore: VKM 319 datë 12.04.2018.

Hartimi i projekteve specifike, të shtjelluar në vijim, duhet të mbështetet në studimet e thelluara të gjendjes faktike. Çdo dokument teknik që disponohet nga institucioni në shërbim të procesit të projektimit do t’i vendoset në dispozicion grupit të projektimit. Grupi i projektimit duhet të hartojë projektet mbështetur në shërbimin topografik të parcelës dhe shërbimet që i takojnë nëntokës, pa anashkaluar kriteret për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e efikasitetit energjetic.

Gjithashtu Grupi i projektimit do të duhet të bëjë një rievitim faktik arkitektoniko-konstruktiv të ndërtesës.

Shkolla 9 - vjeçare ‘ Dode Gege Jaku ’ ne Manati , propozohet për : rikonstrukcion të pjesshëm të godinës kryesisht çatia e cila është tejet e amortizuar , ndërtimi i sistemit të MNZ, ndërtim i sistemit ‘Kapote, etj’ për efikasitetin energjetic , sistemimin e ujërave të shiut, zëvendësim të pajisjeve sanitare, pllakave, dyerve dhe dritareve të dëmtuara, riorganizim dhe gjelbërim të ambientit të jashtëm dhe terreneve sportive . Për të ruajtur pastërtinë e oborrit të shkollës apo ambienteve të jashtme, në projekt/preventiv të vlerësohet që të parashikohet vendosja e koshave për mbeturinat.

Gjithashtu kërkohet që të shihet mundësia e realizimit të hidroizolimit të dyshemesë, si dhe drenazhimi total i objektit për eliminimin e lagështirës.

Është e rëndësishme të projektohet rindërtimi edhe i ambjentëve sportive për t'i përshtatur me aktivitetin arsimor, pasi në gjendjen ekzistuese nuk lejojnë zhvillimin e tij.

Gjate hartimit të projektit projektuesi duhet të ketë planifikojë intervistim të perfaqësues të sistemit arsimor dhe të vetë shkollës për të mbledhur një informacion parapra për të hartuar një përmbledhje infroamtive dhe orjentuese.

Përmbledhja përbën pikën e fillimit të punës së ekipit të projektimit. Përgatitja e saj duhet të bëhet mbi këto baza:

- Përshkrimi i një dite të zakonshme të shkollës në këtë moment dhe se si do të ndryshojë ajo me agjendën transformuese;
- Struktura organizative e shkollës, përfshirë drejtimin, departamentet, mbështetjen këshilluese joformale dhe kështu me radhë;
- Etikën dhe vlerat e shkollës;
- Aktivitetet që do të vendosen në shkollë, duke përfshirë edhe jashtë orarit për nevojat e komunitetit si dhe llojin e aktiviteteve që kërkohen;
- Shpeshtësinë e aktiviteteve të ndryshme - nivelet e përdorimit të llojeve të ndryshme të akomodimit;
- Afërsinë e kërkuar në mes të aktiviteteve të ndryshme, departamenteve etj;
- Mënyrat për qasjen e komunitetit dhe nivelet e duhura të sigurisë;
- Mënyrat sipas së cilave shkolla mund të ndryshojë në të ardhmen e afërt, në llogari të ndryshimeve pedagogjike, organizimeve joformale këshilluese dhe metodave të reja të mësimdhënies.
- Të gjitha këto informata janë shumë të dobishme për projektuesit/dizajnerët e shkollës prandaj duhet të përfshihet në përmbledhje të detajuara si informata.

Pasi të jenë zgjedhur të gjitha këto çështje, faza tjetër e hartimit të përmbledhjes është përpilimi i detajuar i planit të akomodimit/detyrës projektuese (fleta që liston të gjitha hapësirat e nevojshme) Këtu duhet të mbahen parasysh ambientet që përmendëm: Biblioteka, palestra, dhoma e mjekut., dhoma e psikologut, ambienti i qeverisë së nxënësve. Kjo detyrë projektuese (plani i akomodimit) do të listojë saktësisht numrin e klasave të duhura dhe madhësitë minimale të dhomave mësimore të tyre, si dhe kapacitetin e parashikuar të shkollës të dhënë më termat e numrit të përgjithshëm të vendeve të nxënësve dhe grupeve. Informata të mëtejshme lidhur me dhomat e veçanta janë të listuara në atë që zakonisht njihet si fleta me të dhëna për të gjitha llojet e dhomave mësimore. Detyra do të shtohet deri në një sipërfaqe të përgjithshme në të cilën synohet të bëhet ndërtimi në mënyrë që të sigurojë që limitet financiare të mos jenë tejkuluar.

Projektuesit duhet të analizojnë madhësitë e klasave eksistuese dhe të propozojnë modifikime të mundshme duke patur parasysh përafrimin me standartin e treguar në tabelën e mëposhtme;

Ciklet e plota	Zonat urbane me densitet të lartë			
	Parafillor	Fillor	M. i ulët	M. i lartë
Vitet:	1	5	4	3
3	3	15		
4	4	20		
5	5	25	20	
6	6	30	24	18
7			28	21
8			32	24
9			36	27
10				30
11				33

Madhesia e shkollave

Përveç kësaj, projektuesi duhet të bëjë vlerësimin dhe të kuptojë se si ligjërohet kurrikulumit dhe se si do të shfrytëzohen klasat e mësimin në mënyrë që ai të mund të del me zgjidhje të reja për llojin e aktiviteteve që do të zhvillohen në klasat e mësimin. Ai gjithashtu duhet të vlerësojë dhe të marrë në konsideratë ndërveprimin dhe qasjen në hapësirat e tjera, siç janë (i) hapësirat përcjellëse që ju përshtaten nxënësve që punojnë, (ii) zonat depove dhe ato për mbështetje të mësimdhënësve, (iii) vendet për ruajtjen e rrobave dhe çantave të nxënësve; (iv) hapësirat sociale dhe rekreative.

Përsa i takon mashësisë së klasave projektuesi duhet të ketë parasysh të dhënat në tabelën e mëposhtme;

<i>Niveli i arsimit</i>	<i>Vende për nxënësit</i>		<i>Sipërfaqja në M2</i>		<i>M2/vend të nxënësit</i>	
	<i>Ulët</i>	<i>Lartë</i>	<i>Ulët</i>	<i>Lartë</i>	<i>Ulët</i>	<i>Lartë</i>
<i>Parafillor</i>	24	30-36	48	65	2.0	1.8-2.2
<i>Fillor</i>	24	30-36	44	58	1.8	1.6-1.9
<i>Mesëm i ulët</i>	24	30-36	45	58	1.9	1.6-1.9
<i>Mesëm i lartë</i>	24	30-36	nuk ka	58	nuk ka	1.6-1.9

Madhësia e dhomave mësimore

Projektuesi duhet të ketë në konsideratë parime të funksionalitetit duke u kujdesur që gjatë projektimit të ndërtesës shkollë, të krijohet një bilanc mes cilësisë së funksionimit dhe efikasitetit të kostos. Ky bilanc mund të arrihet me mjete të ndryshme, siç janë:

- Dimensionet racionale të hapësirave:
- Zonat e përshtatura të qarkullimit: hapësirat e qarkullimit nuk duhet të kalojnë 25% të sipërfaqes së dobishme të ndërtuar. Ato duhet të kenë dimensione dhe të përshtaten sipas shfrytëzuesve të shkollës, ato duhet të jenë funksionale dhe të respektojnë kërkesat për siguri;
- Numri optimal i hapësirave: numri i hapësirave fillimisht përcaktohet sipas shfrytëzimit. Në rast se norma e pranueshme nuk mund të arrihet, në veçanti për hapësirat për mësimdhënie të specializuar, hapësirat për qëllime të shumëfishta duhet të merren parasysh;
- Përshtatshmëri maksimale: hapësirat duhet të projektohen me një përshtatshmëri maksimale, që i mundëson ato të përshtaten për lëndë dhe ndryshime të ndryshme, në ato raste kur kjo përshtatet me kërkesat e tyre funksionale;
- Grupimi i hapësirave: hapësirat duhet të grupohen në blloqe sipas funksionit dhe ndërlidhjes. Kjo do të sigurojë një identifikim të lehtë të veprimtarive dhe hapësirave të tyre korresponduese, një komunikim të lehtë mes hapësirave të ndryshme, pa pengesa nëpër zonat e qarkullimit dhe ato të pritjes, një vëzhgim të lehtë të hapësirave dhe një shfrytëzim optimal të tokës në dispozicion;
- Integrimi i nevojave: lokacioni i hapësirave brenda shkollës duhet të ndjekë domosdoshmëritë themelore siç janë rregullat e sanitarisë dhe higjienës, rregulloret e komoditetit funksional dhe të sigurisë, si dhe komoditetin akustik, vizual e atë klimatik.

Kërkesat teknike kundrejt projektit arkitekturor.

Projektuesi duhet të kujdeset që të analizoje dhe të propozojë në respektim të parametrave të komoditetit, duke adresuar tri burime kryesore të mungesës së komoditetit fizik që trupi mund të përjetojë: temperatura, ndriçimi dhe zëri.

Një vëmendje e shtuar duhet t'i kushtohet Komoditetit termik, i cili zakonisht i atribuohet dy parametrave kryesorë: (i) ndjenjës së komoditetit termik si rezultat i bilancit në mes të kalorive të

akumuluar dhe të humbura në trup, dhe (ii) kontrollit të kushteve klimatike, duke përfshirë pozitën e diellit dhe rrezatimit, temperaturën, lagështinë dhe erërat.

Përmirësimi i komoditetit termik do duhet të përqendrohet në masa artificiale ose aktive, që përfshijnë mjetet mekanike ose ato elektrike, siç është ngrohja, ajrosja apo kondicionimi i ajrit. Projektuesi duhet të vlerësojë edhe masa si;

- Sipërfaqet e mbjella: mbjellja e bimëve që mund të luajë një rol thelbësor në krijimin e mikroklimës, kur është e nevojshme. Mbjellja e bimëve kontribuon në mënyrë efektive në mbrojtjen nga pluhuri, erërat dhe rrezet e diellit. Përveç kësaj, mbjellja e shkurreve dhe kaçubave bëjnë të mundur mbrojtjen kundër reflektimit të rrezeve të diellit nga toka;
- Elementet e duhura të ndërtesës: kjo përfshihet kullimi i duhur nga çatia/terrace dhe kullimin rreth ndërtesës, krijimin e hijeve me kanate të rregullueshme nëpër dritare, ndalesa të diellit, perde për diell, çadra dhe/apo galeri që mund të sjellin mbrojtje shtesë nga rrezet e diellit, sidomos kur orientimi i ndërtesës nuk është i favorshëm.
- Materialet e duhura të ndërtimit, që përfshijnë materialet e fasadave me reflektim të mundshëm të diellit, materialet izoluese për rritjen e veprimit termik të mureve dhe të kulmit.

Projektuesi duhet të mbajë parasysh që për realizimin e komoditetit termik të mësimdhënies duhet të synohen parametrat e dhënë në tabelën e mëposhtme

<i>Klasat e mësim</i>	<i>19°C</i>
<i>Depot</i>	<i>16°C</i>
<i>Korridoret</i>	<i>15°C</i>
<i>Zonat e sanitarisë</i>	<i>16°C</i>
<i>Punëtoritë</i>	<i>16°C</i>
<i>Sallat për qëllime të shumëfisha</i>	<i>19°C</i>
<i>Zyrat e administratës</i>	<i>19°C</i>
<i>Dhoma e mjekut</i>	<i>22°C</i>

Temperaturat minimale të rekomanduara

Me një vëmendje të shtuar, projektuesi duhet të vlerësojë masat projektuese për rritjen e efikasitetit energjitik të ndërtesës ëprmes rritjes së cilësisë së termoizolimit të strukturës. Ai duhet të vlerësojë edhe cilësinë e materialeve të kavitetëve dhe të propozojë eventualisht edhe përmirësimin e sipërfaqeve të dritës.

Me qëllim rritjen e efikasitetit energjitik të godinës projekti duhet të parashikojë veshjen termoizoluese të të gjithë kapsulës veshëse të jashtme të godinës. Projekti arkitekturor duhet të mbajë në konsideratë përshtatjen e objektit për personat me aftësi të kufizuara, referuar kategorizimeve të kufizimeve të ndryshme. Materialet e propozuara për të gjithë elementët ndarës dhe veshës, termoizolues, hidroizolues etj., duhet të jenë bashkëkohorë, të plotësojnë kushtet higjieno sanitare dhe të shmangin elementët e rrezikshmërisë. Rëndësi duhet ti kushtohet akustikës së ambienteve, izolimit nga zhurmat, luhatjet e temperaturës dhe lagështirës.

Gjatë të gjithë procesit të projektimit është e rëndësishme që të bashkëpunohet ngushtë ndërmjet të gjithë specialistëve të përfshirë, pasi projekti arkitekturor duhet të reflektojë kërkesat e projektit strukturor, kërkesat e projekteve të sistemeve teknike, kërkesat e aspekteve arkitekturore të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, kërkesat për efikasitetin energjitik, kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe çdo kërkesë tjetër, të gjykuar si të nevojshme nga specialistët e përfshirë.

Sa i takon komoditetin visual, projektuesi duhet të ketë parasysh se nevoja për standarde të larta dhe një ndriçim i projektuar mirë për ndërtesat shkollë bazohet në: (i) ndriçimin natyror që rezulton nga drita e diellit e drejtpërdrejtë apo ajo e tërthortë e reflektuar nga toka dhe sipërfaqet e tjera të jashtme apo ato të brendshme.

Projektuesit duhet të ndërmarrin masa të duhura për të siguruar komoditetin e ndriçimit që është esencial për një performancë të mirë dhe komoditet vizual të nxënësve dhe personelit të shkollës. Ato janë:

Ndriçimi natyror:

- Për të kufizuar përdorimin e ndriçimit të shtrenjtë artificial, plani(projekti) i ndërtesës dhe i dhomave mësimore duhet të maksimizojë përdorimin e dritës natyrore dhe në këtë mënyrë do të minimizohet rrezatimi i mundshëm që mund të ndodhë gjatë periudhave të caktuara të ditës;
- Niveli i mirë i ndriçimit është i rëndësishëm në zonat e qarkullimit për të minimizuar rrezikun nga aksidentet;
- Distancat mes balleve duhet të lejojnë depërtimin e mjaftueshëm të dritës nëpër ndërtesa. Këto rekomandime mbi këtë lloj distance zbatohen edhe për komoditetin klimatik;
- Numri, dimensionimi, vendosja dhe aranzhimet e dritareve duhet të jenë në përputhje me sasinë e kërkuar të dritës (dhe rrjedhën e ajrit). Duke pas parasysh rëndësinë e ndriçimit natyror, rekomandohet që e tërë sipërfaqja e dritareve në hapësirat e mësimimit të jetë 15 deri 20% e sipërfaqes së dyshemesë;
- Thellësia e sallave mund të ndikojë në ndriçimin natyror për hapësirat në anën e kundërt të dritareve. Andaj rekomandohet që të shmangen thellësitë e sallave që tejkalojnë 7.00 m;
- Kur kemi streha, amortizatorë dritarësh apo grila për mbrojtjen e dritareve, efekti i tyre në dritën e ditës duhet të studiohet me kujdes;
- Mbjellja e drunjve dhe shkurreve mund të kufizojë intensitetin e dritës, varësisht nga përmasat dhe format, si dhe llojet e gjetheve dhe distanca nga ndërtesat.

Ndriçimi artificial:

- Disa aktivitete shkollore në mënyrë të domosdoshme kërkojnë ndriçim të duhur artificial, në veçanti gjatë kohës së dimrit dhe në fund të ditës apo gjatë ditëve me re.
- Instalimi i pajisjeve të ndriçimit gjithashtu mund të mundësojë zgjatjen e orëve të punës (ndërrimet e dyfishta, mësimet e natës, takimet...);
- Lloji i pajisjeve të ndriçimit që duhet të instalohen varet nga intensiteti i dritës që kërkohet dhe nga lloji i aktivitetit përkatës. Megjithatë tubat fluoreshente, krahasuar me poçet inkandeshente, kanë përparësinë e reflektimit të ulët të sipërfaqeve, efikasitet të lartë, shpërndarje të mirë të dritës, prodhim të ulët të nxehtësisë;

Projektuesi duhet të ketë në vëmendje projektimin për një mjedis higjienik. Për këtë qëllim ai duhet të ketë parasysh

Hapësirat e brendshme të sanitarisë

Cilësia e mjedisit higjienik në shkollë varet nga projektimi, përzgjedhja e pajisjeve për shfrytëzim nga nxënësit, personeli (mësimdhënës, administrativë, shërbyes), si dhe nga mysafirët, por edhe nga mirëmbajtja dhe menaxhimi i shfrytëzimit të këtyre pajisjeve. Këto pajisje, nëse mirëmbahen mirë do të sigurojnë nivelin e tualeteve, banjave dhe furnizimit me ujë që kërkohet brenda ndërtesave shkollore. Përveç këtyre ekzistojnë edhe komponentët e jashtëm të këtyre shërbimeve, menaxhimi i mirë i të cilave është thelbësor për higjienën dhe funksionimin e vazhdueshëm të pajisjeve të brendshme.

Në bashkëpunim me stafin mësimor, konsulenti duhet të parashikojë ambjente sanitare të përshtatshme për fëmijët e grupmoshës 6 deri 15 vjeç dhe atyre të sistemit parashkollorë.

Nyjet sanitare të jenë të veçanta dhe lavamanët të jenë të mjaftueshëm për numrin e nxënësve. Të sigurohet ujë i vazhdueshëm dhe i ngrohtë në lavamanë, për këtë arsye të shikohet mundësia e instalimit të boliereve si dhe realizimi i rrjetit të nevojshëm hidraulik.

Banja dhe parabanja të jenë të ajrosura, të ndriçuara dhe të ventiluar. Kur s'ka ajrim direkt duhet të pajisen me impiant ajrimi dhe ventilimi. Kollonat e shkarkimit të jenë të shkëputura nga kanalet e ventilimit, me ajrim në terracë dhe shkarkimet të jenë të kontrollueshme.

Banjat të kenë porta të hapshme nga jashtë dhe të shkëputura nga dyshemeja dhe të përjashtohet hapja nga brenda, për raste emergjence.

Ambientet sportive

Për terrenet e jashtme sportive ka nevojë për ndërtimin e sistemit të drenazhimit. Terrenet e jashtme sportive kanë nevojë për sistemim dhe mobilim urban .

Sistemimet e jashtme dhe ambientet e gjelbëruara

Sistemimit të oborrit të shkollës duhet ti kushtohet një rëndësi e veçantë. Ai duhet të rezultojë me rrethim transparent (kangjella, etj) dhe të garantoje të gjitha normat e sigurisë dhe standardeve për ndërtime të këtij lloji. Ambientet e jashtme janë ambiente që kryesisht shërbejnë për qëndrim, çlodhje prandaj rëndësi të veçantë ka edhe krijimi i një sipërfaqeje të gjelbër dhe me pemë. Projektuesi duhet të japë të detajuara shtresat përkatëse dhe teknologjinë e zbatimit të tyre, dhe të kombinojë ambientet e qëndrimit/treshtimit me ambientet e gjelbëruara.

Konsulenti duhet t'i jap rëndësi dhe të parashikojë dhe ndriçimin e jashtëm të objektit, në përputhje me planin urbanistik të kësaj zone dhe në përputhje me kërkesat e veçanta për rrjetin e ndriçimit të dhënë në këtë detyrë projektimi.

Për të mbajtur pastërtinë e oborrit të shkollës, në projekt/preventiv të parashikohet vendosja e koshave për mbeturinat, sidomos në afërsi të stolave.

T'i kushtohet kujdes i veçantë, sistemimit dhe disiplinimit të ujërave sipërfqasore të cilat janë problematike për këtë objekt.

Trajtimi i ujërave të zeza dhe atmosferike

Në përgjithësi, ekzistojnë 2 lloje të ujërave që duhet të trajtohen dhe të qiten jashtë ndërtesave shkollë. Këto janë: (i) të gjitha ujërat e tualeteve; dhe (iii) ujërat nga shirat, nga kulmet apo hapësirat e jashtme.

Të gjitha ujërat mund të dërgohen drejtpërdrejtë në rrjetin e kanalizimit. Rekomandohet që ujërat atmosferike nga kulmet të grumbullohen në një rezervuar të ndarë në mënyrë që ai ujë të shfrytëzohet për ujitjen e hapësirave të gjelbëruara në oborr të shkollës.

Për ruajtjen e ujit kërkohet cisterna e prodhuar nga çeliku i galvanizuar apo nga material tjetër që është rezistues dhe që plotëson kushtet higjienike për depozitimin e ujit të pijshëm. Pozita apo vendndodhja e këtyre cisternave do të rregullohet në atë mënyrë që të ekzistojë rënia e lirë e duhur kurdo që kërkohet për furnizim me ujë të të gjitha pjesëve të shkollës.

Drenazhimi i lokacionit

Drenazhimi i lokacionit të shkollës përfshinë shkallëzimin e përgjithshëm të lokacionit, sistemin e drenazhimit të ujërave pas shtrëngatave dhe atë të ujërave atmosferike.

Sistemi i drenazhit të ujërave atmosferike

I tërë drenazhimi i lokacionit nga ndërtimet e reja apo nga ndërtesat ekzistuese lidhen me sistemin ekzistues të drenazhimit të ujërave atmosferikë dhe të gjitha rrjedhat e ujërave atmosferikë nga hapësirat e shtruara (terrenet sportive, ato për lojërë, rrugët, vend parkimet, dhe shtigjet) mblidhen në

kanalet për drenazhim të ujërave atmosferike apo në kanale të hapura dhe do të barten përmes gypave nëntokësorë në vendgrumbullim të ujërave, në rezervuare të ujërave apo në rrjetin e kanalizimit të qytetit.

Drenazhimi i kulmit

Kulmi i ndërtesave duhet të planifikohet në atë mënyrë që të mundësojë drenazhimin e ujërave atmosferike: (i) kulmet e rrafshëta nga pllakat e çimentos duhet të kenë pjerrtësinë minimale prej 1% që shkon drejt pikave dalëse dhe tek gypat vertikalë të drenazhimit; (ii) kulmet e pjerrëta të ndërtesave disakatëshe duhet të kenë ulluqet dhe gypat vertikalë të drenazhimit, të lidhura me sistemin kryesor të drenazhimit në lokacion.

Në lidhje me sigurinë e objektit ndaj zjarrit duhet të kihet parasysh

Ajrosja e mjediseve

Ajrosja e mjediseve të shkollës përmirëson shumë higjienën brenda objektit, duke eliminuar lagështinë, lagështinë nga muret, nga ndarjet e hapësirave dhe nga hapjet, si dhe duke larguar insektet që bartin sëmundje. Përveç kësaj, lëvizjet e ajrit ndihmojnë në zvogëlimin e disa sëmundjeve, siç janë mukozat, duke zvogëluar temperaturën trupore, dhe rrjedhimisht duke zvogëluar djersitjen e nxënësve dhe të punonjësve përmes avullimit dhe rrymimit. Ajrosja e ndërtesave shkollë mund të bëhet përmes:

Sistemet dhe rregullat për mbrojtje nga zjarri

Masat paraprake që duhet të ndërmerren nga projektuesit e shkollave përfshijnë një grup masash për kufizimin e rreziqeve nga zjarri, lehtësimin e evakuimit të shfrytëzuesve të ndërtesave dhe lehtësimin e qasjes së ekipeve të shpëtimit. Kjo përfshinë metoda të ndryshme të mbrojtjes dhe sisteme të sigurisë ndaj zjarrit të cilat janë përshkruar shkurtimisht në vijim:

Qasja në lokacion

Për sa i përket mbrojtjes nga aksidentet, lokacioni i shkollës duhet të vendoset sa më larg që është e mundur nga zonat që paraqesin rrezik nga zjarri (punëtoritë, fabrikat, depot, pompat e benzinës...), dhe rruga e qasjes për në ndërtesa duhet të jetë, së paku, 8.0 m e gjerë (të shqyrtohet me shërbimet lokale të shpëtimit) dhe duhet të jetë e përshtatshme për vetura dhe kamionë, përfshirë ambulancat dhe automjetet e shpëtimit të zjarrfikësve.

Tubacionet dhe hidrantët e fikjes së zjarrit: tubacionet e fikjes së zjarrit instalohen nëpër ndërtesa dhe pajisjen me valvula në mënyrë që shërbimet e zjarrfikjes dhe të shpëtimit të mund të lidhin tubat për ujë për të fikur zjarrin brenda ndërtesës. Ato mund të jenë të llojit "të thatë" që zakonisht janë të zbrazëta dhe furnizohen përmes një tubi nga pajisjet pompuese të shërbimit të zjarrfikjes dhe të shpëtimit, ose të jenë edhe të llojit të "lagësht" ku ato mbahen me plot ujë dhe furnizohen nga rezervarët dhe pompat në ndërtesë. Duhet të ekzistojë edhe një pajisje për t'i mundësuar sistemit të lagësht që të rimbushet nga pajisjet e pompimit në rast të emergjencave.

Pajisjet e fikjes së zjarrit

Hetimi automatik i zjarrit: Zbulimi i hershëm automatik dhe alarmimi i zjarrit ndihmojnë në daljen e shpejtë dhe të sigurt të personave, apo e trajtojnë zjarrin kur ai gjendet në fazën e parë të zhvillimit. Kjo do të mundësojë thirrjen e ndihmës profesionale pa ndonjë vonesë gjë që do të ulte dëmtimet e shkaktuara të ndërtesës dhe përmbajtjes së saj. Shembuj të këtyre pajisjeve përfshijnë pajisjet mbaj-dhe-hap të dyerve kundër zjarrit, sistemet e nxjerrjes së tymit apo sistemet e ajrosjes, sistemet e presimit dhe valvulave të zjarrit në tubacionin e ajrosjes.

Shenjat dhe njoftimet: Të gjitha shenjat dhe njoftimet duhet të vendosen në mënyrë që ato të shihen dhe të kuptohen me lehtësi. Shenjat duhet të përdoren, aty ku është e nevojshme, për t’ju ndihmuar personave që t’i identifikojnë rrugët e daljes dhe daljet, të gjejnë pajisjet e zjarrfikjes dhe telefonat emergjent në rast të zjarrit. Lajmërimet duhet të përdoren, aty ku është e nevojshme, për të dhënë udhëzime se si të përdoren pajisjet kundër zjarrit, rreth veprimeve që duhet të ndërmerren në rast të zjarrit dhe informatave rreth shërbimit kundër zjarrit dhe të shpëtimit.

Ndriçimi emergjent: ndriçimi emergjent nevojitet për të treguar dhe ilustruar në mënyrë të qartë rrugët dhe shenjat e daljes, përfshirë këtu rrugët e daljes që janë jashtë ndërtesës, për të siguruar që ndryshimet e kateve dhe të drejtimeve të tregohen dhe për të siguruar që pikat e thirrjes së alarmit të zjarrit dhe pajisjet e zjarrfikjes të mund të gjenden me lehtësi.

Kontrolli i tymit: ekzistojnë katër arsye kryesore për kontrollimin e shpërndarjes së tymit, që janë, mbrojtja e rrugëve të daljes, asistimi i fikjes së zjarrit, kufizimi i rrezikut ndaj shfrytëzuesve të objektit në sallat që nuk janë në afërsi të zjarrit dhe minimizimi i dëmit nga tymi ndaj përmbajtjes së ndërtesës. Në shumicën e rasteve kjo arrihet përmes përdorimit të masave të përmbajtjes, siç janë dyert dhe muret. Megjithatë në disa rrethana sistemet e ajrosjes të tymit apo sistemet e shtypjes mund të jenë të nevojshme apo të dëshirueshme.

Ndihma e parë e zjarrfikjes: fikësit e zjarrit duhet të përmbushin funksionin për sigurinë e jetës nëse mënyra më e sigurt e ikjes nga efektet e zjarrit është fikja e tij. Ata gjithashtu kanë një rol të dukshëm në mbrojtjen e pronës, nëse zjarri mund të luftohet para se të bëhet shumë i madh. Llojet e ndryshme të fikësve të zjarrit përdoren për llojet e ndryshme të zjarrit: në tabelën 3.6 më poshtë janë paraqitur llojet kryesore të fikësve të zjarrit, llojet e zjarrit për të cilët ata janë të përshtatshëm dhe lokacionin e përgjithshëm të pajisjeve të zjarrfikjes.

Kur rreziku nga zjarri nuk është i kufizuar në ndonjë lokacion të caktuar, p.sh. zjarret e kategorisë A, fikësit e zjarrit duhet të vendosen në rrugët e daljes, afër daljes nga dhoma apo në dysheme, apo në daljen e fundit nga ndërtesa.

Sistemet e spërkatjes: Sistemet e spërkatjes përfshijnë njehsorët e rrjedhjes të lidhur me alarme, dhe nëse instalohet një sistem i fikjes së zjarrit në tërë ndërtesën do të kenë një bonus shtesë që janë hetuesit e nxehtësisë në tërë shkollën që mund të shprijnë në kursime të përgjithshme. Megjithatë, ky sistem mund të jetë shumë i shtrenjtë dhe projektuesi mund të duhet të zgjedhë një tipar të kufizuar të kompensimit për të trajtuar rreziqet specifike përmes mbrojtjes së vetëm një ndërtese apo vetëm ndonjë pjese të ndërtesës.

Dyert kundër zjarrit: dyert e vendosura në muret rezistuese ndaj zjarrit apo në muret ndarëse duhet të jenë dyer kundër zjarrit, të dizajnuara që të rezistojnë kalimin e zjarrit dhe të tymit. Dyert e zjarrit përdoren në rrugët e daljes për të ndarë korridoret e gjata duke siguruar kështu që jo më shumë se një pjesë e shkurtë e korridorit që shpie në dalje të mbushet me tym gjatë ndonjë zjarri. Dyert e zjarrit duhet të përdoren për të ndarë shkallët nga rrugët e qarkullimit në mënyrë që shkallët të mbrohen nga hyrja e tymit.

Dyert e zjarrit në përgjithësi do të kenë panele të qelqit për t’i ndihmuar shfrytëzuesve për të parë më tej, përfshirë ata me nevoja të veçanta, gjatë lëvizjes së tyre. Panelet e pamjes gjithashtu do të jenë të dobishme në rast të zjarrit për t’ju mundësuar njerëzve që të shohin nëse hapësira nga ana tjetër është prekur nga tymi apo jo. Përdorimi i qelqit varet në atë nëse ai ofron izolim si dhe integritet për nivelin e duhur të rezistencës ndaj zjarrit për së paku 60 minuta.

Mbrojtja nga rrufetë

Sistemi për mbrojtje nga rrufetë është një masë e rëndësishme mbrojtëse që duhet të kihet parasysh nga projektuesit e shkollave. Sistemi është i projektuar për të mbrojtur ndërtesat dhe përmbajtjen e tyre nga dëmtimi për shkak të goditjeve, duke i ndërprerë ato dhe duke e përcjellë pa rrezik rrymat e

tyre të tensionit të lartë në tokë. Shumica e sistemeve për mbrojtje nga rrufetë përmbajnë në vete një rrjet të përbërë nga tri elemente. Ato janë:

- shufrat rrufepritëse ose termialet ajrore që zakonisht janë të vendosura në ose përgjatë pikave më të larta të strukturës së kulmit, dhe të lidhura elektrikisht me njëra tjetrën përmes përçuesve të lidhur;
- përçuesit metalik të vendosur teposhtë që gjithashtu quhen “të drejtuar teposhtë”, të cilët janë të lidhur në rrugën më direkte për te njëri ose më shumë vendshkarkues në tokë. Lidhjet për elektrodat e vendosura në tokë nuk duhet të kenë vetëm rezistencë të ulët, por duhet të kenë edhe vetë-induktancë të ulët;
- elektrodat e tokëzimit ose “tokëzimi” i bërë nga shufrat, pllakat metalike ose rrjetat.

Objekti duhet të adresojë edhe kërkesa të posaçme


Projektimi për personat me nevoja të veçanta

Projektimi/dizajnimi i ndërtesave shkollore duhet të siguroj qasjen e papenguar, lëvizjes, qëndrimin dhe mësimnxënies të nxënësve me nevoja të veçanta, referuar legjislacionit perkates, per kete kategori. prandaj, projektuesit duhen të bazohen në këtë legjislacion por edhe në këtë udhëzues ku janë paraqitur kushtet teknike më specifike për ndërtesat shkollore. Llojet e nevoja të veçanta për të cilat mund të përkujdesemi në një shkollë standarde do të kufizohen, për arsye praktike, në ato me nevoja të veçanta në lëvizje, humbje të dëgjimit që korrigjohet me pajimet për dëgjim, dhe humbja e pjesërishme ose e tërësishme e të parit, pas trajnimit adekuat. Mirëpo, kategoria e fundit nuk do të jetë në gjendje të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet shkollore të mësimdhënies ose të mësimnxënies.

Personat me nevoja të veçanta mund të jenë nxënës, arsimtarë, mysafirë ose personel. Problemi i tyre kryesore është reduktuara në lëvizshmërinë e tyre për arsye se ata shfrytëzojnë karrocet e invalidëve, patericat ose bastunët. Ky problem kërkon dimensionim të veçantë të zonave të qarkullimit, hapësirave të dyerve, pajisjeve sanitare, shtigjeve të evakuimit dhe hapësirave të klasave për t'i akomoduar personat me nevoja të veçanta.


Dimensionet e personave me nevoja të veçantë nëpër karrocet e invalidëve duhet të kihen parasysh nga projektuesit gjatë caktimit të madhësisë së hapësirave të shkollës dhe qarkullimit. Karrocet e invalidëve kanë dimensione të ndryshme, sipas moshës së nxënësve dhe llojit të artikullit. Megjithatë, dimensionet e mëposhtme, përkojnë me dimensionet mesatare të personave të rritur, e që duhet të merren parasysh

- Gjerësia e karriges përgjithësisht është mes 600 dhe 700 mm
- Gjatësia është mes 1000 dhe 1250 mm
- Rrezja e jashtme është mes 1300 dhe 1500 mm



Hapësira deri ku mbërrinjnë personat me nevoja të veçanta në karrocet e invalidëve definohet

- Mes 230 dhe 300 mm mbi nivelin e dyshemesë;
- Mes 1100 dhe 1300 në lartësi;
- Mes 300 dhe 400 mm nga pjesët anësore të karriges;



Kërkesat teknike kundrejt projektit konstruktiv.

Hartimi i projektit konstruktiv duhet të mbajë në konsideratë propozimin e zgjidhjeve më të përshtatshme, referuar konceptit të përgjithshëm arkitekturor dhe funksionit të ambientit.

Materialet, teknikat dhe teknologjitë e propozuara duhet të respektojnë kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Në mungesë të tyre projektuesi duhet t'u referohet Eurokodeve aktuale në përdorim.

Projekti konstruktiv duhet të respektojë kërkesat e jetëgjatësisë së projektimit, ngarkesave dhe rregullave të projektimit për sa i përket durabilitetit (Klasa e durabilitetit), në funksion të kushteve të ekspozimit të tij, bazuar në Eurokode.

Hartimi i projektit konstruktiv duhet të mbështetet në studimin gjeologjik – inxhinierik të truallit dhe studimin sizmologjik.

Çatia

Aktualisht objekti i katesh, është i mbuluar me çati tjegulle .

Projektuesi duhet të projektojë një çati të re , të japë të gjitha detajet arkitektonike lidhur me çatinë : vendosja e kasetës së shkarkimit dhe ullukët vertikalë dhe horizontale si dhe detaje të tjera të domosdoshme për zbatimin e punimeve duke qenë se një pjesë e ujërave të shiut janë të pasistemuar dhe grumbullohen në ambientet e shkollës. Gjithashtu duhet të tregojë, numrin e ulluqeve dhe diametrat e tyre sipas normave në fuqi. Për sasi të reshjeve do të përdoren të dhënat e Institutit Hidrometeorologjik.

Në projekt të parashikohen edhe daljet e oxhakeve egzistues , pasi ato duhet të jenë funksionale

Muret

Konsulentit do të japë të gjitha detajet e përforcimit të muraturës mbajtëse në rastin kur ajo paraqitet me probleme. Në rast të mureve me çarje, konsulentit do të tregojë mënyrën e riparimit/konsolidimit të tyre

Suvatimet.

Objekti i rikonstruktuar duhet të suvatohet nga brenda dhe jashtë. Në pjesët e dëmtuara, suvatimet e mureve dhe tavaneve do të kryhen në të gjithë sipërfaqen përkatëse duke ruajtur shtresën e parë

ekzistuese ku të mundet në mure, kurse tavanet te pastrohen dhe të risuvatohen. Të gjitha shtresat e tjera në rast se janë të dëmtuara do të hiqen pa dëmtuar muret.

Përsa i përket suvatimeve të jashtme do të jenë në varësi të llojit të ndërhyrjes që parashikon projekti, nëse do të restaurohet sipërfaqja ekzistuese ose do të rishikohet e gjitha sipas konceptit të ri që kërkon fasada.

Lyerja e mureve të brendshëm dhe të jashtëm

Muret e brendshëm dhe tavanet do të lyhen me hidromat, kurse pjesa e poshtme e mureve do të lyhet me bojë akrilik me ngjyrë të ndryshme ose jo nga muret, gjë e cila do të vendoset në bashkëpunim me stafin e shkollës.

Fasada

Fasada e shkollës, të jetë e tillë që të mirëmbahet lehtë, kurse ngjyrat e fasadës të jenë të bukura, në mënyrë që objekti të bëhet më atraktive për fëmijët. Fasadat duhet të jenë të veshura me kapotë termike antizjarr. Konsulenti duhet të përcaktojë gjithashtu vendodhjen e tabelës me emrin e shkollës.

Shtresat e pllakave

Pllakat ekzistuese të dyshemesë së vjetër së bashku me llaçin e vjetër nëse është e nevojshme do të zëvendësohen nga shtresa e re e dyshemesë, me pllaka, duke patur parasysh rinivelimin e saj me llaç – çimento si dhe me shtresat e nevojshme izoluese në rastin e ambienteve që nevojiten. Dyshemetë e tualeteve dhe muret e tyre në një lartësi të caktuar, duhet të izoloohen dhe projektuesi duhet të japë detajin e izolimit të tyre. Çdo shtresë duhet të jetë e detajuar me specifikimet përkatëse.

Shkallët

Është e nevojshme përcaktimi i qartë i gjendjes së shkallëve të jashtme, si nga ana funksionale në lidhje me kapacitetin ashtu edhe nga pikëpamja konstruktive ose e aftësisë mbajtëse të konstruksionit në rastin e rikonstrukcionit të godinës. Edhe nëse shkallët nuk kanë nevojë për rikonstrukcion, bazamakët dhe parapetet duhet të ribëhen.

Projekti duhet të përmbajë të gjitha detajet si dhe specifikimet teknike të domosdoshme për fazën e projekt zbatimit.

Dyer, dritare

Projektuesi duhet të përcaktojë që materialet që do të përdoren të jenë të cilësisë së lartë. Nëse janë propozuar dyer prej druri, ato duhet të jenë prej druri të fortë me mentesha të forta (minimumi tre për çdo derë).

Vendosja e dyerve dhe plani i hapjes së tyre të realizohet i tillë që të plotësoje kushtet e daljes së shpejt në raste emergjencash dhe standardet e vendosura nga MAS.

Përsa i përket dritareve do të jenë duralumini të cilësisë së lartë me hapje me rrotullim dopio-xham dhe me sopralluce në ambiente që e kërkojnë atë. Gjithashtu për katet e para duhet të jetë të parashikuara të gjitha normat e sigurisë pra edhe pajisja e tyre me elementet metalike mbrojtës përkatës.

Kërkesat teknike kundrejt projektit hidrosanitar.

Projektimi i Sistemit Hidrosanitar të Furnizimit me ujë dhe shkarkimeve të ujërave të ndotura dhe atmosferike të ndërtesës dhe projektimi i rrjetit inxhinierik të ujërave në zonën përreth duhet të kryhet në përputhje me projektin arkitektonik.

Sistemi hidrosanitar i furnizimit me ujë dhe shkarkimeve të ujrave të ndotura të ndërtesës dhe jashtë saj duhet të projektohet në përputhje me Kushtet Teknike të Projektimit (KTP) në Fuqi, si dhe sipas udhëzimeve të Standardeve të projektimit shtetërore dhe ndërkombëtare. Ky sistem duhet të projektohet, në përputhje me zgjidhjet e konceptuara në projektin arkitekturor dhe duke marrë në konsideratë kërkesat bashkëkohore për funksionimin e nyjeve higjieno – sanitare.

Sistemi hidrosanitar i furnizimit me ujë duhet të sigurojë prurjen e kërkuar, me presionin e nevojshëm në çdo pajisje hidrosanitare. Ky sistem duhet të garantojë furnizimin e vazhdueshëm dhe pa ndërprerje të të gjitha nyjeve sanitare, duke vendosur një rezervë ujore rreth 24 orëshe, si dhe grup presioni për sigurimin e presionit në rastet e furnizimit me ujë nga depozita.

Sistemi hidrosanitar i kanalizimeve të ujërave të ndotura duhet të mbledhë dhe largojë me vetërrjedhje ujërat e nyjeve sanitare. Nëse ka mjedise sanitare nën nivelin e linjave të rrjetit rrugor, duhet të vendosen grupe presioni tip njësi kompakte me rezervuar, të cilat të lidhen direkt me linjën e shkarkimit (të ruhet hermeticiteti i sistemit të kanalizimeve, jo me pusetë).

Nevojitet që në ndërtesë të sigurohet furnizimi me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë, duke u bazuar në zgjidhje aktuale dhe perspektive, të cilat do të shmangnin maksimalisht nevojën për ndërhyrje të mëvonshme në objekt dhe do të realizoheshin duke mbajtur në konsideratë edhe aspektet e efikasitetit energjetic afatgjatë.

Për llogaritjet e parametrave hidraulikë dhe gjeometrikë të sistemit, prurjet, humbjet hidraulike, presionin e nevojshëm dhe diametrat duhet të përdoren tabelat e dhëna në kushtet teknike të sipërpërmendura. Llogaritjet e parametrave hidraulikë dhe gjeometrikë të rrjetit duhet të kryhen, duke patur parasysh edhe prurjen e grupeve përzierës (mishelatorë) të ujit apo të rubinetave të pajisjeve përkatëse.

Zgjidhjet teknike të propozuara në projektin hidrosanitar duhet të respektojnë funksionin e objektit, si dhe standardet dhe normativat e detyrueshme, të përcaktuara në aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi.

Të gjithë tubacionet dhe rakorderitë e sistemeve hidrosanitare duhet të propozohen sipas standardeve dhe certifikimeve bashkëkohore ndërkombëtare.

Të nisur nga sa më sipër gjatë hartimit të projekt-zbatimit duhet të meren parasysh sa më poshtë:

- Të merret në konsideratë perspektiva 10 vjeçare e rritjes së numrit të fëmijëve.
- Të merret në konsideratë rrjeti ekzistues i kanalizimeve të zonave ku ndodhen objektet, por gjithashtu konsulenti duhet të marrë në konsideratë projektin e ri të kanalizimeve për këto zona, nëse ka.

Sistemi i largimit të ujërave të bardha dhe të zeza do të jetë miks.

Në përputhje me normat, konsulenti duhet të ketë parasysh numrin e fëmijëve, stafin mësimor dhe administrativ.

Konsulenti duhet të verifikojë gjendjen teknike të banjave ekzistuese dhe duhet të përgatisë projektin e detajuar si për rikonstrukcionin e atyre ekzistuese ashtu edhe të shtesës eventuale të kapacitetit (numrit) të tyre.

Rrjeti i shkarkimit të ujërave të zeza do të ndërtohet me materiale bashkohore dhe në përputhje me standardet në fuqi.

Rrjeti i amortizuar i ujësjellësit do të zëvendësohet. Gjithashtu në bashkëpunim me shoqërinë e Ujësjellës Kanalizime sh.a. do saktësohet dhe gjendja e ujësjellësit ekzistues të zonës si dhe problemet e vërejtura në këtë zonë gjatë periudhës së furnizimit me ujë duke përcaktuar edhe kapacitetin depozitues për furnizim me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje gjatë ditës .

Materialet që do përdoren për rrjetin e brendshëm të ujësjellësit do jenë tuba polietileni me densitet të lartë për ujë të pijshëm me diametër dhe aftësi mbajtëse në përputhje me prurjet dhe presionet llogaritëse.

Për nyjen e marrjes nga rrjeti i zonës do të parashikohet puseta me kapak b/a, përmasat e të cilave duhet të realizohen sipas kushteve teknike dhe të sigurojnë kushte normale manovrimi dhe riparimi. Nëse është e domosdoshme, projektuesi duhet të parashikojë zëvendësimin dhe nxjerrjen jashtë pune të sistemit të vjetër të furnizimit me ujë.

Projektuesi të parashikojë në projekt/preventivin e objektit, vlerën e furnizimit dhe vendosjes së linjës së furnizimit me ujë nga pika e marrjes së dhënë nga Ujësjellës Kanalizime sh.a. Lezhe deri tek matësi i ujit.

Të parashikohet realizimi i depozitave të ujit, të nevojshme në raste emergjence si dhe lidhja e tyre në, me të paktën dy prej lavamanëve dhe nyjeve sanitareve si dhe depozitat e ujit për MNZ.

Kërkesat teknike kundrejt projektit elektrik dhe elektronik.

Projekti elektrik duhet të përshtatet me kërkesat dhe nevojat funksionale të secilit ambient.

Projekti duhet të përmajë rrjetin e ndriçimit, ku përfshihet edhe ndriçimi i ambienteve të jashtëm dhe ndriçimi i emergjencës, rrjetin e prizave të furnizimit me energji, të prizave të UPS, rrjetin e furnizimit me energji elektrike nga OSHEE, sistemin e telefonisë, rrjetit LAN, sinjalizimit të zjarrit, sistemin video, acces-control, sistemin e vëzhgimit me kamera, sistemin e rrufepritjes etj., në harmoni me kërkesat e projektit arkitekturor.

Pozicionimi i ndriçuesve për secilin ambient duhet të përputhet me konceptin arkitekturor të përgjithshëm, në përputhje me funksionin e ambientit dhe standardet kundrejt tij.

Ndriçuesit e propozuar duhet të shmangin elementët e rrezikshmërisë, emetimin e lëndëve të rrezikshme për shëndetin, përdorimin materialeve që shkaktojnë mbejtje të dëmshme për jetën dhe shëndetin e përdoruesve të ambienteve.

Ndriçimi në ambiente duhet të jetë shpłodhës dhe plotësojë normativat e detyrueshme nga tipologjia funksionale e tyre. Shpërndarja e ndriçuesve në ambient duhet të përshtatet me kërkesat funksionale të tij, duke ruajtur sipas rastit një shpërndarje të njëtrajtshme të dritës, apo duke shtuar ndriçuesat pranë tavolinave, ose zonave të punës. Kjo zgjidhje duhet gjithsesi të përmbushë kërkesat nominale të ambientit për ndriçim, sipas tipologjisë, pa cënuar konceptin e përgjithshëm të pasqyruar në projektin arkitekturor mbi estetikën, zgjidhjen e tavanëve, mureve dhe hapsirave të punës dhe ndriçimin e përgjithshëm të interierit. Tipologjia, estetika, këndi i hedhjes së dritës dhe gjeometria e secilit ndriçues duhet të përcaktohet në bashkëpunim me projektuesin arkitekt duke mbajtur në konsideratë lartësinë e ambientit dhe tavaneve të varur (në rast se janë propozuar). Drita ideale duhet të vijë në tavolinën e punës me kënd anësor dhe jo pingul. Shkëlqimi i sipërfaqeve duhet të kufizohet.

Pavarësisht referencave më sipër, nisur nga specifikat e veçanta të secilit ambient funksional, mbetet në gjykimin e projektuesit përdorimi i një standardi minimal ndriçimi, ose një tjetri, bazuar në kërkesat e saktësuara për secilin ambient, në përputhje me veprimtarinë dhe proceset e punës, për të cilët është projektuar.

Vendosja e prizave elektrike, Lan, sistemeve audio video etj. duhet të përputhet me hapsirat e punës të propozuara nga arkitekti në projektin e mobilimit.

Në tërësi në hartimin e projektit do të mbahen parasysh këto kërkesa për projektimin dhe zbatimin e rrjetit elektrik dhe elektronik:

Të gjithë instalimet elektrike, kabllot dhe ndriçuesit, çelësat, prizat etj. duhet të jenë hermetikë.

Ndriçimi elektrik duhet të zbatojë normat e CE.

Sistemi elektronik duhet të konceptohet me server (servera) qendror të veçantë.

Në projektin elektrik duhet të parashikohet edhe instalimi i ndriçimit të emergjencës, në rastet e shkeputjeve të rrymës, apo emergjence të çfarëdo lloji.

Në ndërtesë duhet të parashikohet projektimi dhe instalimi i sistemit të tokëzimit dhe mbrojtjes atmosferike.

Në ndërtesë duhet të parashikohen sisteme elektrike dhe elektronike të nevojshme për mirëfunksionimin e ndërtesës si institucion publik. Krahas sa më sipër, të shqyrtohet mundësia e integritimit të burimeve të rinovueshme të energjisë.

Rikonstrukcioni i objekteve duhet të përfshijë edhe instalimin e ri elektrik, telefonik dhe rrjetin e internetit në laboratorin e informatikës dhe zyrave të administratës.

Konsulenti duhet të parashikojë ndriçimin e ambienteve me ndriçues me fuqi të mjaftueshme për të garantuar një ndriçim në përputhje me normat në fuqi, dhe një numër të mjaftueshëm prizash për secilin ambient, sipas destinacionit të tyre. Projektuesi duhet të japë detajin e fiksimit të ndriçuesve si dhe dimensionet e elementeve në të cilat ato do të kapen.

Panelet e komandimit të vendosen të rinj sipas standardeve bashkëkohore.

Në këto kushte projektuesi duhet të parashikojë nqs nevojitet dhe instalimin e rrjetit elektrik trefazor me fuqi të tillë që të sigurojë funksionim normal të sistemit elektrik me të gjitha pajisjet e saj.

Projektuesi duhet të sigurojë Miratimin e projekteve elektrike në OSHEE, si dhe të përcaktojë edhe pikën e lidhjes me energji elektrike, nga rrjeti i fuqisë (kabina ose transformatori i zonës).

Projektuesi duhet të parashikojë vendosjen e matësit elektrik trefazor, dhe vlerën e përafërt të shtrimit të kablilit nga sahati deri te pika e lidhjes së miratuar.

Projekti elektrik të jetë i shoqëruar me licencën e noteruar të inxhinierit elektrik, e cila do të shërbejë për procedurat e mëtejshme për miratimin e pikës së lidhjes me OSHEE -n. Në projekt-preventiv duhet të parashikohen edhe llambat me bateri të karikueshme, në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike.

Rrjeti telefonik dhe kompjuterik

Në objekt të shikohet mundësia e sistemit telefonike të godinës që të mund të përdoret në çdo moment. Godina duhet të jetë e pajisur me sistem telefonik, rrjetin data dhe sistemi vëzhgimit me kamera CCTV, shoqëruar me sistemin e kontrollit të hyrje/daljeve "access control".

Sistemi elektrik, ndriçimi i emergjencës dhe sigurisë.

Ndriçuesit luminishent dhe prozhektorët të zëvendësohen me ndriçues led, si ndriçues më ekonomik.

Ndriçimi i emergjencës duhet të futet automatikisht në punë dhe të ketë një kohë pune të paktën 1 orë në rast se stakohet tensioni. Ndriçimi i emergjencës dhe i sigurisë duhet të vendoset në ambientet e mëposhtme:

- • Korridore, të cilat shërbejnë edhe si rrugë largimi emergjence;
- • Dhoma që shërbejnë si pika grumbullimi;
- • Në ambientet që nuk kanë dritare;

Projektuesi duhet të parashikojë ndriçimin e dhomave me ndriçues me fuqi të mjaftueshme për të garantuar një ndriçim në përputhje me normat në fuqi, dhe një numër të mjaftueshëm prizash për secilin ambient, sipas destinacionit të tyre.

Në projekt-preventiv duhet të parashikohen edhe ndriçuesit e emergjencës, në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike.

Kërkesat teknike kundrejt projektit mekanik

Projekti i sistemit të ngrohje – ftohjes dhe ventilimit duhet të përfshijë:

Llogaritjet e ngarkesave termike të nevojave për ngrohje – ftohje të secilit ambient dhe nevojave të veçanta të gjithësecilit prej tyre. Projekti i ngrohje/ftohjes/ventilimit duhet të mbështetet në normativat e përcaktura në Standartet ASHRAE, në të dhënat klimatike për qytetin e Lezhës, normat ndërkombetare, si dhe normat Evropiane, apo çdo standard tjetër të pranuar në Republikën e Shqipërisë.

Hartimin e projektit të zbatimit të instalimeve të brendëshme të sistemit të ajrit të kondicionuar.

Hartimin e preventivit të sistemit të ajrit të kondicionuar me zëra pune.

Specifikimet teknike për të gjithë materialet sipas normave të prodhimit të CE dhe pajisjet që do të përdoren nga projektuesit gjatë hartimit të projektit në fjalë.

Relacionin teknik të hollësishëm për zbatimin me korrektësi të punimeve të projektit.

Sistemi i propozuar nuk duhet të bjerë ndesh me funksionin e ndërtesës. Si i tillë, komforti termik, qarkullimi i mirë i ajrit dhe lagështia relative e krijuar në ambient është shumë e rëndësishme. Zgjidhjet për sistemin e ngrohjes, ftohjes dhe ventilimit duhet të përfshijnë të gjithë ambientet, duke ruajtur parametrat e këshillueshëm për tipologjinë e secilit ambient, në përputhje me nevojat funksionale të tij.

Projekti mekanik duhet të harmonizohet me konceptin e përgjithshëm arkitekturor të shprehur në projektin përkatës. Krahas sa më sipër, të shqyrtohet mundësia e integritit të burimeve të rinovueshme të energjisë për ngrohje dhe përdorimit të sistemeve me ndikim minimal në mjedis.

Sistemi i ngrohje-ftohjes, do të realizohet nëpërmjet sistemit qendror. Sistemi i ngrohjes do të bëhet sipas standarteve që kërkon shërbimi spitalor.

Kërkesat teknike kundrejt projektit të mbrojtjes nga zjarri

Projekti për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin duhet të realizohet në nivel godine në bazë të standardeve dhe normave lokale, si dhe ato të vendeve të Komunitetit Europian. Sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit duhet të respektojë të gjitha kërkesat e detyrueshme shtetërore që kanë të bëjnë me normat / standardet që janë në fuqi aktualisht në Shqipëri si dhe normat Evropiane.

Ligjet, rregulloret, normat dhe standardet, mbi të cilët duhet të hartohet projekti, objekt i kësaj detyre projektimit janë paraqitur në vijim: - Ligji nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”; - Rregullore “Mbi masat e mbrojtjes kundër zjarrit në projektimin e ndërtesave të çdo lloji “Vendim nr.162 datë 19.4.1965, e ripunuar; - Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendëshme nr.425 date 24.7.2015 “Për pranimin, administrimin e dokumentacionit teknik dhe grafik të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dhe lëshimin e akteve teknike”.

Projektimi i masave për mbrojtjen kundër zjarrit dhe shpëtimin nuk duhet të trajtohen të ndara nga përgatitja e projekteve specifike; projektit arkitekturor, konstruktiv, hidrosanitar, elektrik dhe mekanik. Masat e nevojshme për mbrojtjen nga zjarri duhet të reflektohen edhe në projektet më sipër cituar, në përputhje me udhëzimet dhe zgjidhjet e trajtuara në projektin e mbrojtjes kundra zjarrit.

Në projektin e mbrojtjes kundra zjarrit duhet të përfshihen të gjitha masat aktive dhe pasive, për mbrojtjen nga zjarri të ndërtesës që projektohet. Relacioni teknik i mbrojtjes nga zjarri duhet të përmbajë minimalisht të dhënat sipas pikës 5 të Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendëshme nr.425 date 24.7.2015 “Për pranimin, administrimin e dokumentacionit teknik dhe grafik të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dhe lëshimin e akteve teknike”.

Kërkesat kundrejt raportit dhe auditimit të efikasitetit energjétique.

Mbështetur në VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 (hyrja në fuqi 21.05.2015) “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e azhurnuar, pjesë e dokumentacionit për marrjen e Lejes së Ndërtimit duhet të jetë edhe projekti i efikasitetit energjetike, në rastet kur është e detyrueshme me ligj.

Pjesë e dokumentacionit të projektimit duhet të jetë edhe Raporti mbi efikasitetin e energjitike të ndërhyrjes së propozuar. Projekti i propozuar dhe specifikimet teknike duhet të përmbushin kriteret për efikasitetin e energjisë, në përputhje me propozimet dhe masat e reflektuara në këtë raport.

Kur projektohet një ndërtesë e re ose kur një ndërtesë duhet t'i nënshtrohet një rinovimi të rëndësishëm, subjekti që ka apo do të ketë në pronësi apo përgjegjësi administrimi këtë ndërtesë, duhet të marrë në konsideratë zbatimin e kërkesave të Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes së performancës së energjisë së ndërtesave dhe të analizojë mundësinë e përdorimit të sistemeve me një performancë të lartë të energjisë, të parashikuara në Ligjin 116/2016 “PËR PERFORMANCËN E ENERGJISË SË NDËRTESAVE” neni 8 e vijues.

Hartimi i propozimeve të zgjidhjeve teknike në respektim të kriterëve të efikasitetit energjetike të ndërtesës së parashikura, duhet të kryhet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet të gjithë specialistëve të përfshirë, me qëllim që në të gjithë projektet specifike të mbahen në konsideratë kriteret e efikasitetit energjetike, për arritjen e një performancë sa më të mirë energjetike të të gjithë ndërtesës.

Hartimi i Raportit të efikasitetit energjetike duhet të kryhet në përputhje me metodologjinë kombëtare të llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa, sipas nenit 5 të Ligjit 116/2016 më sipër cituar.

Gjatë procesit të projektimit duhet paraprakisht të kryhet vlerësimi i mundësisë së përdorimit të sistemeve alternative me efikasitet të lartë energjie. Gjatë vlerësimit teknik të mundësisë së përdorimit të sistemeve alternative me efikasitet të lartë energjie, duhet të merren në konsideratë çështjet mjedisore dhe ekonomike.

Projekti i propozuar dhe specifikimet teknike duhet të përmbushin kriteret për efikasitetin e energjisë, në përputhje me propozimet dhe masat e reflektuara në këtë raport.

Kërkesat teknike kundrejt shërbimeve që i takojnë nëntokës.

Shërbimet që i takojnë nëntokës duhet të paraprijnë procesin e projektimit. Hartimi i tyre duhet të respektojë kuadrin ligjor në fuqi dhe eurokodet aktuale.

Kërkesa të përgjithshme.

Gjatë hartimit të projektit do të mbahet kontakt i vazhdueshëm me autoritetet e Institucionit dhe grupin e punës së përpilimit të detyrës së projektimit, i cili do të vendosë në dispozicion të grupit të punës për hartimin e projektit një fotokopje të dokumentacionit tekniko – juridik që disponon, në shërbim të procesit të projektimit;

Autorët e projekteve duhet të marrin përsipër përveç realizimit të planeve dhe skicave (vizatimet teknike) të përshkruajnë në mënyrë të detajuar të gjitha zërat e punimeve që do të përmbajë preventivi;

Projekti të shoqërohet me një relacion teknik ku të përshkruhen saktë zgjidhjet e ofruara teknike, avantazhet dhe prioritetet e tyre, materialet dhe paisjet e përdorura, vetitë dhe karakteristikat e tyre;

Gjithashtu, grupi i projektimit duhet të marrë përsipër konsultat me zbatuesin si dhe predispozicionin për tu angazhuar në ndryshimet e mundëshme që mund të lindin, si pasojë e situatave të paparashikuara apo shmangieve si evoluim i kërkesave të investitorit në procesin e realizimit;

Projekti duhet të përshijë dhe specifikimet teknike për materialet që do përdoren, por projektuesi duhet të ketë kujdes të mos përcaktojë markën apo çdo detaj tjetër që identifikon prodhuesin;

Në përgatitjen e projekt-preventivit të merret në konsideratë funksionimi, komoditeti dhe estetika e ambienteve të tij. Gjithashtu, preventivat e punimeve të jenë të ndara me grupe zërash pune, spas ambienteve që të mund të kryhen në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri.

Kërkesa të veçanta.

Zgjidhjet dhe ndërhyrjet e propozuara duhet të bazohen në kritere të tilla:

Të kenë ndikim minimal në mjedis.

Të jenë propozuar në përputhje me funksionin e ambientit.

Të respektojnë Legjislacionin në Fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë këtu legjislacionin në fushën higjieno – sanitare dhe legjislacionin në fushën e mbrotjes nga zjarri.

Çdo ndërhyrje të jetë e mirëjustifikuar nga pikëpamja teknike dhe funksionale.

Shërbimet e kërkuara sipas fazave.

Grupi i projektimit duhet të kryejë shërbimet e mëposhtme:

Hartimin i projekt preventivit duhet të përfshijë fazat si vijon:

Kosto totale do të përcaktohet nga preventivi përfundimtar i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike, relacionin, si dhe duke marrë parasysh dhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standardet e pranuar.

Në hartimin e preventivit çmimet e referencës do të jenë sipas legjislacionit, mbështetur në Manualin Teknik të Çmimeve në fuqi, **ne sistemin e integruar ne e –albania** . Për zërat e punimeve që nuk gjenden në manual, projektuesi duhet të hartojë analiza përkatëse, të cilat do ti bashkëlidhen të detajuara projekt zbatimit, kjo për të siguruar kursimin dhe efijencën e përdorimit të fondeve.

Faza I - Analiza e detyrës së projektimit / përcaktimi i bazës së projektit.

Faza III - Projektideja përfundimtare.

Faza IV - Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit.

Faza V - Projekti i zbatimit.

Faza VI - Preventivi përfundimtar bazuar ne \manualin 2023.

Shërbimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis duhet të përfshijë fazat si vijon:

Faza I - Aplikimi për VNM paraprake.

Shërbimi Topografik duhet të përfshijë fazat si vijon:

Faza I - Analiza e detyrës së projektimit/percaktimi i bazës së projektit

Faza II - Planet e pozicionimit dhe rilevimit

Faza IV - Vizatime te piketave

Faza V - Projekt zbatimi Piketat për qëllime planifikimi

Shërbimet që i takojnë nëntokës dhe punimeve në themele duhet të përfshijnë fazat si vijon:

Faza I.

1. Qartësimi i kërkesave të projektit

2. Përcaktimi i strukturës së tokës nga dokumentet ekzistuese, duke specifikuar dhe prezantuar strukturën e nëntokës, sipas testeve të kërkuara.

Faza II.

Analizimi dhe prezantimi i rezultateve të testeve laboratorike dhe në terren për strukturën e nëntokës,

Vlerësimi i gamës së lëkundjeve të tokës me përmbajtje uji,

Vlerësimi i nëntokës, specifikimi i parametrave kryesorë në strukturën e tokës.

Faza III.

Paraqitja e rekomandimeve për qëndrueshmërinë e themeleve dhe presionet e lejuara në tokë, në rast të veçantë propozohet dhe dimensionimi i themelit.

Deklaratë mbi cedimet e pritura nga realizimi i veprës për të realizuar shërbimet bazë të përfshira në projektin final për veprat inxhinierike sipas nenit 39.

Udhëzimet për të gërmuar themelet dhe për të mbajtur edhe strukturën e thatë, edhe kontrollimin e ndikimit të projektit në strukturat ngjitur.

Standarde në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për personat me aftësi të kufizuar, të verbrit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihen parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji "Për planifikimin e territorit" I ndryshuar .

Realizimi i Projektit

Projekti i paraqitur për struktura 'Rikonstrukcion Shkolle dhe sistemimi i terreneve sportive të Shkolles 9 – Vjeçare 'Dodë Gegë Jaku ' Manati, Njesia Administrative Kolsh, Lezhe',

Duke iu referuar VKM Nr. 354, datë 11.5.2016 "Për Miratimin e manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Terriori, Projektim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim" duhet të kalojë në këto faza:

Faza e I: Analiza e detyrës së projektimit e cila përfshin:

Shërbimet bazë:

- Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit.
- Dhënia e konsultave mbi nevojën edhe shkallët e shërbimit.
- Përmbledhja e rezultateve

Shërbimet të veçanta

- Studimi i gjendjes
- Analiza e vendodhjes
- Planifikimi i punës
- Verifikimi i rëndësisë së mjedisit
- Verifikimi i pajtueshmërisë me mjedisin

Faza e II: Projekt-ideja përfundimtare (sistemet dhe planifikimi i integruar)

Projekt Idea duhet të realizohet në jo më pak se një variant, ku për secilin variant duhet të paraqitet relacioni teknik mbi ndërhyrjet, projektin e ndërhyrjeve, kostoja e ndërtimit për secilin variant dhe specifikimet teknike. Paraqitja e varianteve duhet të bëhet në bazë të ndërhyrjes, të rezultateve të vlerësimit të kostos së ndërtimit dhe asaj të shfrytëzimit.

Varianti me treguesit më social - ekonomik dhe teknik që do përzgjidhet , do vazhdoj procedurën e hartimit të projekt zbatimi.

Faza e III: Projekti për miratimin e lejës së ndërtimit.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, i cili duhet të mbështetet në ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar .

Faza e IV: Projekti i Zbatimit

Të kryhet hartimi i Projekt - Zbatimit të objektit me përmbajtjen si më poshtë :

- Raporti Teknik
- Topografinë e gjendjes ekzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjëndjen e sotme (me leje dhe pa leje)
- Projektin arkitektonik: Relacion arkitektonik i objektit, Fasadat, Planimetritë ekzistuese dhe të reja të objektit, Prerjet e godinës, Plan mobilimin e ambienteve, Plani i mbulesës, etj;
- Projektin e zbatimit/konstruksionin të objektit: Plani i strukturave dhe detajet, Plani i themeleve, etj.
- Projekt Zbatimin e instalimeve hidrosanitare, të kanalizimeve
- Projekt Zbatimin e instalimeve elektrike, të shoqëruara me licencën e noteruar të projektuesit
- Projekt Zbatimin e instalimit të sistemit të ngrohjes, të mbrojtjes kundër zjarrit të strukturës të miratuar nga Drejtoria e Zjarrit dhe Shpëtimit
- Projektin e eficensës energjitike , dhe miratimin perkates nga Ministria
- Projektin e sistemimit dhe të gjelbërimit të oborrit, projektin e ambienteve të lojtrave;
- Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen.
- Grafikon e punimeve të detajuar sipas zërave të punës
- Rekomandime për materialet e ndërtimit që do të përdoren
- Relacionin gjeologjik për shtesat e reja të parashikuara,
- Relacion sizmik
- Eficensa energjitike
- Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)
- Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujërave të shiut
- Analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve që nuk janë në manual;

- Plan organizimim e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve që do jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur në grafikun e punimeve;
- Licencë të firmës projektuese, licencë të ekspertit mjedisor dhe ekstrakt i regjistrit tregtar.

Rekomandime për projektuesin

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me zonën ku ndodhet shkolla. Sistemin ekzistues të largimit të ujërave, Sistemin e furnizimit të zonës me ujë të pijshëm, Sistemin ndriçues rrugor, distancat e lejuara si dhe kriteret urbane të zonës në fjalë.
- Projektuesi duhet të përdore studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia e Lezhe , seksioni i Urbanistikës dhe nga kadastra.
- Konsulentit do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria Arsimore Lezhe edhe një Program Standard i ambienteve ku janë përcaktuar standardet minimale të organizimit të hapësirave të brendshme, lloji i ambienteve të detyrueshme, instruksione mbi funksionet që duhet të akomodohen, sipërfaqet funksionale të rrethimeve dhe sistemeve të jashtme, etj.
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standardin e kërkuar.

Gjithashtu projektuesi duhet të paraqesë

- Plani i vendosjes së strukturës i cili do të hartohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë së Lezhe.
- Rilevim topografik të sheshit të shkolles .
- Licencë të shoqërisë projektuese + ekstrakt të Regjistrit Tregtar
- Licenca të inxhinierëve projektues, licenca të ekspertit mjedisor + deklarata noteriale të inxhinierëve projektues.
- Projekti i plotë elektrik (planvendosjen e të gjitha pajisjeve elektrike, sistemi data - telefoni, projekti i MNZ, i mbrojtjes atmosferike dhe tokëzimit) të printuara në formatin A3, shkalla 1:1000 në 3 kopje origjinale; Kopja e noterizuar e licencës së inxhinierit elektrik që ka kryer projektin
- Planvendosja e objektit në shkallën 1 : 1000 format A3 .

Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar

Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë e Lezhes . Staf i kërkuar duhet të mbulojë :

- Arkitekt
- Inxhinier ndërtimi strukturist (konstruktor)
- Inxhinier gjeodet
- Inxhinier hidroteknik/hidraulik
- Inxhinier për sistemet e ngrohjes
- Inxhinier gjeolog, në rastin kur ndërhyrje në konstruksionin e objektit
- Inxhinier elektrik
- Preventivues
- Inxhinier mjedisi;
- Ekspert të efikasitetit energjitike
- Staf mbështetës për fushat e mësipërme.

Raportimi

Raportet dhe dokumentat duhet të jenë në 5 (pesë) kopje, në gjuhën shqipe ku njëra nga kopjet të jetë e printuar me ngjyra. Vizatimet duhet të jenë të lexueshme në formatin "dëg" (AutoCad 2007-2012). Të gjitha materialet do të dorëzohen edhe në soft-copy (në 5 CD).

Relacioni teknik që shoqëron projektin duhet të përmbajë:

- Raportin teknik të projektimit arkitektonik
- Raportin teknik të projektimit konstruktiv ku duhet të përfshihet edhe raporti mbi llogaritjet për gjithë strukturat (themelet, shkallëve, soletave, arkitrarëve, trarëve, etj.) si dhe masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, siguria e kalimit në objekt gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit. Në këtë raport do të bashkëngjiten dhe anekset përkatëse ku janë të gjitha llogaritjet përfshirë modelin kompjuterik të llogaritjeve për kontrollet eventuale nga ana e investitorit.
- Relacionin sizmologjik të truallit (kur nuk ka studim, një përshkrim i përgjithshëm)
- *Specifikimet Teknike të cilat duhet të jepen për çdo zë pune.*
- Relacionin gjeologjik dhe vetitë fiziko-mekanike të dherave ku duhet të paraqiten.
- *Cilësitë fiziko-mekanike të dherave dhe të shtresave në themelet e objektit ekzistues.*
- *Rekomandime dhe propozime për raste të veçanta.*
- Certifikata e Performances se Energjise

Gjithashtu për këtë projekt, bazuar në Ligjin Nr 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë" si dhe Vendimit Nr.537, datë 08/07/2020 për miratimin e kërkesave minimale të performances se energjisë së ndërtesave dhe elementeve të ndërtesave duhet të realizohet raporti i auditimit të energjisë dhe Certifikata e Performances se Energjise.

Oponenca teknike

Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik. Me "objekte me akses publik", sipas këtij neni, do të kuptohen të gjitha objektet, ku, pavarësisht statusit të pronësisë së tyre, qytetarët kanë akses të lirë hyrjeje, si: kinema, teatro, stadione, markete etj..".

- Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (nese e kerkon ligji)
- Raport elektrik.
- Raport hidro, kush, kuz.
- Raport i sistemeve mekanike, ngrohje – ftohje, mnz. etj...
- Raport teknik; Preventiv; Rilevimi.
- Grafiku i punimeve.
- Licensat e stafit projektues.
- Deklaratat e përgjegjesis profesionale të stafit pjesmarres në hartimin e projektit. Dorëzimi final, fizik, i projektit të zbatimit, do të konsiderohet ai, i cili do të ketë kaluar të gjitha fazat e mësipërme, si të dhe bazuara në: Ligji 107/2014 Për planifikimin e zhvillimit të territorit i ndryshuar ; Ligji 69/2012 Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar ;Ligji nr 8402 date 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar ;Ligji 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara" i ndryshuar ;Ligj nr. 116/2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave" ;Ligji nr. 152/2015 Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin. Projektuesi do të përdorë edhe standardet në fuqi të projektimit të hartuara nga MASH për objektet arsimore: VKM 319 datë 12.04.2018.

Paraqitja e vizatimeve.

Vizatimet në fazë projekt zbatimi duhet të paraqiten në format A3, të jenë të lexueshme dhe të përmbajnë si minimum fletët si më poshtë:

- Topografinë e gjendjes ekzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjëndjen e sotme (me leje dhe pa leje)

- Planimetria e përgjithshme e objektit në Shk. 1:200; 1:500
- Planimetritë e kateve ekzistuese Shk. 1:100, 1:50
- Planimetritë e objektit pas ndryshimeve Shk. 1:100; 1:50
- Fasadat ekzistuese Shk.1:100
- Fasadat e reja në 2D dhe 3D Shk.1:100
- Prerjet e godinës (në të dy drejtimet) Shk.1:100
- Planimetria e themeleve Shk.1:100
- Prerje të themeleve dhe detajet Shk.1:20; 1:10
- Plani i strukturave detaje Shk.1:100; Shk.1:50
- Planimetritë e mobilimit të shkollës Shk.1:100
- Planimetria e rrjetit të kanalizimeve në shkallën Shk. 1: 100
- Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve Shk.1:10, 1:20
- Planimetria e furnizimit me ujë në Shk. 1: 200, 1:100
- Skemat aksonometrike të furnizimit me ujë, detaje të pajisjeve hidrosanitare Shk.1:100
- Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të ujësjellësit Shk.1:20, 1:10
- Planimetria, aksonometria dhe detaje të sistemit të ngrohjes Shk.1:100
- Planimetria dhe detaje të sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit Shk.1:100
- Planimetria e dhomës së kaldajës, konstruksioni, detaje Shk.1:100;1:50
- Planimetri dhe detaje për ndriçimin, fiksimin e ndriçuesve në tavan, instalimin e kuadrit kryesor etj. Shk.1:100;1:50
- Planimetria e skemës së shpërndarjes së fuqisë në të gjithë objektin, Shk. 1:100
- Planimetritë për telefoninë, rrjetin e internetit Shk.1:100; 1:50
- Planimetria e ndriçimit të jashtëm dhe detaje të tij Shk.1:100; 1:50
- Planimetria e ambienteve sportive dhe ambienteve të gjelbëruara dhe detaje Shk.1:100; 1:50
- Planimetria e murit rrethues, tipin dhe detajin e fiksimit të stolave Shk.1:100; 1:50.
- Planimetria disiplinimit dhe shkarkimit të ujërave sipërfaqësore dhe detajet përkatëse shk.1: 100; 1:50.
- Planimetria e Shpronësimeve, Kjo planimetri do të identifikojë pronat dhe godinat që preken nga realizimi i projektit dhe gjithashtu të bëhet llogaritja e sipërfaqes që preket për arsye shpronësimi.

Faza e V: Projekti i Zbatimit

Preventivi i plotë i kushtimit të veprës. Përgatitja e preventivit të detajuar sipas specifikimeve të projektit me programin e punimeve të ndara sipas kategorive dhe zërave të punës. Harmonizimi dhe kordinimi i kategorive të punës së projektit të bëra nga specialistet e përfshirë në planifikimin e projektit.

Investimi Themelor

Investimi themelor do të dal nga varianti më i mirë tekniko-ekonomik i aprovuar nga Bashkia Lezhe.

Sqarime të fundit

Të dhënat e nevojshme për projektim, siç janë: gjendja e rrjetit ekzistues të ujësjellësit, të kanalizimeve, ndriçimit, kabinat e tensionit të lartë, planin rregullues të zonës, etj, do t'i bashkëngjiten kësaj detyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

MIRATOHET

PJERIN NDREU
KRYETAR



DETYRË PROJEKTIMI

PËR REALIZIMIN E STUDIM PROJEKTIMIT:

RIKONSTRUKSION SHKOLLE, SISTEMIMI I TERRENEVE SPORTIVE TË
SHKOLLES 9 – VJEÇARE ‘SHTJEFËN GJEÇOVI’ NE TROSHAN, NJESIA
ADMINISTRATIVE BLINISHT, LEZHE

Lezhë
Korrik 2024

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
Institucioni përfitues	3
Arsyetimi i nevojës për ndërhyrje.	3
Baza ligjore.	3
Qëllimi i projektit të investimit.	3
Objektivat e projektit të investimit.	3
PËRSHKRIM I DETYRËS SË PROJEKTIMIT	4
Qëllimi	4
Objektivat	4
Përshkrim i përgjithshëm	4
Pozicionimi i parcelës që zhvillohet	4
Gjendja faktike	7
Kërkesat teknike planimetriko – kompozicionale dhe infrastrukturore	10
Kërkesat teknike kundrejt projektit arkitekturor.	13
Hapësirat e brendshme të sanitarisë	14
Trajtimi i ujërave të zeza dhe atmosferike	15
Drenazhimi i lokacionit	15
Sistemi i drenazhit të ujërave atmosferikë	16
Drenazhimi i kulmit	16
Ajrosja e mjedisëve	16
Sistemet dhe rregullat për mbrojtje nga zjarri	16
Qasja në lokacion	16
Pajisjet e fikjes së zjarrit	16
Mbrojtja nga rrufetë	18
Projektimi për personat me nevoja të veçanta	18
Kërkesat teknike kundrejt projektit konstruktiv.	19
Mbulesa	Error! Bookmark not defined.
Soletat	Error! Bookmark not defined.
Suvatimet.	20
Lyerja e mureve të brendshëm dhe të jashtëm	20
Fasada	20
Shtresat e pllakave	20
Shkallët	21
Dyer, dritare	21
Kërkesat teknike kundrejt projektit hidrosanitar.	21
Kërkesat teknike kundrejt projektit elektrik dhe elektronik.	22

Rrjeti telefonik dhe kompjuterik	24
Sistemi elektrik, ndriçimi i emergjencës dhe sigurisë.	24
Kërkesat teknike kundrejt projektit mekanik	24
Kërkesat teknike kundrejt projektit të mbrojtjes nga zjarri	25
Kërkesat kundrejt raportit dhe auditimit të efikasitetit energjetic.	25
Kërkesat teknike kundrejt shërbimeve që i takojnë nëntokës.	26
Kërkesa të përgjithshme.	26
Kërkesa të veçanta.	26
SHËRBIMET E KËRKUARA SIPAS FAZAVE.	26
Hartimin i projekt preventivitet duhet të përfshijë fazat si vijon:	26
Faza I - Aplikimi për VNM paraprake.	27
Faza I.	27
Faza II.	27
Faza III.	27
STANDARDE NË PROJEKTIM	27
Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik	28
REALIZIMI I PROJEKTIT	28
Faza e I: Analiza e detyrës së projektimit e cila përfshin:	28
Faza e II : Projekt-ideja përfundimtare (sistemet dhe planifikimi i integruar)	28
Faza e III : Projekti për miratimin e lejës së ndërtimit.	28
Faza e IV: Projekti i Zbatimit	28
Rekomandime për projektuesin	29
Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar	30
RAPORTIMI	30
Oponenca teknike	30
Paraqitja e vizatimeve.	31
Faza e V: Projekti i Zbatimit	32
Investimi Themelor	32
Sqarime të fundit	32

HYRJE

Institucioni përfitues

Institucioni përfitues i shërbimit në fushën e projektimit është Bashkia Lezhë. Përfituesi i këtij shërbimi është Institucion Publik.

Misioni i këtij institucioni është të sigurojë një infrastrukturë sa më cilësore arsimore për popullatën dhe posaçërisht për shëndetin e nënës dhe fëmijës së porsalindur.

Përfituesi i projektit është sistemi arsimor, për infrastrukturën fizike të të cilit është përgjegjës pushteti vendor.

Arsyetimi i nevojës për ndërhyrje.

Problematika që sjell nevojën e investimit. Në rast se nuk ka problematikë por përputhet me strategjinë e zhvillimit shtjellohet strategjia që e bën të nevojshëm investimin.

Ky projekt është nevojë e rëndësishme e momentit e institucionit për realizimin e veprimtarisë së tij institucionale, si dhe përputhet me strategjinë e zhvillimit të Bashkisë Lezhë dhe orientimeve të ministrisë së linjës.

Baza ligjore.

Bazuar në statusin ligjor të institucionit, ky shërbim në fushën e projektimit duhet të përmbushë kërkesat dhe të marrë në konsideratë referencat si vijon:

1. Ligj Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i përditësuar
2. Rregulloren e Zhvillimit të Territorit (në fuqi).
3. VKM Nr.1503, datë 19.11.2008 "Për miratimin e Rregullores "Për shfrytëzimin e hapsirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar"".
4. Ligj Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".
5. Ligj Nr. 124/2015 "Për efikasitetin e energjisë".
6. "Rregullore për formatin e auditimit energjistik dhe pagesën e audituesit energjistik", miratuar me Urdhër Nr. 5, datë 12.01.2021 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.
7. Manualet, standardet dhe kushtet teknike shtetërore dhe evropiane të projektimit të objekteve spitalore.
8. VNM
9. Çdo ligj, apo manual tjetër, të lidhur me projektimin e ndërtesave të kësaj natyre.

Qëllimi i projektit të investimit.

Qëllimi i rikonstruksionit është që të përmirësohet infrastruktura e procesit mësimor në shkollën 9-vjeçare "Shtjefën Gjeçovi", Troshan, Lezhë nëpërmjet rikonstruksionit të godinës dhe mjediseve sportive, në mënyrë që të rritet edhe cilësia e mësimdhënies dhe nxënies.

Konsulentit duhet të vlerësojë mundësinë e rindërtimit të një godine të re nga fillimi. Në rast se vlerësimi i kushteve paraprake nuk e lejon një gjë të tillë, do vlerësohet mundësia e një rikonstruksioni.

Gjithashtu duhet vlerësuar mundësia e ndërtimit të një kopshti për fëmijë brenda të njëjtit shesh ndërtimor.

Objektivat e projektit të investimit.

Objektivi kryesor i këtij projekti është të sigurojë ambiente të projektuara dhe të përshtatura në përputhje me kërkesat dhe nevojat e veprimtarisë arsimore, në respektim të standardeve bashkëkohore infrastrukturore dhe çdo akti juridik, normativ, apo standard në fushën e projektimit të ndërtesave arsimore në Republikën e Shqipërisë dhe më gjerë, në shërbim të rritjes së cilësisë së ofrimit të shërbimeve.

Objektivat specifikë të këtij projekti investimi përmbledhen në vazhdim:

- Organizimi funksional i mjediseve shkollore dhe zonimi hapësinor i tyre, në përputhje me kërkesat dhe standardet infrastrukturore për objektet arsimor të mesëm ulët.
- Pajisja e objektit me sisteme, rrjete dhe materiale ndërtimore bashkëkohore.
- Përmirësimi i gjendjes fizike të ndërtesës për të përmbushur kritere infrastrukturore për efikasitetin energjitik, komoditetin termoakustik, mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, kërkesat higjieno - sanitare dhe përshtatjen e mjediseve për personat me aftësi të kufizuara.
- Përmirësimi i mjediseve sportive të shkollës në përputhje me kërkesat për mjedise rekreative, kërkesat drenazhimit e ujërave të shiut, ato për mbrojtjen e mjedisit dhe kriteret për orientimin e fluksit të nxënësve.

PËRSHKRIM I DETYRËS SË PROJEKTIMIT

Qëllimi

Detyra e Projektimit ka për qëllim parashtrimin e të dhënave thelbësore, njohëse, kërkesave dhe nevojave specifike të institucionit përfutur, në cilësinë e Porositësit, kundrejt shërbimit të kërkuar, si dhe orientimet mbi problematikën aktuale të shtruar për zgjidhje, mbi bazën e të cilave, grupi i projektimit, do të hartojë projektin për Rikonstrukcionin e Shkollës 9-vjeçare “Shtjefën Gjeçovi”.

Objektivat

Detyra e projektimit ka këto objektiva:

- Të prezantojë grupin e projektimit me vendndodhjen, infrastrukturën dhe problematikën e gjendjes faktike të objektit që i nënshtrohet ndërhyrjes.
- Të përshkruajë kërkesat sasiore dhe cilësore kundrejt shërbimit të porositur.
- Të evidentojë kërkesat profesionale kundrejt grupit të projektimit.
- Të shtjellojë formën, mënyrën dhe afatet e raportimit të materialeve pranë Porositësit.

Përshkrim i përgjithshëm

Pozicionimi i parcelës që zhvillohet


Vendndodhja: Troshan, Njësia Administrative Blinisht, Bashkia Lezhe



Pozicionimi i objektit lidhur me qendrën e qytetit të Lezhës



Pozicioni i objektit në hartë kadastrale dhe ortofoto



Fragment i Hartës Treguese të Pasurive



Foto te objektit

Përshkrim: Shkolla 9 - vjeçare ‘Shtjefën Gjeçovi’ ne Troshan eshte 1 kat , është ndërtuar në vitin 1964 dhe rikonstruktuar per here te fundit ne vitin 2005. Godina e shkollës është nje objekt nje kat dhe mbulesa është e tipit çati tjegulle

Siperfaqe e gjurmes : 670 m²

Siperfaqe ndertimi totale : 670 m²

Siperfaqe e prones (truall+ gjurme) : 2370 m²

Kapaciteti: Në total frekuentojnë mësimin 79 nxënës nga klasa e pare deri ne te nenten dhe 17 femije frekuentojne kopeshtin e shkollës , Mesimi zhvillohet me një turn.

Të dhëna statistikore për vitin shkollor 2023-2024

- Numri i nxënësve të regjistruar sipas klasave

Klasa e pare		Klasa e dyte		Klasa e trete		Klasa e katert		Klasa e peste		Klasa e gjashte		Klasa e shtate		Klasa e tete		Klasa e nente		Klasa e pare deri e nente		
Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	M
6	3	9	3	4	2	18	7	12	4	10	5	5	5	9	7	6	2	79	38	41

Nxenes me aftesi e kufizuar				Nxenes Rom				Nxenes Egjiptian			
Mendore		Fizike		Cikli fillor		Cikli larte		Cikli fillor		Cikli larte	
Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F
1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Gjendja faktike

Vlerësimi fizik i objektit: Megjithëse shkolla është e mirëmbajtur, vërehen probleme të cilat kërkojnë ndërhyrje sa më parë për t'i eliminuar dhe mos të rëndohen më tepër. Nga një vlerësim paraprak rezulton se:

- Ka nevojë për sistemim të ujërave të shiut, duke qenë të pasistemuara ato depërtojnë në ambientet e brendshme të shkollës .
- Ka nevojë për ndërtimin e sistemit të drenazhimit në ambientet e jashtme sportive.
- Nyjet sanitare rrjedhin dhe japin lagështi në klasa, pajisjet hidrosanitare janë pjesërisht jashtë funksionit.
- Mungon sistemi i ngrohjes, ngrohja pjesërisht me soba druri dhe rezistencë.
- Sistemi elektrik duhet të rishikohet pasi nuk mban ngarkesë.
- Nuk ka sistem të MNZ-së.
- Dyert kanë nevojë për riparime dhe zëvendësime si dhe dritaret.
- Ka nevojë për rrethim të terreneve sportive si dhe për riparime të tyre.
- Ka nevojë për riparim të rrethimit egzistues.

- Konstruksioni mbajtes i çatise se tjegullës është komplet i demtuar dhe nuk e siguron aftësinë mbajtëse . 60 % e tjegullave ekzistuese mund të përdoren pas rikonstruktionit

Foto të gjendjes ekzistuese të objektit







Kërkesat teknike planimetriko – kompozicionale dhe infrastrukurore

Projektuesi duhet të kryejë të gjithë punën në përputhje me standardet e projektimit dhe ndërtimit që janë në fuqi në Shqipëri.

Perpara hartimit të projektit është e domosdoshme të bëhet një Akt – Ekspertimi nga Instituti i Ndërtimit për të përcaktuar qendrueshmërinë e objektit nga pikepamja konstruktive.

Gjatë hartimit të meren parasysh kondicionet e PPV Bashkisë Lezhë. Projektuesi duhet të marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi për ndërtimet, kryesisht: Ligji 107/2014 Për planifikimin e zhvillimit të territorit i ndryshuar; Ligji 69/2012 Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar; Ligji nr 8402 date 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar; Ligji 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara" i ndryshuar; Ligj nr. 116/2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave"; Ligji nr. 152/2015 Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin. Projektuesi do të përdorë edhe standardet në fuqi të projektimit të hartuara nga MASH për objektet arsimore: VKM 319 datë 12.04.2018.

Hartimi i projekteve specifike, të shtjelluar në vijim, duhet të mbështetet në studimet e thelluara të gjendjes faktike. Çdo dokument teknik që disponohet nga institucioni në shërbim të procesit të projektimit do t'i vendoset në dispozicion grupit të projektimit. Grupi i projektimit duhet të hartojë projektet mbështetur në shërbimin topografik të parcelës dhe shërbimet që i takojnë nëntokës, pa anashkaluar kriteret për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e eficensës energjitike.

Gjithashtu Grupi i projektimit do të duhet të bëjë një rilevim faktik arkitektoniko-konstruktiv të ndërtesës.

Shkolla 9 - vjeçare 1 kat 'Shtjefën Gjeçovi' në Troshan, propozohet për: rikonstrukcion të pjesshëm të godinës kryesisht çatia e cila është tejet e amortizuar, ndertimi i sistemit të MNZ, ndertim i sistemit 'Kapote, etj' për eficensën energjitike, sistemimin e ujërave të shiut, zëvendësim të pajisjeve sanitare, pllakave, dyerve dhe dritareve të dëmtuara, riorganizim dhe gjelbërim të ambientit të jashtëm dhe terreneve sportive. Për të ruajtur pastërtinë e oborrit të shkollës apo ambienteve të jashtme, në projekt/preventiv të vlerësohet që të parashikohet vendosja e koshave për mbeturinat.

Gjate hartimit të projektit projektuesi duhet të ketë planifikojë intervistim të perfaqësues të sistemit arsimor dhe të vete shkollës për të mbledhur një informacion paraprak për të hartuar një përmbledhje informative dhe orjentuese.

Përmbledhja përbën pikën e fillimit të punës së ekipit të projektimit. Përgatitja e saj duhet të bëhet mbi këto baza:

- Përshkrimi i një dite të zakonshme të shkollës në këtë moment dhe se si do të ndryshojë ajo me agjendën transformuese;
- Struktura organizative e shkollës, përfshirë drejtimin, departamentet, mbështetjen këshilluese joformale dhe kështu me radhë;
- Etikën dhe vlerat e shkollës;
- Aktivitetet që do të vendosen në shkollë, duke përfshirë edhe jashtë orarit për nevojat e komunitetit si dhe llojin e aktiviteteve që kërkohen;
- Shpeshësinë e aktiviteteve të ndryshme - nivelet e përdorimit të llojeve të ndryshme të akomodimit;
- Afërsinë e kërkuar në mes të aktiviteteve të ndryshme, departamenteve etj;
- Mënyrat për qasjen e komunitetit dhe nivelet e duhura të sigurisë;
- Mënyrat sipas së cilave shkolla mund të ndryshojë në të ardhmen e afërt, në llogari të ndryshimeve pedagogjike, organizimeve joformale këshilluese dhe metodeve të reja të mësimdhënies.
- Të gjitha këto informata janë shumë të dobishme për projektuesit/dizajnerët e shkollës prandaj duhet të përfshihet në përmbledhje të detajuara si informata.

Pasi të jenë zgjedhur të gjitha këto çështje, faza tjetër e hartimit të përmbledhjes është përpilimi i detajuar i planit të akomodimit/detyrës projektuese (fleta që liston të gjitha hapësirat e nevojshme) Këtu duhet të mbahen parasysh ambientet që përmendëm: Biblioteka, palestra, dhoma e mjekut., dhoma e psikologut, ambienti i qeverisë së nxënësve. Kjo detyrë projektuese (plani i akomodimit) do të listojë saktësisht numrin e klasave të duhura dhe madhësitë minimale të dhomave mësimore të tyre, si dhe kapacitetin e parashikuar të shkollës të dhënë në terma të numrit të përgjithshëm të vendeve të nxënësve dhe grupeve. Informata të mëtejshme lidhur me dhomat e veçanta janë të listuara në atë që zakonisht njihet si fleta me të dhëna për të gjitha llojet e dhomave mësimore. Detyra do të shtohet deri në një sipërfaqe të përgjithshme në të cilën synohet të bëhet ndërtimi në mënyrë që të sigurojë që limitet financiare të mos jenë tejkaluar.

Projektuesit duhet të analizojnë madhësitë e klasave eksistuese dhe të propozojnë modifikime të mundshme duke patur parasysh përafrimin me standartin e treguar në tabelën e mëposhtme;

<i>Ciklet e plotë</i>	<i>Zonat urbane me densitet të lartë</i>
-----------------------	--

	<i>Parafillor</i>	<i>Fillor</i>	<i>M. 1 ulët</i>	<i>M. 1 lartë</i>
<i>Vitet:</i>	<i>1</i>	<i>5</i>	<i>4</i>	<i>3</i>
<i>3</i>	<i>3</i>	<i>15</i>		
<i>4</i>	<i>4</i>	<i>20</i>		
<i>5</i>	<i>5</i>	<i>25</i>	<i>20</i>	
<i>6</i>	<i>6</i>	<i>30</i>	<i>24</i>	<i>18</i>
<i>7</i>			<i>28</i>	<i>21</i>
<i>8</i>			<i>32</i>	<i>24</i>
<i>9</i>			<i>36</i>	<i>27</i>
<i>10</i>				<i>30</i>
<i>11</i>				<i>33</i>

Madhësia e shkollave

Përveç kësaj, projektuesi duhet të bëjë vlerësimin dhe të kuptojë se si ligjërohet kurrikulumit dhe se si do të shfrytëzohen klasat e mësimin në mënyrë që ai të mund të del me zgjidhje të reja për llojin e aktiviteteve që do të zhvillohen në klasat e mësimin. Ai gjithashtu duhet të vlerësojë dhe të marrë në konsideratë ndërveprimin dhe qasjen në hapësirat e tjera, siç janë (i) hapësirat përcjellëse që ju përshtaten nxënësve që punojnë, (ii) zonat depove dhe ato për mbështetje të mësimdhënësve, (iii) vendet për ruajtjen e rrobave dhe çantave të nxënësve; (iv) hapësirat sociale dhe rekreative.

Përsa i takon mashësisë së klasave projektuesi duhet të ketë parasysh të dhënat në tabelën e mëposhtme;

<i>Niveli i arsimit</i>	<i>Vende për nxënësit</i>		<i>Sipërfaqja në M2</i>		<i>M2/vend të nxënësit</i>	
	<i>Ulët</i>	<i>Lartë</i>	<i>Ulët</i>	<i>Lartë</i>	<i>Ulët</i>	<i>Lartë</i>
<i>Parafillor</i>	<i>24</i>	<i>30-36</i>	<i>48</i>	<i>65</i>	<i>2.0</i>	<i>1.8-2.2</i>
<i>Fillor</i>	<i>24</i>	<i>30-36</i>	<i>44</i>	<i>58</i>	<i>1.8</i>	<i>1.6-1.9</i>
<i>Mesëm 1 ulët</i>	<i>24</i>	<i>30-36</i>	<i>45</i>	<i>58</i>	<i>1.9</i>	<i>1.6-1.9</i>
<i>Mesëm 1 lartë</i>	<i>24</i>	<i>30-36</i>	<i>nuk ka</i>	<i>58</i>	<i>nuk ka</i>	<i>1.6-1.9</i>

Madhësia e dhomave mësimore

Projektuesi duhet të ketë në konsideratë parime të funksionalitetit duke u kujdesur që gjatë projektimit të ndërtesës shkollë, të krijohet një bilanc mes cilësisë së funksionimit dhe efikasitetit të kostos. Ky bilanc mund të arrihet me mjete të ndryshme, siç janë:

- Dimensionet racionale të hapësirave:
- Zonat e përshtatura të qarkullimit: hapësirat e qarkullimit nuk duhet të kalojnë 25% të sipërfaqes së dobishme të ndërtuar. Ato duhet të kenë dimensione dhe të përshtaten sipas shfrytëzuesve të shkollës, ato duhet të jenë funksionale dhe të respektojnë kërkesat për siguri;
- Numri optimal i hapësirave: numri i hapësirave fillimisht përcaktohet sipas shfrytëzimit. Në rast se norma e pranueshme nuk mund të arrihet, në veçanti për hapësirat për mësimdhënie të specializuar, hapësirat për qëllime të shumëfishta duhet të merren parasysh;
- Përshtatshmëri maksimale: hapësirat duhet të projektohen me një përshtatshmëri maksimale, që i mundëson ato të përshtaten për lëndë dhe ndryshime të ndryshme, në ato raste kur kjo përshtatet me kërkesat e tyre funksionale;
- Grupimi i hapësirave: hapësirat duhet të grupohen në blloqe sipas funksionit dhe ndërlidhjes. Kjo do të siguronte një identifikim të lehtë të veprimtarive dhe hapësirave të tyre korresponduese, një komunikim të lehtë mes hapësirave të ndryshme, pa pengesa nëpër zonat e qarkullimit dhe ato të pritjes, një vëzhgim të lehtë të hapësirave dhe një shfrytëzim optimal të tokës në dispozicion;

- Integrimi i nevojave: lokacioni i hapësirave brenda shkollës duhet të ndjekë domosdoshmëritë themelore siç janë rregullat e sanitarisë dhe higjienës, rregulloret e komoditetit funksional dhe të sigurisë, si dhe komoditetin akustik, vizual e atë klimatik.

Kërkesat teknike kundrejt projektit arkitekturor.

Projektuesi duhet të kujdeset që të analizoje dhe të propozojë në respektim të parametrave të komoditetit, duke adresuar tri burime kryesore të mungesës së komoditetit fizik që trupi mund të përjetojë: temperatura, ndriçimi dhe zëri.

Një vëmendje e shtuar duhet t'i kushtohet Komoditetit termik, i cili zakonisht i atribuohet dy parametrave kryesorë: (i) ndjenjës së komoditetit termik si rezultat i bilancit në mes të kalorive të akumuluarra dhe të humbura në trup, dhe (ii) kontrollit të kushteve klimatike, duke përfshirë pozitën e diellit dhe rrezatimit, temperaturën, lagështinë dhe erërat.

Përmirësimi i komoditetit termik do duhet të përqendrohet në masa artificiale ose aktive, që përfshijnë mjetet mekanike ose ato elektrike, siç është ngrohja, ajrosja apo kondicionimi i ajrit. Projektuesi duhet të vlerësojë edhe masa si:

- Sipërfaqet e mbjella: mbjellja e bimëve që mund të luajë një rol thelbësor në krijimin e mikroklimës, kur është e nevojshme. Mbjellja e bimëve kontribuon në mënyrë efektive në mbrojtjen nga pluhuri, erërat dhe rrezet e diellit. Përveç kësaj, mbjellja e shkurreve dhe kaçubave bëjnë të mundur mbrojtjen kundër reflektimit të rrezeve të diellit nga toka;
- Elementet e dhura të ndërtesës: kjo përfshihet kullimi i dhur nga çatia/terrace dhe kullimin rreth ndërtesës, krijimin e hijeve me kanate të rregullueshme nëpër dritare, ndalesa të diellit, perde për diell, çadra dhe/apo galeri që mund të sjellin mbrojtje shtesë nga rrezet e diellit, sidomos kur orientimi i ndërtesës nuk është i favorshëm.
- Materialet e dhura të ndërtimit, që përfshijnë materialet e fasadave me reflektim të mundshëm të diellit, materialet izoluese për rritjen e veprimit termik të mureve dhe të kulmit.

Projektuesi duhet të mbajë parasysh që për realizimin e komoditetit termik të mësimdhënies duhet të synohen parametrat e dhënë në tabelën e mëposhtme

<i>Klasat e mësimi</i>	<i>19°C</i>
<i>Depot</i>	<i>16°C</i>
<i>Korridoret</i>	<i>15°C</i>
<i>Zonat e sanitarisë</i>	<i>16°C</i>
<i>Punëtoritë</i>	<i>16°C</i>
<i>Sallat për qëllime të shumëfishta</i>	<i>19°C</i>
<i>Zyrat e administratës</i>	<i>19°C</i>
<i>Dhoma e mjekut</i>	<i>22°C</i>

Temperaturat minimale të rekomanduara

Me një vëmendje të shtuar, projektuesi duhet të vlerësojë masat projektuese për rritjen e efikasitetit energjitik të ndërtesës ëprmes rritjes së cilësisë së termoizolimit të strukturës. Ai duhet të vlerësojë edhe cilësinë e materialeve të kaviteve dhe të propozojë eventualisht edhe përmirësimin e sipërfaqeve të dritës.

Me qëllim rritjen e efikasitetit energjitik të godinës projekti duhet të parashikojë veshjen termoizoluese të të gjithë kapsulës veshëse të jashtme të godinës. Projekti arkitekturor duhet të mbajë në konsideratë përshtatjen e objektit për personat me aftësi të kufizuara, referuar kategorizimeve të kufizimeve të ndryshme. Materialet e propozuara për të gjithë elementët ndarës dhe veshës, termoizolues, hidroizolues etj., duhet të jenë bashkëkohorë, të plotësojnë kushtet higjieno sanitare dhe të shmangin elementët e rrezikshmërisë. Rëndësi duhet ti kushtohet akustikës së ambienteve, izolimit nga zhurmat, luhatjet e temperaturës dhe lagështirës.

Gjatë të gjithë procesit të projektimit është e rëndësishme që të bashkëpunohet ngushtë ndërmjet të gjithë specialistëve të përfshirë, pasi projekti arkitekturor duhet të reflektojë kërkesat e projektit strukturor, kërkesat e projekteve të sistemeve teknike, kërkesat e aspekteve arkitekturore të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, kërkesat për efikasitetin energjetic, kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe çdo kërkesë tjetër, të gjykuar si të nevojshme nga specialistët e përfshirë.

Sa i takon komoditetin visual, projektuesi duhet të ketë parasysh se nevoja për standarde të larta dhe një ndriçim i projektuar mirë për ndërtesat shkollore bazohet në: (i) ndriçimin natyror që rezulton nga drita e diellit e drejtpërdrejtë apo ajo e tërthortë e reflektuar nga toka dhe sipërfaqet e tjera të jashtme apo ato të brendshme.

Projektuesit duhet të ndërmarrin masa të duhura për të siguruar komoditetin e ndriçimit që është esencial për një performancë të mirë dhe komoditet vizual të nxënësve dhe personelit të shkollës. Ato janë:

Ndriçimi natyror:

- Për të kufizuar përdorimin e ndriçimit të shtrenjtë artificial, plani(projekti) i ndërtesës dhe i dhomave mësimore duhet të maksimizojë përdorimin e dritës natyrore dhe në këtë mënyrë do të minimizohet rrezatimi i mundshëm që mund të ndodhë gjatë periudhave të caktuara të ditës;
- Niveli i mirë i ndriçimit është i rëndësishëm në zonat e qarkullimit për të minimizuar rrezikun nga aksidentet;
- Distancat mes balleve duhet të lejojnë depërtimin e mjaftueshëm të dritës nëpër ndërtesa. Këto rekomandime mbi këtë lloj distance zbatohen edhe për komoditetin klimatik;
- Numri, dimensionet, vendosja dhe aranzhimet e dritareve duhet të jenë në përputhje me sasinë e kërkuar të dritës (dhe rrjedhën e ajrit). Duke pas parasysh rëndësinë e ndriçimit natyror, rekomandohet që e tërë sipërfaqja e dritareve në hapësirat e mësimin të jetë 15 deri 20% e sipërfaqes së dyshemesë;
- Thellësia e sallave mund të ndikojë në ndriçimin natyror për hapësirat në anën e kundërt të dritareve. Andaj rekomandohet që të shmangen thellësitë e sallave që tejkalojnë 7.00 m;
- Kur kemi streha, amortizatorë dritarësh apo grila për mbrojtjen e dritareve, efekti i tyre në dritën e ditës duhet të studiohet me kujdes;
- Mbjellja e drunjve dhe shkurreve mund të kufizojë intensitetin e dritës, varësisht nga përmasat dhe format, si dhe llojet e gjetheve dhe distanca nga ndërtesat.

Ndriçimi artificial:

- Disa aktivitete shkollore në mënyrë të domosdoshme kërkojnë ndriçim të dukur artificial, në veçanti gjatë kohës së dimrit dhe në fund të ditës apo gjatë ditëve me re.
- Instalimi i pajisjeve të ndriçimit gjithashtu mund të mundësojë zgjatjen e orëve të punës (ndërrimet e dyfishta, mësimet e natës, takimet...);
- Lloji i pajisjeve të ndriçimit që duhet të instalohen varet nga intensiteti i dritës që kërkohet dhe nga lloji i aktivitetit përkatës. Megjithatë tubat fluoreshente, krahasuar me poçet inkandeshente, kanë përparësinë e reflektimit të ulët të sipërfaqeve, efikasitet të lartë, shpërndarje të mirë të dritës, prodhim të ulët të nxehtësisë;

Projektuesi duhet të ketë në vëmendje projektimin për një mjedis higjienik. Për këtë qëllim ai duhet të ketë parasysh

Hapësirat e brendshme të sanitarisë

Cilësia e mjedisit higjienik në shkollë varet nga projektimi, përzgjedhja e pajisjeve për shfrytëzim nga nxënësit, personeli (mësimdhënës, administrativë, shërbyes), si dhe nga mysafirët, por edhe nga mirëmbajtja dhe menaxhimi i shfrytëzimit të këtyre pajisjeve. Këto pajisje, nëse mirëmbahen mirë do të sigurojnë nivelin e tualeteve, banjave dhe furnizimit me ujë që kërkohet brenda ndërtesave shkollore. Përveç këtyre ekzistojnë edhe komponentët e jashtëm të këtyre shërbimeve, menaxhimi i

mirë i të cilave është thelbësor për higjienën dhe funksionimin e vazhdueshëm të pajisjeve të brendshme.

Në bashkëpunim me stafin mësimor, konsulenti duhet të parashikojë ambjente sanitare të përshtatshme për fëmijët e grupmoshës 6 deri 15 vjeç dhe atyre të sistemit parashkollorë.

Nyjet sanitare të jenë të veçanta dhe lavamanët të jenë të mjaftueshëm për numrin e nxënësve. Të sigurohet ujë i vazhdueshëm dhe i ngrohtë në lavamanë, për këtë arsye të shikohet mundësia e instalimit të boliereve si dhe realizimi i rrjetit të nevojshëm hidraulik.

Banja dhe parabanja të jenë të ajrosura, të ndriçuara dhe të ventiluar. Kur s'ka ajrim direkt duhet të pajisen me impiant ajrimi dhe ventilimi. Kollonat e shkarkimit të jenë të shkëputura nga kanalet e ventilimit, me ajrim në tarracë dhe shkarkimet të jenë të kontrollueshme.

Banjat të kenë porta të hapshme nga jashtë dhe të shkëputura nga dyshemeja dhe të përjashtohet hapja nga brenda, për raste emergjence.

Ambientet sportive

Për terrenet e jashtme sportive ka nevojë për ndërtimin e sistemit të drenazhimit. Terrenet e jashtme sportive kanë nevojë për sistemim dhe mobilim urban .

Sistemimet e jashtme dhe ambientet e gjelbëruara

Sistemimit të oborrit të shkollës duhet ti kushtohet një rëndësi e veçantë. Ai duhet të rezultojë me rrethim transparent (kangjella, etj) dhe të garantojë të gjitha normat e sigurisë dhe standardeve për ndërtime të këtij lloji. Ambientet e jashtme janë ambiente që kryesisht shërbejnë për qëndrim, çlodhje prandaj rëndësi të veçantë ka edhe krijimi i një sipërfaqeje të gjelbër dhe me pemë. Projektuesi duhet të japë të detajuara shtresat përkatëse dhe teknologjinë e zbatimit të tyre, dhe të kombinojë ambientet e qëndrimit/rreshtimit me ambientet e gjelbëruara.

Konsulenti duhet t'i jap rëndësi dhe të parashikojë dhe ndriçimin e jashtëm të objektit, në përputhje me planin urbanistik të kësaj zone dhe në përputhje me kërkesat e veçanta për rrjetin e ndriçimit të dhënë në këtë detyrë projektimi.

Për të mbajtur pastërtinë e oborrit të shkollës, në projekt/preventiv të parashikohet vendosja e koshave për mbeturinat, sidomos në afërsi të stolave.

T'i kushtohet kujdes i veçantë, sistemimit dhe disiplinimit të ujërave sipërfaqësore të cilat janë problematike për këtë objekt.

Trajtimi i ujërave të zeza dhe atmosferike

Në përgjithësi, ekzistojnë 2 lloje të ujërave që duhet të trajtohen dhe të qiten jashtë ndërtesave shkollore. Këto janë: (i) të gjitha ujërat e tualeteve; dhe (iii) ujërat nga shirat, nga kulmet apo hapësirat e jashtme.

Të gjitha ujërat mund të dërgohen drejtpërdrejtë në rrjetin e kanalizimit. Rekomandohet që ujërat atmosferike nga kulmet të grumbullohen në një rezervuar të ndarë në mënyrë që ai ujë të shfrytëzohet për ujitjen e hapësirave të gjelbëruara në oborr të shkollës.

Për ruajtjen e ujit kërkohet cisterna e prodhuar nga çeliku i galvanizuar apo nga material tjetër që është rezistues dhe që plotëson kushtet higjienike për depozitim ujit të pijshëm. Pozita apo vendndodhja e këtyre cisternave do të rregullohet në atë mënyrë që të ekzistojë rënia e lirë e duhur kurdo që kërkohet për furnizim me ujë të të gjitha pjesëve të shkollës.

Drenazhimi i lokacionit

Drenazhimi i lokacionit të shkollës përfshinë shkallëzimin e përgjithshëm të lokacionit, sistemin e drenazhimit të ujërave pas shtrëngatave dhe atë të ujërave atmosferike.

Sistemi i drenazhit të ujërave atmosferikë

I tërë drenazhimi i lokacionit nga ndërtimet e reja apo nga ndërtesat ekzistuese lidhen me sistemin ekzistues të drenazhimit të ujërave atmosferikë dhe të gjitha rrjedhat e ujërave atmosferikë nga hapësirat e shtruara (terrenet sportive, ato për lojëra, rrugët, vend parkimet, dhe shtigjet) mblidhen në kanalet për drenazhim të ujërave atmosferike apo në kanale të hapura dhe do të barten përmes gypave nëntokësorë në vendgrumbullim të ujërave, në rezervuare të ujërave apo në rrjetin e kanalizimit të qytetit.

Drenazhimi i kulmit

Kulmi i ndërtesave duhet të planifikohet në atë mënyrë që të mundësojë drenazhimin e ujërave atmosferike: (i) kulmet e rrafshëta nga pllakat e çimentos duhet të kenë pjerrtësinë minimale prej 1% që shkon drejt pikave dalëse dhe tek gypat vertikalë të drenazhimit; (ii) kulmet e pjerrëta të ndërtesave disakatëshe duhet të kenë ulluqet dhe gypat vertikalë të drenazhimit, të lidhura me sistemin kryesor të drenazhimit në lokacion.

Në lidhje me sigurinë e objektit ndaj zjarrit duhet të kihet parasysh

Ajrosja e mjediseve

Ajrosja e mjediseve të shkollës përmirëson shumë higjienën brenda objektit, duke eliminuar lagështinë, lagështinë nga muret, nga ndarjet e hapësirave dhe nga hapjet, si dhe duke larguar insektet që bartin sëmundje. Përveç kësaj, lëvizjet e ajrit ndihmojnë në zvogëlimin e disa sëmundjeve, siç janë mukozat, duke zvogëluar temperaturën trupore, dhe rrjedhimisht duke zvogëluar djersitjen e nxënësve dhe të punonjësve përmes avullimit dhe rrymimit. Ajrosja e ndërtesave shkollë mund të bëhet përmes:

Sistemet dhe rregullat për mbrojtje nga zjarri

Masat paraprake që duhet të ndërmerren nga projektuesit e shkollave përfshijnë një grup masash për kufizimin e rreziqeve nga zjarri, lehtësimin e evakuimit të shfrytëzuesve të ndërtesave dhe lehtësimin e qasjes së ekipeve të shpëtimit. Kjo përfshinë metoda të ndryshme të mbrojtjes dhe sisteme të sigurisë ndaj zjarrit të cilat janë përshkruar shkurtimisht në vijim:

Qasja në lokacion

Për sa i përket mbrojtjes nga aksidentet, lokacioni i shkollës duhet të vendoset sa më larg që është e mundur nga zonat që paraqesin rrezik nga zjarri (punëtoritë, fabrikat, depot, pompat e benzinës...), dhe rruga e qasjes për në ndërtesa duhet të jetë, së paku, 8.0 m e gjerë (të shqyrtohet me shërbimet lokale të shpëtimit) dhe duhet të jetë e përshtatshme për vetura dhe kamionë, përfshirë ambulancat dhe automjetet e shpëtimit të zjarrfikësve.

Tubacionet dhe hidrantët e fikjes së zjarrit: tubacionet e fikjes së zjarrit instalohen nëpër ndërtesa dhe pajisjen me valvula në mënyrë që shërbimet e zjarrfikjes dhe të shpëtimit të mund të lidhin tubat për ujë për të fikur zjarrin brenda ndërtesës. Ato mund të jenë të llojit “të thatë” që zakonisht janë të zbrazëta dhe furnizohen përmes një tubi nga pajisjet pompuese të shërbimit të zjarrfikjes dhe të shpëtimit, ose të jenë edhe të llojit të “lagësht” ku ato mbahen me plot ujë dhe furnizohen nga rezervarët dhe pompat në ndërtesë. Duhet të ekzistojë edhe një pajisje për t’i mundësuar sistemit të lagësht që të rimbushet nga pajisjet e pompimit në rast të emergjencave.

Pajisjet e fikjes së zjarrit

Hetimi automatik i zjarrit: Zbulimi i hershëm automatik dhe alarmimi i zjarrit ndihmojnë në daljen e shpejtë dhe të sigurt të personave, apo e trajtojnë zjarrin kur ai gjendet në fazën e parë të zhvillimit. Kjo do të mundësojë thirrjen e ndihmës profesionale pa ndonjë vonesë gjë që do të ulte dëmtimet e shkaktuara të ndërtesës dhe përmbajtjes së saj. Shembuj të këtyre pajisjeve përfshijnë pajisjet mbaj-dhe-hap të dyerve kundër zjarrit, sistemet e nxjerrjes së tymit apo sistemet e ajrosjes, sistemet e presimit dhe valvulave të zjarrit në tubacionin e ajrosjes.

Shenjat dhe njoftimet: Të gjitha shenjat dhe njoftimet duhet të vendosen në mënyrë që ato të shihen dhe të kuptohen me lehtësi. Shenjat duhet të përdoren, aty ku është e nevojshme, për t'ju ndihmuar personave që t'i identifikojnë rrugët e daljes dhe daljet, të gjejnë pajisjet e zjarrfikjes dhe telefonat emergjent në rast të zjarrit. Lajmërimet duhet të përdoren, aty ku është e nevojshme, për të dhënë udhëzime se si të përdoren pajisjet kundër zjarrit, rreth veprimeve që duhet të ndërmerren në rast të zjarrit dhe informatave rreth shërbimit kundër zjarrit dhe të shpëtimit.

Ndriçimi emergjent: ndriçimi emergjent nevojitet për të treguar dhe ilustruar në mënyrë të qartë rrugët dhe shenjat e daljes, përfshirë këtu rrugët e daljes që janë jashtë ndërtesës, për të siguruar që ndryshimet e kateve dhe të drejtimeve të tregohen dhe për të siguruar që pikat e thirrjes së alarmit të zjarrit dhe pajisjet e zjarrfikjes të mund të gjenden me lehtësi.

Kontrolli i tymit: ekzistojnë katër arsye kryesore për kontrollimin e shpërndarjes së tymit, që janë, mbrojtja e rrugëve të daljes, asistimi i fikjes së zjarrit, kufizimi i rrezikut ndaj shfrytëzuesve të objektit në sallat që nuk janë në afërsi të zjarrit dhe minimizimi i dëmit nga tymi ndaj përmbajtjes së ndërtesës. Në shumicën e rasteve kjo arrihet përmes përdorimit të masave të përmbajtjes, siç janë dyert dhe muret. Megjithatë në disa rrethana sistemet e ajrosjes të tymit apo sistemet e shtypjes mund të jenë të nevojshme apo të dëshirueshme.

Ndihma e parë e zjarrfikjes: fikësit e zjarrit duhet të përmbushin funksionin për sigurinë e jetës nëse mënyra më e sigurt e ikjes nga efektet e zjarrit është fikja e tij. Ata gjithashtu kanë një rol të dukshëm në mbrojtjen e pronës, nëse zjarri mund të luftohet para se të bëhet shumë i madh. Llojet e ndryshme të fikësve të zjarrit përdoren për llojet e ndryshme të zjarrit: në tabelën 3.6 më poshtë janë paraqitur llojet kryesore të fikësve të zjarrit, llojet e zjarrit për të cilët ata janë të përshtatshëm dhe lokacionin e përgjithshëm të pajisjeve të zjarrfikjes.

Kur rreziku nga zjarri nuk është i kufizuar në ndonjë lokacion të caktuar, p.sh. zjarret e kategorisë A, fikësit e zjarrit duhet të vendosen në rrugët e daljes, afër daljes nga dhoma apo në dysheme, apo në daljen e fundit nga ndërtesa.

Sistemet e spërkatjes: Sistemet e spërkatjes përfshijnë njehsorët e rrjedhjes të lidhur me alarme, dhe nëse instalohet një sistem i fikjes së zjarrit në tërë ndërtesën do të kenë një bonus shtesë që janë hetuesit e nxehtësisë në tërë shkollën që mund të shpijnë në kursime të përgjithshme. Megjithatë, ky sistem mund të jetë shumë i shtrenjtë dhe projektuesi mund të duhet të zgjedhë një tipar të kufizuar të kompensimit për të trajtuar rreziqet specifike përmes mbrojtjes së vetëm një ndërtese apo vetëm ndonjë pjese të ndërtesës.

Dyert kundër zjarrit: dyert e vendosura në muret rezistuese ndaj zjarrit apo në muret ndarëse duhet të jenë dyer kundër zjarrit, të dizajnuara që të rezistojnë kalimin e zjarrit dhe të tymit. Dyert e zjarrit përdoren në rrugët e daljes për të ndarë korridoret e gjata duke siguruar kështu që jo më shumë se një pjesë e shkurtë e korridorit që shpie në dalje të mbushet me tym gjatë ndonjë zjarri. Dyert e zjarrit duhet të përdoren për të ndarë shkallët nga rrugët e qarkullimit në mënyrë që shkallët të mbrohen nga hyrja e tymit.

Dyert e zjarrit në përgjithësi do të kenë panele të qelqit për t'i ndihmuar shfrytëzuesve për të parë më tej, përfshirë ata me nevoja të veçanta, gjatë lëvizjes së tyre. Panelet e pamjes gjithashtu do të jenë të dobishme në rast të zjarrit për t'ju mundësuar njerëzve që të shohin nëse hapësira nga ana tjetër është prekur nga tymi apo jo. Përdorimi i qelqit varet në atë nëse ai ofron izolim si dhe integritet për nivelin e duhur të rezistencës ndaj zjarrit për së paku 60 minuta.

Mbrojtja nga rrufetë

Sistemi për mbrojtje nga rrufetë është një masë e rëndësishme mbrojtëse që duhet të kihet parasysh nga projektuesit e shkollave. Sistemi është i projektuar për të mbrojtur ndërtesat dhe përmbajtjen e tyre nga dëmtimi për shkak të goditjeve, duke i ndërprerë ato dhe duke e përcjellë pa rrezik rrymat e tyre të tensionit të lartë në tokë. Shumica e sistemeve për mbrojtje nga rrufetë përmbajnë në vete një rrjet të përbërë nga tri elemente. Ato janë:

- shufrat rrufepritëse ose terminalet ajrore që zakonisht janë të vendosura në ose përgjatë pikave më të larta të strukturës së kulmit, dhe të lidhura elektrikisht me njëra tjetrën përmes përçuesve të lidhur;
- përçuesit metalik të vendosur teposhtë që gjithashtu quhen “të drejtuar teposhtë”, të cilët janë të lidhur në rrugën më direkte për te njëri ose më shumë vendshkarkues në tokë. Lidhjet për elektrodën e vendosura në tokë nuk duhet të kenë vetëm rezistencë të ulët, por duhet të kenë edhe vetë-induktancë të ulët;
- elektrodën e tokëzimit ose “tokëzimi” i bërë nga shufrat, pllakat metalike ose rrjetat.

Objekti duhet të adresojë edhe kërkesa të posaçme

Projektimi për personat me nevoja të veçanta


Projektimi/dizajnimi i ndërtesave shkollore duhet të siguroj qasjen e papenguar, lëvizjes, qëndrimin dhe mësimnxënies të nxënësve me nevoja të veçanta, referuar legjislacionit perkates, per kete kategori. prandaj, projektuesit duhen të bazohen në këtë legjislacion por edhe në këtë udhëzues ku janë paraqitur kushtet teknike më specifike për ndërtesat shkollore. Llojet e nevoja të veçanta për të cilat mund të përkujdesemi në një shkollë standarde do të kufizohen, për arsye praktike, në ato me nevoja të veçanta në lëvizje, humbje të dëgjimit që korrigohet me pajimet për dëgjim, dhe humbja e pjesërishme ose e tërësishme e të parit, pas trajnimit adekuat. Mirëpo, kategoria e fundit nuk do të jetë në gjendje të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet shkollore të mësimdhënies ose të mësimnxënies.

Personat me nevoja të veçanta mund të jenë nxënës, arsimtarë, mysafirë ose personel. Problemi i tyre kryesore është reduktuara në lëvizshmërinë e tyre për arsye se ata shfrytëzojnë karrocën e invalidëve, patericat ose bastunët. Ky problem kërkon dimensionim të veçantë të zonave të qarkullimit, hapësirave të dymëve, pajisjeve sanitare, shtigjeve të evakuimit dhe hapësirave të klasave për t'i akomoduar personat me nevoja të veçanta.

Dimensionet e personave me nevoja të veçantë nëpër karrocën e invalidëve duhet të kihet parasysh nga projektuesit gjatë caktimit të madhësisë së hapësirave të shkollës dhe qarkullimit. Karrocën e invalidëve kanë dimensione të ndryshme, sipas moshës së nxënësve dhe llojit të artikullit. Megjithatë, dimensionet e mëposhtme, përkojnë me dimensionet mesatare të personave të rritur, e që duhet të merren parasysh


- Gjerësia e karriges përgjithësisht është mes 600 dhe 700 mm
- Gjatësia është mes 1000 dhe 1250 mm

- Rrezja e jashtme është mes 1300 dhe 1500 mm



Hapësira deri ku mbërrijnë personat me nevoja të veçanta në karrocat e invalidëve definohet

- Mes 230 dhe 300 mm mbi nivelin e dyshemesë;
- Mes 1100 dhe 1300 në lartësi;
- Mes 300 dhe 400 mm nga pjesët anësore të karriges;



Kërkesat teknike kundrejt projektit konstruktiv.

Hartimi i projektit konstruktiv duhet të mbajë në konsideratë propozimin e zgjidhjeve më të përshtatshme, referuar konceptit të përgjithshëm arkitekturor dhe funksionit të ambientit.

Materialet, teknikat dhe teknologjitë e propozuara duhet të respektojnë kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Në mungesë të tyre projektuesi duhet t'u referohet Eurokodeve aktuale në përdorim.

Projekti konstruktiv duhet të respektojë kërkesat e jetëgjatësisë së projektimit, ngarkesave dhe rregullave të projektimit për sa i përket durabilitetit (Klasa e durabilitetit), në funksion të kushteve të ekspozimit të tij, bazuar në Eurokode.

Hartimi i projektit konstruktiv duhet të mbështetet në studimin gjeologjik – inxhinierik të truallit dhe studimin sizmologjik.

Çatia

Aktualisht objekti I katesh, eshte i mbuluar me çati tjegulle .

Projektuesi duhet te projektoje nje cati te re , të japë të gjitha detajet arkitektonike lidhur me çatine : vendosja e kasetës së shkarkimit dhe ullukët vertikalë dhe horizontale si dhe detaje të tjera të domosdoshme për zbatimin e punimeve duke qenë se një pjesë e ujërave të shiut janë të pasistemuar dhe grumbullohen në ambientet e shkollës. Gjithashtu duhet të tregojë, numrin e ulluqeve dhe diametrat e tyre sipas normave në fuqi. Për sasitë e reshjeve do të përdoren të dhënat e Institutit Hidrometeorologjik.

Ne projekt te parashikohen edhe daljet e oxhakeve egzistues , pasi ato duhet te jene funksionale.

Soletat

Është detyrë e konsulentit, kontrolli dhe verifikimi teknik i soletave ekzistuese të objektit, në mënyrë që të parashikohet rikonstruksioni i tyre sidomos në rastet kur ka probleme, të lidhura me degradimin e tyre dhe me uljen e aftësive mbajtëse.

Muret

Konsulenti do të japë të gjitha detajet e përforcimit të muraturës mbajtëse në rastin kur ajo paraqitet me probleme. Në rast të mureve me çarje, konsulenti do të tregojë mënyrën e riparimit/konsolidimit të tyre

Suvatimet.

Objekti i rikonstruktuar duhet të suvatohet nga brenda dhe jashtë. Në pjesët e dëmtuara, suvatimet e mureve dhe tavaneve do të kryhen në të gjithë sipërfaqen përkatëse duke ruajtur shtresën e parë ekzistuese ku të mundet në mure, kurse tavanet te pastrohen dhe të risuvatohen. Të gjitha shtresat e tjera në rast se janë të dëmtuara do të hiqen pa dëmtuar muret.

Përsa i përket suvatimeve të jashtme do të jenë në varësi të llojit të ndërhyrjes që parashikon projekti, nëse do të restaurohet sipërfaqja ekzistuese ose do të rishikohet e gjitha sipas konceptit të ri që kërkon fasada.

Lyerja e mureve të brendshëm dhe të jashtëm

Muret e brendshëm dhe tavanet do të lyhen me hidromat, kurse pjesa e poshtme e mureve do të lyhet me bojë akrilik me ngjyrë të ndryshme ose jo nga muret, gjë e cila do të vendoset në bashkëpunim me stafin e shkollës.

Fasada

Fasada e shkollës, të jetë e tillë që të mirëmbahet lehtë, kurse ngjyrat e fasadës të jenë të bukura, në mënyrë që objekti të bëhet më atraktive për fëmijët. Fasadat duhet të jenë të veshura me kapotë termike antizjarr. Konsulenti duhet të përcaktojë gjithashtu vendodhjen e tabelës me emrin e shkollës.

Shtresat e pllakave

Pllakat ekzistuese të dyshemesë së vjetër së bashku me llaçin e vjetër nëse është e nevojshme do të zëvendësohen nga shtresa e re e dyshemesë, me pllaka, duke patur parasysh rinivelimin e saj me llaç – çimento si dhe me shtresat e nevojshme izoluese në rastin e ambienteve që nevojiten. Dyshemetë e tualeteve dhe muret e tyre në një lartësi të caktuar, duhet të izoloohen dhe projektuesi duhet të japë detajin e izolimit të tyre. Çdo shtresë duhet të jetë e detajuar me specififikimet përkatëse.

Shkallët

Është e nevojshme përcaktimi i qartë i gjendjes së shkallëve të jashtme, si nga ana funksionale në lidhje me kapacitetin ashtu edhe nga pikëpamja konstruktive ose e aftësisë mbajtëse të konstruksionit në rastin e rikonstrukcionit të godinës. Edhe nëse shkallët nuk kanë nevojë për rikonstrukcion, bazamakët dhe parapetet duhet të ribëhen.

Projekti duhet të përmbajë të gjitha detajet si dhe specifikimet teknike të domosdoshme për fazën e projekt zbatimit.

Dyer, dritare

Projektuesi duhet të përcaktojë që materialet që do të përdoren të jenë të cilësisë së lartë. Nëse janë propozuar dyer prej druri, ato duhet të jenë prej druri të fortë me mentesha të forta (minimumi tre për çdo derë).

Vendosja e dyerve dhe plani i hapjes së tyre të realizohet i tillë që të plotësojë kushtet e daljes së shpejt në raste emergjencash dhe standardet e vendosura nga MAS.

Përsa i përket dritareve do të jenë duralumini të cilësisë së lartë me hapje me rrotullim dopio-xham dhe me sopralluce në ambiente që e kërkojnë atë. Gjithashtu për katet e para duhet të jetë të parashikuara të gjitha normat e sigurisë pra edhe pajisja e tyre me elementet metalike mbrojtës përkatës.

Kërkesat teknike kundrejt projektit hidrosanitar.

Projektimi i Sistemit Hidrosanitar të Furnizimit me ujë dhe shkarkimeve të ujërave të ndotura dhe atmosferike të ndërtesës dhe projektimi i rrjetit inxhinierik të ujërave në zonën përreth duhet të kryhet në përputhje me projektin arkitektonik.

Sistemi hidrosanitar i furnizimit me ujë dhe shkarkimeve të ujërave të ndotura të ndërtesës dhe jashtë saj duhet të projektohet në përputhje me Kushtet Teknike të Projektimit (KTP) në Fuqi, si dhe sipas udhëzimeve të Standardeve të projektimit shtetërore dhe ndërkombëtare. Ky sistem duhet të projektohet, në përputhje me zgjidhjet e konceptuara në projektin arkitekturor dhe duke marrë në konsideratë kërkesat bashkëkohore për funksionimin e nyjeve higjieno – sanitare.

Sistemi hidrosanitar i furnizimit me ujë duhet të sigurojë prurjen e kërkuar, me presionin e nevojshëm në çdo pajisje hidrosanitare. Ky sistem duhet të garantojë furnizimin e vazhdueshëm dhe pa ndërprerje të të gjitha nyjeve sanitare, duke vendosur një rezervë ujore rreth 24 orëshe, si dhe grup presioni për sigurimin e presionit në rastet e furnizimit me ujë nga depozita.

Sistemi hidrosanitar i kanalizimeve të ujërave të ndotura duhet të mbledhë dhe largojë me vetërrjedhje ujërat e nyjeve sanitare. Nëse ka mjedise sanitare nën nivelin e linjave të rrjetit rrugor, duhet të vendosen grupe presioni tip njësi kompakte me rezervuar, të cilat të lidhen direkt me linjën e shkarkimit (të ruhet hermeticiteti i sistemit të kanalizimeve, jo me pusetë).

Nevojitet që në ndërtesë të sigurohet furnizimi me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë, duke u bazuar në zgjidhje aktuale dhe perspektive, të cilat do të shmangnin maksimalisht nevojën për ndërhyrje të mëvonshme në objekt dhe do të realizoheshin duke mbajtur në konsideratë edhe aspektet e efikasitetit energjitike afatgjatë.

Për llogaritjet e parametrave hidraulikë dhe gjeometrikë të sistemit, prurjet, humbjet hidraulike, presionin e nevojshëm dhe diametrat duhet të përdoren tabelat e dhëna në kushtet teknike të sipërpërmendura. Llogaritjet e parametrave hidraulikë dhe gjeometrikë të rrjetit duhet të kryhen, duke patur parasysh edhe prurjen e grupeve përzierës (mishelatorë) të ujit apo të rubinetave të pajisjeve përkatëse.

Zgjidhjet teknike të propozuara në projektin hidrosanitar duhet të respektojnë funksionin e objektit, si dhe standardet dhe normativat e detyrueshme, të përcaktuara në aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi.

Të gjithë tubacionet dhe rakorderitë e sistemeve hidrosanitare duhet të propozohen sipas standardeve dhe certifikimeve bashkëkohore ndërkombëtare.

Të nisur nga sa më sipër gjatë hartimit të projekt-zbatimit duhet të meren parasysh sa më poshtë:

- Të merret në konsideratë perspektiva 10 vjeçare e rritjes së numrit të fëmijëve.
- Të merret në konsideratë rrjeti ekzistues i kanalizimeve të zonave ku ndodhen objektet, por gjithashtu konsulenti duhet të marrë në konsideratë projektin e ri të kanalizimeve për këto zona, nëse ka.

Sistemi i largimit të ujërave të bardha dhe të zeza do të jetë miks.

Në përputhje me normat, konsulenti duhet të ketë parasysh numrin e fëmijëve, stafin mësimor dhe administrativ.

Konsulenti duhet të verifikojë gjendjen teknike të banjave ekzistuese dhe duhet të përgatisë projektin e detajuar si për rikonstruksionin e atyre ekzistuese ashtu edhe të shtesës eventuale të kapacitetit (numrit) të tyre.

Rrjeti i shkarkimit të ujërave të zeza do të ndërtohet me materiale bashkëkohore dhe në përputhje me standardet në fuqi.

Rrjeti i amortizuar i ujësjellësit do të zëvendësohet. Gjithashtu në bashkëpunim me shoqërinë e Ujësjellës Kanalizime sh.a. do saktësohet dhe gjendja e ujësjellësit ekzistues të zonës si dhe problemet e vërejtura në këtë zonë gjatë periudhës së furnizimit me ujë duke përcaktuar edhe kapacitetin depozitues për furnizim me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje gjatë ditës .

Materialet që do përdoren për rrjetin e brendshëm të ujësjellësit do jenë tuba polietileni me densitet të lartë për ujë të pijshëm me diametër dhe afësi mbajtëse në përputhje me prurjet dhe presionet llogaritëse.

Për nyjen e marrjes nga rrjeti i zonës do të parashikohet puseta me kapak b/a, përmasat e të cilave duhet të realizohen sipas kushteve teknike dhe të sigurojnë kushte normale manovrimi dhe riparimi. Nëse është e domosdoshme, projektuesi duhet të parashikojë zëvendësimin dhe nxjerrjen jashtë pune të sistemit të vjetër të furnizimit me ujë.

Projektuesi të parashikojë në projekt/preventivin e objektit, vlerën e furnizimit dhe vendosjes së linjës së furnizimit me ujë nga pika e marrjes së dhënë nga Ujësjellës Kanalizime sh.a. Lezhe deri tek matësi i ujit.

Të parashikohet realizimi i depozitave të ujit, të nevojshme në raste emergjence si dhe lidhja e tyre në, me të paktën dy prej lavamanëve dhe nyjeve sanitareve si dhe depozitat e ujit për MNZ.

Kërkesat teknike kundrejt projektit elektrik dhe elektronik.

Projekti elektrik duhet të përshtatet me kërkesat dhe nevojat funksionale të secilit ambient.

Projekti duhet të përmajë rrjetin e ndriçimit, ku përfshihet edhe ndriçimi i ambienteve të jashtëm dhe ndriçimi i emergjencës, rrjetin e prizave të furnizimit me energji, të prizave të UPS, rrjetin e furnizimit me energji elektrike nga OSHEE, sistemin e telefonisë, rrjetit LAN, sinjalizimit të zjarrit, sistemin video, acces-control, sistemin e vëzhgimit me kamera, sistemin e rrafepitjes etj., në harmoni me kërkesat e projektit arkitekturor.

Pozicionimi i ndriçuesve për secilin ambient duhet të përputhet me konceptin arkitekturor të përgjithshëm, në përputhje me funksionin e ambientit dhe standardet kundrejt tij.

Ndriçuesit e propozuar duhet të shmangin elementët e rrezikshmërisë, emetimin e lëndëve të rrezikshme për shëndetin, përdorimin materialeve që shkaktojnë mbejtje të dëmshme për jetën dhe shëndetin e përdoruesve të ambienteve.

Ndriçimi në ambiente duhet të jetë shpłodhës dhe plotësojë normativat e detyrueshme nga tipologjia funksionale e tyre. Shpërndarja e ndriçuesve në ambient duhet të përshtatet me kërkesat funksionale të tij, duke ruajtur sipas rastit një shpërndarje të njëtrajtshme të dritës, apo duke shtuar ndriçuesa pranë tavolinave, ose zonave të punës. Kjo zgjidhje duhet gjithsesi të përmbushë kërkesat nominale të ambientit për ndriçim, sipas tipologjisë, pa cënuar konceptin e përgjithshëm të pasqyruar në projektin arkitekturor mbi estetikën, zgjidhjen e tavanëve, mureve dhe hapsirave të punës dhe ndriçimin e përgjithshëm të interierit. Tipologjia, estetika, këndi i hedhjes së dritës dhe gjeometria e secilit ndriçues duhet të përcaktohet në bashkëpunim me projektuesin arkitekt duke mbajtur në konsideratë lartësinë e ambientit dhe tavanëve të varur (në rast se janë propozuar). Drita ideale duhet të vijë në tavolinën e punës me kënd anësor dhe jo pingul. Shkëlqimi i sipërfaqeve duhet të kufizohet.

Pavarësisht referencave më sipër, nisur nga specifikat e veçanta të secilit ambient funksional, mbetet në gjykimin e projektuesit përdorimi i një standardi minimal ndriçimi, ose një tjetri, bazuar në kërkesat e saktësuara për secilin ambient, në përputhje me veprimtarinë dhe proceset e punës, për të cilët është projektuar.

Vendosja e prizave elektrike, Lan, sistemeve audio video etj. duhet të përputhet me hapsirat e punës të propozuara nga arkitekti në projektin e mobilimit.

Në tërësi në hartimin e projektit do të mbahen parasysh këto kërkesa për projektimin dhe zbatimin e rrjetit elektrik dhe elektronik:

Të gjithë instalimet elektrike, kabllot dhe ndriçuesit, çelësat, prizat etj. duhet të jenë hermetikë.

Ndriçimi elektrik duhet të zbatohet sipas normat e CE.

Sistemi elektronik duhet të konceptohet me server (servera) qendror të veçantë.

Në projektin elektrik duhet të parashikohet edhe instalimi i ndriçimit të emergjencës, në rastet e shkeputjeve të rrymës, apo emergjence të çfarëdo lloji.

Në ndërtesë duhet të parashikohet projektimi dhe instalimi i sistemit të tokëzimit dhe mbrojtjes atmosferike.

Në ndërtesë duhet të parashikohen sisteme elektrike dhe elektronike të nevojshme për mirëfunksionimin e ndërtesës si institucion publik. Krahas sa më sipër, të shqyrtohet mundësia e integritit të burimeve të rinovueshme të energjisë.

Rikonstrukcioni i objekteve duhet të përfshijë edhe instalimin e ri elektrik, telefonik dhe rrjetin e internetit në laboratorin e informatikës dhe zyrave të administratës.

Konsulenti duhet të parashikojë ndriçimin e ambienteve me ndriçues me fuqi të mjaftueshme për të garantuar një ndriçim në përputhje me normat në fuqi, dhe një numër të mjaftueshëm prizash për secilin ambient, sipas destinacionit të tyre. Projektuesi duhet të japë detajin e fiksimit të ndriçuesve si dhe dimensionet e elementeve në të cilat ato do të kapen.

Panelet e komandimit të vendosen të rinj sipas standardeve bashkëkohore.

Në këto kushte projektuesi duhet të parashikojë nqs nevojitet dhe instalimin e rrjetit elektrik trefazor me fuqi të tillë që të sigurojë funksionim normal të sistemit elektrik me të gjitha pajisjet e saj.

Projektuesi duhet të sigurojë Miratimin e projekteve elektrike në OSHEE, si dhe të përcaktojë edhe pikën e lidhjes me energji elektrike, nga rrjeti i fuqisë (kabina ose transformatori i zonës).

Projektuesi duhet të parashikojë vendosjen e matësit elektrik trefazor, dhe vlerën e përafërt të shtrimit të kabllit nga sahati deri te pika e lidhjes së miratuar.

Projekti elektrik të jetë i shoqëruar me licencën e noteruar të inxhinierit elektrik, e cila do të shërbejë për procedurat e mëtejshme për miratimin e pikës së lidhjes me OSHEE -n. Në projekt-preventiv duhet të parashikohen edhe llambat me bateri të karikueshme, në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike.

Rrjeti telefonik dhe kompjuterik

Në objekt të shikohet mundësia e sistemit telefonike të godinës që të mund të përdoret në çdo moment. Godina duhet të jetë e pajisur me sistem telefonik, rrjetin data dhe sistemi vëzhgimit me kamera CCTV, shoqëruar me sistemin e kontrollit të hyrje/daljeve "access control".

Sistemi elektrik, ndriçimi i emergjencës dhe sigurisë.

Ndriçuesit luminisht dhe prozhektorët të zëvendësohen me ndriçues led, si ndriçues më ekonomik.

Ndriçimi i emergjencës duhet të futet automatikisht në punë dhe të ketë një kohë pune të paktën 1 orë në rast se stakohet tensioni. Ndriçimi i emergjencës dhe i sigurisë duhet të vendoset në ambientet e mëposhtme:

- Korridore, të cilat shërbejnë edhe si rrugë largimi emergjence;
- Dhoma që shërbejnë si pika grumbullimi;
- Në ambientet që nuk kanë dritare;

Projektuesi duhet të parashikojë ndriçimin e dhomave me ndriçues me fuqi të mjaftueshme për të garantuar një ndriçim në përputhje me normat në fuqi, dhe një numër të mjaftueshëm prizash për secilin ambient, sipas destinacionit të tyre.

Në projekt-preventiv duhet të parashikohen edhe ndriçuesit e emergjencës, në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike.

Kërkesat teknike kundrejt projektit mekanik

Projekti i sistemit të ngrohje – ftohjes dhe ventilimit duhet të përfshijë:

Llogaritjet e ngarkesave termike të nevojave për ngrohje – ftohje të secilit ambient dhe nevojave të veçanta të gjithësecilit prej tyre. Projekti i ngrohje/ftohjes/ventilimit duhet të mbështetet në normativat e përcaktura në Standartet ASHRAE, në të dhënat klimatike për qytetin e Lezhës, normat ndërkombetare, si dhe normat Evropiane, apo çdo standard tjetër të pranuar në Republikën e Shqipërisë.

Hartimin e projektit të zbatimit të instalimeve të brendëshme të sistemit të ajrit të kondicionuar.

Hartimin e preventivit të sistemit të ajrit të kondicionuar me zëra pune.

Specifikimet teknike për të gjithë materialet sipas normave të prodhimit të CE dhe pajisjet që do të përdoren nga projektuesit gjatë hartimit të projektit në fjalë.

Relacionin teknik të hollësishëm për zbatimin me korrektësi të punimeve të projektit.

Sistemi i propozuar nuk duhet të bjerë ndesh me funksionin e ndërtesës. Si i tillë, komforti termik, qarkullimi i mirë i ajrit dhe lagështia relative e krijuar në ambient është shumë e rëndësishme. Zgjidhjet për sistemin e ngrohjes, ftohjes dhe ventilimit duhet të përfshijnë të gjithë ambientet, duke ruajtur parametrat e këshillueshëm për tipologjinë e secilit ambient, në përputhje me nevojat funksionale të tij.

Projekti mekanik duhet të harmonizohet me konceptin e përgjithshëm arkitekturor të shprehur në projektin përkatës. Krahas sa më sipër, të shqyrtohet mundësia e integritit të burimeve të rinovueshme të energjisë për ngrohje dhe përdorimit të sistemeve me ndikim minimal në mjedis.

Sistemi i ngrohje-ftohjes, do të realizohet nëpërmjet sistemit qëndror. Sistemi i ngrohjes do të bëhet sipas standarteve që kërkon shërbimi spitalor.

Kërkesat teknike kundrejt projektit të mbrojtjes nga zjarri

Projekti për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin duhet të realizohet në nivel godine në bazë të standardeve dhe normave lokale, si dhe ato të vendeve të Komunitetit European. Sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit duhet të respektojë të gjitha kërkesat e detyrueshme shtetërore që kanë të bëjnë me normat / standardet që janë në fuqi aktualisht në Shqipëri si dhe normat Europiane.

Ligjet, rregulloret, normat dhe standardet, mbi të cilët duhet të hartohet projekti, objekt i kësaj detyre projektimit janë paraqitur në vijim: - Ligji nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”; - Rregullore “Mbi masat e mbrojtjes kundër zjarrit në projektimin e ndërtesave të çdo lloji “Vendim nr.162 datë 19.4.1965, e ripunuar; - Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme nr.425 date 24.7.2015 “Për pranimin, administrimin e dokumentacionit teknik dhe grafik të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dhe lëshimin e akteve teknike”.

Projektimi i masave për mbrojtjen kundër zjarrit dhe shpëtimin nuk duhet të trajtohen të ndara nga përgatitja e projekteve specifike; projektit arkitekturor, konstruktiv, hidrosanitar, elektrik dhe mekanik. Masat e nevojshme për mbrojtjen nga zjarri duhet të reflektohen edhe në projektet më sipër cituar, në përputhje me udhëzimet dhe zgjidhjet e trajtuara në projektin e mbrojtjes kundra zjarrit.

Në projektin e mbrojtjes kundra zjarrit duhet të përfshihen të gjitha masat aktive dhe pasive, për mbrojtjen nga zjarri të ndërtesës që projektohet. Relacioni teknik i mbrojtjes nga zjarri duhet të përmbajë minimalisht të dhënat sipas pikës 5 të Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.425 date 24.7.2015 “Për pranimin, administrimin e dokumentacionit teknik dhe grafik të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dhe lëshimin e akteve teknike”.

Kërkesat kundrejt raportit dhe auditimit të efikasitetit energjetic.

Mbështetur në VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 (hyrja në fuqi 21.05.2015) “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e azhurnuar, pjesë e dokumentacionit për marrjen e Lejes së Ndërtimit duhet të jetë edhe projekti i efikasitetit energjetic, në rastet kur është e detyrueshme me ligj.

Pjesë e dokumentacionit të projektimit duhet të jetë edhe Raporti mbi efikasitetin e energjetic të ndërhyrjes së propozuar. Projekti i propozuar dhe specifikimet teknike duhet të përmbushin kriteret për efikasitetin e energjisë, në përputhje me propozimet dhe masat e reflektuara në këtë raport.

Kur projektohet një ndërtesë e re ose kur një ndërtesë duhet t'i nënshtrohet një rinovimi të rëndësishëm, subjekti që ka apo do të ketë në pronësi apo përgjegjësi administrimi këtë ndërtesë, duhet të marrë në konsideratë zbatimin e kërkesave të Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes së performancës së energjisë së ndërtesave dhe të analizojë mundësinë e përdorimit të sistemeve me një performancë të lartë të energjisë, të parashikuara në Ligjin 116/2016 “PËR PERFORMANCËN E ENERGISË SË NDËRTESAVE” neni 8 e vijues.

Hartimi i propozimeve të zgjidhjeve teknike në respektim të kriterëve të efikasitetit energjetic të ndërtesës së parashikura, duhet të kryhet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet të gjithë specialistëve të përfshirë, më qëllim që në të gjithë projektet specifike të mbahen në konsideratë kriteret e efikasitetit energjetic, për arritjen e një performancë sa më të mirë energjeticë të të gjithë ndërtesës.

Hartimi i Raportit të efikasitetit energjetic duhet të kryhet në përputhje me metodologjinë kombëtare të llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa, sipas nenit 5 të Ligjit 116/2016 më sipër cituar.

Gjatë procesit të projektimit duhet paraprakisht të kryhet vlerësimi i mundësisë së përdorimit të sistemeve alternative me efikasitet të lartë energjetic. Gjatë vlerësimit teknik të mundësisë së përdorimit të sistemeve alternative me efikasitet të lartë energjetic, duhet të merren në konsideratë çështjet mjedisore dhe ekonomike.

Projekti i propozuar dhe specifikimet teknike duhet të përmbushin kriteret për efikasitetin e energjisë, në përputhje me propozimet dhe masat e reflektuara në këtë raport.

Kërkesat teknike kundrejt shërbimeve që i takojnë nëntokës.

Shërbimet që i takojnë nëntokës duhet të paraprijnë procesin e projektimit. Hartimi i tyre duhet të respektojë kuadrin ligjor në fuqi dhe eurokodet aktuale.

Kërkesa të përgjithshme.

Gjatë hartimit të projektit do të mbahet kontakt i vazhdueshëm me autoritetet e Institucionit dhe grupin e punës së përpilimit të detyrës së projektimit, i cili do të vendosë në dispozicion të grupit të punës për hartimin e projektit një fotokopje të dokumentacionit tekniko – juridik që disponon, në shërbim të procesit të projektimit;

Autorët e projekteve duhet të marrin përsipër përveç realizimit të planeve dhe skicave (vizatimet teknike) të përshkruajnë në mënyrë të detajuar të gjitha zërat e punimeve që do të përmbajë preventivi;

Projekti të shoqërohet me një relacion teknik ku të përshkruhen saktë zgjidhjet e ofruara teknike, avantazhet dhe prioritetet e tyre, materialet dhe paisjet e përdorura, vetitë dhe karakteristikat e tyre;

Gjithashtu, grupi i projektimit duhet të marrë përsipër konsultat me zbatuesin si dhe predispozicionin për tu angazhuar në ndryshimet e mundshme që mund të lindin, si pasojë e situatave të paparashikuara apo shmangieve si evoluim i kërkesave të investitorit në procesin e realizimit;

Projekti duhet të përfshijë dhe specifikimet teknike për materialet që do përdoren, por projektuesi duhet të ketë kujdes të mos përcaktojë markën apo çdo detaj tjetër që identifikon prodhuesin;

Në përgatitjen e projekt–preventivit të merret në konsideratë funksionimi, komoditeti dhe estetika e ambienteve të tij. Gjithashtu, preventivat e punimeve të jenë të ndara me grupe zërash pune, spas ambienteve që të mund të kryhen në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri.

Kërkesa të veçanta.

Zgjidhjet dhe ndërhyrjet e propozuara duhet të bazohen në kritere të tilla:

Të kenë ndikim minimal në mjedis.

Të jenë propozuar në përputhje me funksionin e ambientit.

Të respektojnë Legjislacionin në Fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë këtu legjislacionin në fushën higjieno – sanitare dhe legjislacionin në fushën e mbrotjes nga zjarri.

Çdo ndërhyrje të jetë e mirëjustifikuar nga pikëpamja teknike dhe funksionale.

Shërbimet e kërkuara sipas fazave.

Grupi i projektimit duhet të kryejë shërbimet e mëposhtme:

Hartimin i projekt preventivit duhet të përfshijë fazat si vijon:

Kosto totale do të përcaktohet nga preventivi përfundimtar i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike, relacionin, si dhe duke marrë parasysh dhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standardet e pranuar.

Në hartimin e preventivit çmimet e referencës do të jenë sipas legjislacionit, mbështetur në Manualin Teknik të Çmimeve në fuqi, **ne sistemin e integruar ne e –albania** . Për zërat e punimeve që nuk gjenden në manual, projektuesi duhet të hartojë analiza përkatëse, të cilat do ti bashkëlidhen të detajuara projekt zbatimit, kjo për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Faza I - Analiza e detyrës së projektimit / përcaktimi i bazës së projektit.

Faza III - Projektideja përfundimtare.

Faza IV - Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit.

Faza V - Projekti i zbatimit.

Faza VI - Preventivi përfundimtar bazuar në manualin 2023.

Shërbimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis duhet të përfshijë fazat si vijon:

Faza I - Aplikimi për VNM paraprake.

Shërbimi Topografik duhet të përfshijë fazat si vijon:

Faza I - Analiza e detyrës së projektimit/ përcaktimi i bazës së projektit

Faza II - Planet e pozicionimit dhe rievimit

Faza IV - Vizatime të piketave

Faza V - Projekt zbatimi Piketat për qëllime planifikimi

Shërbimet që i takojnë nëntokës dhe punimeve në themele duhet të përfshijnë fazat si vijon:

Faza I.

1. Qartësimi i kërkesave të projektit

2. Përcaktimi i strukturës së tokës nga dokumentet ekzistuese, duke specifikuar dhe prezantuar strukturën e nëntokës, sipas testeve të kërkuara.

Faza II.

Analizimi dhe prezantimi i rezultateve të testeve laboratorike dhe në terren për strukturën e nëntokës,

Vlerësimi i gamës së lëkundjeve të tokës me përmbajtje uji,

Vlerësimi i nëntokës, specifikimi i parametrave kryesorë në strukturën e tokës.

Faza III.

Paraqitja e rekomandimeve për qëndrueshmërinë e themeleve dhe presionet e lejuara në tokë, në rast të veçantë propozohet dhe dimensionimi i themelit.

Deklaratë mbi cedimet e pritura nga realizimi i veprës për të realizuar shërbimet bazë të përfshira në projektin final për veprat inxhinierike sipas nenit 39.

Udhëzimet për të gërmuar themelet dhe për të mbajtur edhe strukturën e thatë, edhe kontrollimin e ndikimit të projektit në strukturat ngjitur.

Standarde në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet

të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për personat me aftësi të kufizuar, të verbrit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihen parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për planifikimin e territorit” I ndryshuar .

Realizimi i Projektit

Projekti i paraqitur për strukturën ‘Rikonstruksion shkolle, sistemimi i terreneve sportive të shkolles 9 – Vjeçare ‘Shtjefën Gjeçovi’ ne Troshan, Njesia Administrative Blinisht, Lezhe

Duke iu referuar VKM Nr. 354, datë 11.5.2016 “Për Miratimin e manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Terriori, Projektim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim” duhet të kalojë në këto faza:

Faza e I: Analiza e detyrës së projektimit e cila përfshin:

Shërbimet bazë:

- Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit.
- Dhënia e konsultave mbi nevojën edhe shkallët e shërbimit.
- Përmbledhja e rezultateve

Shërbimet të veçanta

- Studimi i gjendjes
- Analiza e vendodhjes
- Planifikimi i punës
- Verifikimi i rëndësisë së mjedisit
- Verifikimi i pajtueshmërisë me mjedisin

Faza e II: Projekt-ideja përfundimtare (sistemet dhe planifikimi i integruar)

Projekt Idea duhet të realizohet në jo më pak se një variant, ku për secilin variant duhet të paraqitet relacioni teknik mbi ndërhyrjet, projekti i ndërhyrjeve, kostoja e ndërtimit për secilin variant dhe specifikimet teknike. Paraqitja e varianteve duhet të bëhet në bazë të ndërhyrjes, të rezultateve të vlerësimit të koston së ndërtimit dhe asaj të shfrytëzimit.

Varianti me treguesit më social - ekonomik dhe teknik që do përzgjidhet , do vazhdoj procedurën e hartimit të projekt zbatimi.

Faza e III: Projekti për miratimin e lejës së ndërtimit.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, i cili duhet të mbështetet në ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” I ndryshuar .

Faza e IV: Projekti i Zbatimit

Të kryhet hartimi i Projekt - Zbatimit të objektit me përmbajtjen si më poshtë :

- Raporti Teknik
- Topografinë e gjendjes ekzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjëndjen e sotme (me leje dhe pa leje)
- Projektin arkitektonik: Relacion arkitektonik i objektit, Fasadat, Planimetritë ekzistuese dhe të reja të objektit, Prerjet e godinës, Plan mobilimin e ambienteve, Plani i mbulesës, etj;
- Projektin e zbatimit/konstruksionin të objektit: Plani i strukturave dhe detajet, Plani i themeleve, etj.
- Projekt Zbatimin e instalimeve hidrosanitare, të kanalizimeve
- Projekt Zbatimin e instalimeve elektrike, të shoqëruara me licencën e noteruar të projektuesit
- Projekt Zbatimin e instalimit të sistemit të ngrohjes, të mbrojtjes kundër zjarrit të strukturës të miratuar nga Drejtoria e Zjarrit dhe Shpëtimit
- Projektin e eficenses energjitike , dhe miratimin perkates nga Ministria
- Projektin e sistemimit dhe të gjelbërimit të oborrit, projektin e ambienteve të lojrave;
- Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen.
- Grafikon e punimeve te detajuar sipas zërave të punës
- Rekomandime për materialet e ndërtimit që do të përdoren
- Relacionin gjeologjik për shtesat e reja të parashikuara,
- Relacion sizmik
- Eficensa energjitike
- Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)
- Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujërave të shiut
- Analizat teknike të çmimeve të zërave të punime që nuk janë në manual;
- Plan organizimim e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve që do jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur në grafikun e punimeve;
- Licencë të firmës projektuese, licencë të ekspertit mjedisor dhe ekstrakt i regjistrit tregtar.

Rekomandime për projektuesin

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me zonën ku ndodhet shkolla. Sistemin ekzistues të largimit të ujërave, Sistemin e furnizimit të zonës me ujë të pijshëm, Sistemin ndriçues rrugor, distancat e lejuara si dhe kriteret urbane të zonës në fjalë.
- Projektuesi duhet të përdore studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia e Lezhe , seksioni i Urbanistikës dhe nga kadastra.
- Konsulentit do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria Arsimore Lezhe edhe një Program Standard i ambienteve ku janë përcaktuar standardet minimale të organizimit të hapësirave të brendshme, lloji i ambienteve të detyrueshme, instruksione mbi funksionet që duhet të akomodohen, sipërfaqet funksionale të rrethimeve dhe sistemeve të jashtme, etj.
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standardin e kërkuar.

Gjithashtu projektuesi duhet të paraqesë

- Plani i vendosjes së strukturës i cili do të hartohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë së Lezhe.
- Rilevim topografik të sheshit të shkolles .
- Licencë të shoqërisë projektuese + ekstrakt të Regjistrit Tregtar
- Licenca të inxhinierëve projektues, licenca të ekspertit mjedisor + deklarata noteriale të inxhinierëve projektues.
- Projekti i plotë elektrik (planvendosjen e të gjitha pajisjeve elektrike, sistemi data - telefoni, projekti i MNZ, i mbrojtjes atmosferike dhe tokëzimit) të printuara në formatin A3, shkalla

1:1000 në 3 kopje origjinale; Kopja e noterizuar e licencës së inxhinierit elektrik që ka kryer projektin

- Planvendosja e objektit në shkallën 1 : 1000 format A3 .

Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar

Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë e Lezhës . Staf i që kërkohe duhet të mbulojë :

- Arkitekt
- Inxhinier ndërtimi strukturist (konstruktor)
- Inxhinier gjeodet
- Inxhinier hidroteknik/hidraulik
- Inxhinier për sistemet e ngrohjes
- Inxhinier gjeolog, në rastin kur ndërhyrje në konstruksionin e objektit
- Inxhinier elektrik
- Preventivues
- Inxhinier mjedisi;
- Ekspert të efikasitetit energjetic
- Staf mbështetës për fushat e mësipërme.

Raportimi

Raportet dhe dokumentat duhet të jenë në 5 (pesë) kopje, në gjuhën shqipe ku njëra nga kopjet të jetë e printuar me ngjyra. Vizatimet duhet të jenë të lexueshme në formatin "dëg" (AutoCad 2007-2012). Të gjitha materialet do të dorëzohen edhe në soft-copy (në 5 CD).

Relacioni teknik që shoqëron projektin duhet të përmbajë:

- Raportin teknik të projektimit arkitektonik
- Raportin teknik të projektimit konstruktiv ku duhet të përfshihet edhe raporti mbi llogaritjet për gjithë strukturat (themelet, shkallëve, soletave, arkitrarëve, trarëve, etj.) si dhe masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, siguria e kalimit në objekt gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit. Në këtë raport do të bashkëngjiten dhe anekset përkatëse ku janë të gjitha llogaritjet përfshirë modelin kompjuterik të llogaritjeve për kontrollin eventuale nga ana e investitorit.
- Relacionin sizmologjik të truallit (kur nuk ka studim, një përshkrim i përgjithshëm)
- *Specifikimet Teknike të cilat duhet të jepen për çdo zë pune.*
- Relacionin gjeologjik dhe vetitë fiziko-mekanike të dherave ku duhet të paraqiten.
- *Cilësitë fiziko-mekanike të dherave dhe të shtresave në themelet e objektit ekzistues.*
- *Rekomandime dhe propozime për raste të veçanta.*
- Certifikata e Performances se Energjise

Gjithashtu për këtë projekt, bazuar në Ligjin Nr 124/2015 "Për Efikasitetin e Energjisë" si dhe Vendimin Nr.537, datë 08/07/2020 për miratimin e kërkesave minimale të performances se energjise se ndërtesave dhe elementeve të ndërtesave duhet të realizohet raporti i auditimit të energjise dhe Certifikata e Performances se Energjise.

Oponenca teknike

Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik. Me "objekte me akses publik", sipas këtij neni, do të kuptohen të gjitha objektet, ku,

pavarësisht statusit të pronësisë së tyre, qytetarët kanë akses të lirë hyrjeje, si: kinema, teatro, stadione, markete etj.”.

- Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis (nese e kerkon ligji)
- Raport elektrik.
- Raport hidro, kush, kuz.
- Raport i sistemeve mekanike, ngrohje – ftohje, mnz. etj...
- Raport teknik; Preventiv; Rilevimi.
- Grafiku i punimeve.
- Licensat e stafit projektues.
- Deklaratat e pergjegjesis profesionale te stafit pjesmarres ne hartimin e projektit.Dorëzimi final, fizik, i projektit të zbatimit, do të konsiderohet ai, i cili do të ketë kaluar të gjitha fazat e mësipërme, si te dhe bazuara në: Ligji 107/2014 Për planifikimin e zhvillimit te territorit i ndryshuar ; Ligji 69/2012 Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar ;Ligji nr 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” te ndryshuar ;Ligji 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” i ndryshuar ;Ligj nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave” ;Ligji nr. 152/2015 Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin. Projektuesi do të përdorë edhe standardet në fuqi të projektimit të hartuara nga MASH për objektet arsimore: VKM 319 datë 12.04.2018.

Paraqitja e vizatimeve.

Vizatimet në fazë projekt zbatimi duhet të paraqiten në format A3, të jenë të lexueshme dhe të përmbajnë si minimum fletët si më poshtë:

- Topografinë e gjendjes ekzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjëndjen e sotme (me leje dhe pa leje)
- Planimetria e përgjithshme e objektit në Shk. 1:200; 1:500
- Planimetritë e kateve ekzistuese Shk. 1:100, 1:50
- Planimetritë e objektit pas ndryshimeve Shk. 1:100; 1:50
- Fasadat ekzistuese Shk.1:100
- Fasadat e reja në 2D dhe 3D Shk.1:100
- Prerjet e godinës (në të dy drejtimet) Shk.1:100
- Planimetria e themeleve Shk.1:100
- Prerje të themeleve dhe detajet Shk.1:20; 1:10
- Plani i strukturave detaje Shk.1:100; Shk.1:50
- Planimetritë e mobilimit të shkollës Shk.1:100
- Planimetria e rrjetit të kanalizimeve në shkallën Shk. 1: 100
- Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve Shk.1:10, 1:20
- Planimetria e furnizimit me ujë në Shk. 1: 200, 1:100
- Skemat aksonometrike të furnizimit me ujë, detaje të pajisjeve hidrosanitare Shk.1:100
- Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të ujësjellësit Shk.1:20, 1:10
- Planimetria, aksonometria dhe detaje të sistemit të ngrohjes Shk.1:100
- Planimetria dhe detaje të sistemit te mbrojtjes kundër zjarrit Shk.1:100
- Planimetria e dhomës së kaldajës, konstruksioni, detaje Shk.1:100;1:50
- Planimetri dhe detaje për ndriçimin, fiksimin e ndriçuesve në tavan, instalimin e kuadrit kryesor etj. Shk.1:100;1:50
- Planimetria e skemës së shpërndarjes së fuqisë në të gjithë objektin, Shk. 1:100
- Planimetritë për telefoninë, rrjetin e internetit Shk.1:100; 1:50
- Planimetria e ndriçimit të jashtëm dhe detaje të tij Shk.1:100; 1:50
- Planimetria e ambienteve sportive dhe ambienteve të gjelbëruara dhe detaje Shk.1:100; 1:50
- Planimetria e murit rrethues, tipin dhe detajin e fiksimit të stolave Shk.1:100; 1:50.

- Planimetria disiplinimit dhe shkarkimit të ujërave sipërfaqësore dhe detajet përkatëse shk.1: 100; 1:50.
- Planimetria e Shpronësimeve, Kjo planimetri do të identifikojë pronat dhe godinat që preken nga realizimi i projektit dhe gjithashtu të bëhet llogaritja e sipërfaqes që preket për arsye shpronësimi.

Faza e V: Projekti i Zbatimit

Preventivi i plotë i kushtimit të veprës. Përgatitja e preventivit të detajuar sipas specifikimeve të projektit me programin e punimeve të ndara sipas kategorive dhe zërave të punës. Harmonizimi dhe kordinimi i kategorive të punës së projektit të bëra nga specialistet e përfshirë në planifikimin e projektit.

Investimi Themelor

Investimi themelor do të dal nga varianti më i mirë tekniko-ekonomik i aprovuar nga Bashkia Lezhe.

Sqarime të fundit

Të dhënat e nevojshme për projektim, siç janë: gjendja e rrjetit ekzistues të ujësjellësit, të kanalizimeve, ndriçimit, kabinat e tensionit të lartë, planin rregullues të zonës, etj, do t'i bashkëngjiten kësaj detyre.